

*“Tefsir-e-Kebir”
(Komentim i gjerë i Kuranit Famëlartë)*

Komentim i Sures El-Fatiha



Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed^{ra}

“Tefsir-e-Kebir”
(*Komentim i gjerë i Kuranit Famëlartë*)

Komentim

i Sures El-Fatiha

Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed r.a.

Kalif i Dytë i Xhematit Musliman Ahmedia

Tiranë, 2018

Komentim i sures El-Fatiha (Pjesë nga vëll. I i “*Tefsir-e-Kebir*”)

Autor: *Hazret* Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed ^{r.a.},

Kalif i Dytë i Xhematit Musliman Ahmedia (1914 – 1965)

(Albanian rendering of Urdu *Commentary of Surah Al-Fatiha*
from *Tafseer-e-Kabeer*, vol. I)

Botimi i parë në gjuhën urdu: “*Tafseer-e-Kabeer*” vol. I, 1948

Botimi i parë në shqip: 2018

E përktheu nga origjinali: Samad Ahmed Ghorî

Redaktorë gjuhësorë: Ina Komino, Besmir Yvejsi

Botues:



Fond. Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë
Tiranë, Shqipëri (Albania)

© Islam International Publications Ltd.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Kopertina: Petani Design, Tiranë

U shtyp në shtypshkronjën: Gent.grafik, Tiranë

ISBN: 978-9928-4491-0-8

Parathënie

Janë vetëm shtatë vargje por secili prej tyre mbart një det kuptimesh dhe dijes. E tillë është surja El-Fatiha, kaptina e parë e Kuranit Famëlartë. Me një depërtim të thellë në këtë sure, lexuesi kupton që ajo është si një prizëm, të cilën nga do ta kthesh, tregon ngjyra të reja. I tillë është ky komentim brilant i kësaj sureje të bekuar.

Megjithatë, ky libër është vetëm një pjesë e vogël e Komentimit të Gjerë të sureve të ndryshme të Kuranit Famëlartë që bëri Kalifi i Dytë i Xhematit, *Hazret* Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed, Allahu e mëshiroftë. Komentimi i sures El-Fatiha është një pjesë e vëllimit të parë. Gjithsej, autori ka shkruar dhjetë vëllime që kanë më shumë se dhjetë mijë faqe.

Në rininë e hershme, autori përjetoi një ngjarje të çuditshme shpirtërore. Iu paraqit një engjëll në ëndërr dhe ia mësoi komentimin e sures El-Fatiha. Në këtë mënyrë, atij iu dhuruan njohuria e thellë dhe kuptimi i gjerë i Kuranit nga Allahu i Lartësuar. Të gjitha fjalimet, diskurset dhe shkrimet e tij rrotullohen rreth këtij boshti dhe shpalosin perlat e Kuranit. Lutem që Zoti t'ua shtojë besimin lexuesve të këtij komentimi! Amin!

Përkthimi i këtij libri në shqip është bërë nga z. Samad Ghorì.
Redaktimin gjuhësor e bëri znj. Ina Komino, ndërsa z. Besmir Yvejsi
punoi për të gjetur referencat e plota për citimet që janë përdorur në
këtë libër. Zoti i shpërbleftë!

Ves-selam

Munir-ud-Din Shams

Add. Vakilut-Tasnif

(Drejtor i botimeve të Xhematit Musliman Ahmedia)

20 prill 2018

Fjala e Allahut

Kurani Famëlartë është i vetmi libër që mund të quhet si Fjala e Zotit. Librat e tjerë, qofshin edhe të shpallur, nuk mund të quhen të tilla, sepse në ta është përzierë edhe fjala e njeriut. Fjala e Zotit pastër, nga a-ja te zh-ja, pra nga *bismil-lah* deri tek *ven-nas*, është vetëm Kurani Famëlartë.

Ky Libër që kur është zbritur e gjer më sot, është njësoj i pandryshuar. Nuk i është shtuar asnjë fjalë dhe as nuk i është pakësuar. Çdo bashkëtingëllore, çdo zanore dhe çdo presje e tij janë edhe sot njësoj siç kanë qenë në kohën e zbritjes. Gjithashtu, ky Libër nuk ka asnjë porosi të papraktikueshme dhe asnjë ajet të shfuqizuar. Prandaj, nuk ka libër tjetër përveç Kuranit, të cilin njeriu mund ta përcaktojë për vete si një udhërrëfim, duke besuar se aty nuk ka asgjë të dyshimtë. Por mjerisht, muslimanët e lanë pas dore këtë Libër të çmuar dhe në vend të tij, po merren me libra të tjerë. Në vend të Zotit, ata po ndjekin liderë të sajuar.

Kam shkruar komentimin e Fjalës së Allahut me shpresën se ata që nuk dinë arabisht, ose që fatkeqësisht nuk gjejnë kohë për t'u thelluar në të, ose atyre që nuk u lind dëshira për këtë punë, t'u krijohet rasti për ta kuptuar Fjalën e Allahut në mënyrë që edhe ata të njihen me bukuritë e saj të brendshme e të jashtme.

Kjo parathënie i kushtohet vëllimit të parë. Tri vëllimet që janë për disa nga suret e mesme dhe të fundit të Kuranit, janë botuar më përpara. Allahu i Madhërishëm më pranofte këtë përpjekje shumë të

vogël dhe përmes këtij komentimi, u dhëntë jetë edhe një herë, së brendshmi dhe së jashtmi, kuptimeve të Kuranit Famëlartë, dhe gjithashtu, më dhëntë edhe mua mundësinë për ta përfunduar këtë komentim! (Amin!)

Mirza Mahmud Ahmed

Raten Bag, Lahor

Data: 23.05.1948

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ نَحْمَدُهُ وَنُصَلِّي عَلَى رَسُولِهِ الْكَرِيمِ

Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga djalli i mallkuar

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

Atë e lavdërojmë dhe të dërguarit të Tij fisnik i dërgojmë salavate!

Me bekimin dhe mëshirën e Zotit!

Ai është Ndihmësi!

Surja El-Fatiha

Surja El-Fatiha është *mekase*

dhe bashkë me *bismil-labin*, ajo ka 7 ajete.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢﴾ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿٣﴾
مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٤﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾ أَهْدِنَا الصِّرَاطَ
الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

Bismil-lāhirr-Rrahmānirr-Rrahīm

El-Hamdulil-lāhi Rabbil-‘ālemīn

Err-Rrahmānirr-Rrahīm

Māliki jeumiddīn

Ijjāke na‘budu ve ijjāke neste‘īn

Ihdinas-sirātal-mustekīm

Sirātal-ledhīne en‘amte ‘alejhim gajril-magdūbi ‘alejhim ve led-dāl-līn.

(Āmīn!)

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.
2. Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve;
3. të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit;
4. Sunduesit të ditës së gjykimit.
5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.
6. Na udhëzo në rrugën e drejtë.
7. Në rrugën e atyre që i bekove, që nuk tërhoqën zemërim dhe që nuk devijuan. (Amin!)

Kuptime leksikore

سُورَةُ Sure

Sure në arabisht, ka kuptime si më poshtë:

- 1) مَائِلَةٌ – Shkallë (pozitë).
- 2) شَرَفٌ – Nder.
- 3) عَلَامَةٌ – Shenjë.
- 4) Mur ose ndërtesë e gjatë dhe e bukur.¹
- 5) Mund të rrjedhë edhe nga سُورَةٌ *su’retun*, pra, ajo ka një *hemze* që për shkak të “u-së” para, u shndërrua në “ue”. Kuptimi është: tepricë. Arabët thonë: هُوَ فِي أَسَارِ النَّاسِ, që do të thotë “përveç njerëzve të tjerë, është edhe ai”.²
- 6) Diçka që është e plotë dhe e përsosur. Arabët devesë së re e të shëndetshme i thonë سُورَةٌ “sure”.³

Shumësi i fjalës سُورَةٌ *sure*, është سُُورٌ *suver*.

Arsyeja e emërimit të kapitujve si *sure*

Përse disa pjesë të Kuranit janë quajtur *sure*? Në lidhje me këtë, dijetarë të ndryshëm kanë dhënë shpjegime të ndryshme. Sipas disave, ato quhen *sure* sepse lexuesi i tyre ngrihet në pozitë. Sipas disave, fiton nder duke i lexuar ato. Për disa të tjerë, surja është shenjë e përfundimit të një teme të caktuar, ndërsa për të tjerë, suret paraqesin një ndërtesë të lartë e të bukur shpirtërore. Disa e shpjegojnë si pjesë të veçuar të gjithë Kuranit. E sipas të tjerëve, surja është emërtuar kështu sepse ajo përmbledh në vetvete një temë të plotë.

Është e qartë se variacioni në shpjegimin e emërimit të sures është thjesht subjektiv, përndryshe, ajo mund t'i ketë të gjitha kuptimet e lartpërmendura dhe ne përmbledhtazi mund të themi se pjesë të caktuara të Kuranit quhen *sure*, sepse: 1) janë pjesë të tij, 2) secila prej tyre mbart një temë të plotë e tërësore, 3) përbëhen nga ndërtesa të larta e të bukura shpirtërore, në të cilat, ata që hyjnë: 4) fitojnë pozitë të lartë, 5) dhe nder dhe, 6) ata që i zbatojnë këto sure, dallohen dukshëm nga të tjerët.

Emërtimi i sureve si *sure* është i shpallur

Emërtimi i pjesëve të caktuara të Kuranit Famëlartë me fjalën "sure" është i shpallur dhe është përdorur edhe nga i Dërguari fisnik i Allahut^{sav}. Kurani Famëlartë thotë:

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّثْلِهِ

"E nëse jeni në mëdyshje për atë që kemi zbritur mbi robin Tonë, sillni ndonjë sure të tillë".⁴

Emri *sure* në Kuran dhe në hadithe

Kështu që, fjala “sure” është përdorur vetë nga Kurani Famëlartë dhe si e tillë është një emër i shpallur. Edhe i Dërguari fisnik i Allahut^{savs} e përdorte këtë emër. Imam Muslim në sahihun e tij përmend: Në Sahih Muslim thuhet: Hazret Enesi^{ra} dëshmon:

قال رسول الله صلى عليه وسلم أنزلت على أنفأ سورة فقرأ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ- إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكُؤُتْرَ-

I Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Sapo më zbriti një sure”, dhe lexoi: “Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. Sigurisht, Ne të dhamë ty *Keutherin*...”⁵

Ky rrëfim tregon se edhe Profeti Muhammed^{savs} i quante *sure* ato pjesë të Kuranit, të cilat sot muslimanët i quajnë po kështu dhe se ky emërtim nuk është aspak i mëvonshëm.

Surja El-Fatiha

Kjo sure e shkurtër që vjen në fillim të Kuranit Famëlartë quhet *Fatihatul-Kitab* (Çelësi i Librit). Urdufolësit ndoqën mënyrën perse dhe e quajtën *Sura-e-Fatiha*. Këtë emërtim e përmend edhe i Dërguari fisnik i Allahut^{savs}, siç thuhet në Tirmidhi:

عن عبادة بن الصامت عن النبي ﷺ قال: لَا صَلَاةَ لِمَنْ لَمْ يَقْرَأْ بِفَاتِحَةِ الْكِتَابِ-

“Derisa *Fatihatul-Kitab* (dmth. Surja El-Fatiha) nuk thuhet në namaz, namazi nuk kryhet”.⁶

Po ky rrëfim nga i njëjti sahab përmendet edhe në Sahih Muslim.⁷

Nëntë emrat e sures El-Fatiha

Kjo sure ka shumë emra, prej të cilëve më të famshmit janë ata që vijnë në Kuranin Famëlartë dhe disa të tjerë që i gjejmë në thëniet e Profetit Muhmmed^{savs}, si vijon:

1) Surja e namazit (*Suretus-Salat*)

Hazret Ebu Hurejre^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Allahu i Madhërishëm tha:

قَسَمْتُ الصَّلَاةَ بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي نِصْفَيْنِ-

“Unë e kam ndarë *salatin* (dmth. suren El-Fatiha) gjysmë për gjysmë mes Meje dhe robit Tim”.⁸

E njëjta gjë rrëfëhet edhe nga Xhabir Ibni Abdullah^{ra}, të cilën e ka përmendur Ibni Xheriri.⁹

Që do të thotë se gjysma e El-Fatijasë flet për atributet e Allahut dhe në gjysmën tjetër ka lutje për robin.

2) Surja El-Hamd (*Suretul-Hamd*)

Libri “Ebu Daud” sjell rrëfimin e Hazret Ebu Hurejres^{ra}, i cili thotë:

الْحَمْدُ لِلَّهِ أَمُّ الْقُرْآنِ وَأُمُّ الْكِتَابِ وَالسَّبْعُ الْمَثَانِ

“Surja *El-Hamdulil-lah* është edhe *Ummul-Kur’an*, *Ummul-Kitab*, dhe *Es-seb’ul-methani*”.¹⁰

3, 4, 5) Nëna e Kuranit (*Ummul-Kur’an*) Kurani i Madhërishëm (*Kur’anul-Adhim*) dhe Shtatëvargëshi i përsëritur (*Es-sab’ul-mathani*)

Edhe këta tre janë emrat e kësaj sureje. Musnedi i Imam Ahmed Ibni Hanbelit përmend rrëfimin e Ebu Hurejres^{ra}, që i Dërguari i Allahut^{savs} tha:

هِيَ أُمُّ الْقُرْآنِ وَهِيَ السَّبْعُ الْمَثَانِي وَهِيَ الْقُرْآنُ الْعَظِيمُ.

“El-Fatihaja është edhe *Nëna e Kuranit*, është edhe *Shtatëvargëshi i përsëritur* dhe, gjithashtu, është edhe *Kurani i Madhërishëm*”.¹¹

Emri i saj *Shtatëvargëshi i përsëritur* është përmendur edhe në Kuranin Famëllartë. Zoti thotë:

وَلَقَدْ ءَاتَيْنَاكَ سَبْعًا مِّنَ الْمَثَانِي وَالْقُرْءَانَ الْعَظِيمَ

“Sigurisht, Ne të kemi dhënë ty shtatëvargëshin e përsëritur”.¹²

Pra, këtë emër ia ka vënë Kurani Famëllartë sures El-Fatiha.

6) Nëna e Librit (*Ummul-Kitab*)

Um-mul-Kitab (Nëna e Librit). Ky emër përmendet në rrëfimin e Hazret Ebu Hurejres^{ra}, që ruhet në librin Sunen Ebu Davud dhe që u tha në numrin e 2, pak më parë.

7) Shërimi (*Esh-shifa*)

Hazret Ebu Seid Hudriu^{ra} thotë:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فَاتِحَةُ الْكِتَابِ شِفَاءٌ مِنْ كُلِّ دَاءٍ

“Surja El-Fatiha është shërim për çdo sëmundje”¹³

Këtë rrëfim e përmend edhe Imam Bejhaki në librin e tij “*Fi shu’abil-iman*”, veçse në vend të fjalëve مِنْ كُلِّ دَاءٍ “për çdo sëmundje” thuhet مِنْ كُلِّ سَمٍّ “për çdo helm”.¹⁴

8) Surja për të fryrë (*Err-Rrukju*)

Edhe ky emër përmendet në rrëfimin e Hazret Ebu Seid Hudriut^{ra} që është në Musnedin e Ahmed Ibni Hanbelit¹⁵ dhe në Buhari.¹⁶

Dikush i pati thënë Profetit Muhammed^{savs}:

Dikë e pickoi gjarpri. I fryva duke lexuar suren El-Fatiha dhe ai u shërua.

I Dërguari i Allahut^{savs} e pyeti:

مَا يُدْرِيكَ أَنَّهَا رُقِيَّةٌ

“Nga e dije ti se ajo është sure për të fryrë?!”

“Kështu ndjeva në zemër, o i Dërguari i Allahut”, iu përgjigj sahabi.

9) Surja “Thesari” (*Suretul-Kenz*)

Bejhaki¹⁷ sjell rrëfimin e Hazret Enesit^{ra}:

عن النبي ﷺ قال إن الله أعطاني فيما منّ به عليّ فاتحة الكتاب وقال هي كنز من كنوز عرشي.

I Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Njëra prej bekimeve që më dha Zoti Vetë me mirësinë e Tij është *Fatihatul-Kitab* (El-Fatiha) dhe Zoti i Madhërishëm më tha për të: Ky është njëri prej thesareve të *Arshit* Tim”.¹⁸

Emrin El-Fatiha e kam përmendur më lart. Kështu që, këta janë nëntë emrat e kësaj sureje që i gjejmë në Kuran dhe në hadithe. Ka edhe emra të tjerë përveç tyre, treguar prej sahabëve të Profetit Muhammed^{savs}. Sipas Imam Sujutiut janë njëzet e pesë të tillë. ‘Allama Kurtubiji ka përmendur dymbëdhjetë¹⁹, por ngaqë nuk kam gjetur dot ndonjë dëshmi nga Kurani dhe hadithet, nuk i kam përmendur këtu.

Bibla bën profeci emrin dhe numrin e ajeteve të sures El-Fatiha

Emri El-Fatiha i kësaj sureje ka edhe një veçanti. Ai gjendet si profeci edhe në libra të shenjtë të mëparshëm. Kështu, në vargun e dytë të kapitullit 10 të librit “Zbulesa” thuhet:

“Ai kishte në dorë një libërth të hapur dhe vuri këmbën e tij të djathtë mbi det dhe të majtin mbi dhe, dhe thirri me zë të madh si një luan që vrumbullon; dhe, si bërtiti, të shtatë bubullima bënë të dëgjohej ushtima e tyre”.²⁰

Këtu gjejmë në formë profecie edhe emrin, edhe numrin e ajeteve të sures El-Fatiha. Përkthyesi duke mos ditur kuptimin e vërtetë të profecisë, fjalën hebraike “*futuba*” e përktheu “libër i hapur”, ndërkohë “*futuba*” nuk ishte gjë tjetër, veçse “*fatiba*” [edhe *fatiba* do të thotë hapje]. Shtatë bubullimat që janë përmendur në këtë profeci, u referohen shtatë ajeteve të kësaj sureje. Dijetarët e krishterë e pranojnë unanimisht që në këto vargje të librit të Zbulesës është parashikuar ardhja e dytë e Mesihut dhe kjo është plotësisht e vërtetë. Fjalët e profecisë tregojnë që surja në fjalë do të jetë e kyçur deri në kohën e ardhjes së Mesihut, pra shpjegimi i saj do të zbulohej në kohën e Mesihut të Premtuar. Kështu, në vazhdim të librit të Zbulesës thuhet që një zë qiellor iu drejtua të dërguarit dhe e porositi:

“Vulosi gjërat që thonin të shtatë bubullimat dhe mos i shkruaj.”²¹

Emrat e sureve janë vendosur që në kohën e Profetit Muhammed^{savs}

I kam renditur emrat e kësaj sureje duke i shpjeguar me hollësi, që t'ju tregoj se emrat e sureve janë vendosur nga Profeti Muhammed^{savs} dhe siç provohet nga disa, emrat e sures El-Fatiha Profeti^{savs} i ka vendosur në bazë të shpalljes së Zotit të Madhërishëm.

Emrat e sures El-Fatiha tregojnë edhe tema të ndryshme të saj

Arsyeja e dytë e renditjes së këtyre emrave është që ata hedhin dritë mbi kuptime të thella të kësaj sureje. Këta nëntë emra të El-Fatihës zbulojnë dhjetë tema të ndryshme të saj.

El-Fatiha është *Fatihatul-Kitab*. Do të thotë që është porositur të vendosej në krye të Kuranit Famëlartë dhe së dyti, ajo është si një çelës për të hapur kuptimet kuranore.

Ajo është *Suretul-Hamd*, sepse hedh dritë mbi krijimin e njeriut dhe mbi lidhjen e Zotit dhe robit, duke zbuluar qartazi se njeriu është krijuar për të bërë zhvillime madhore dhe se lidhja e Zotit të Madhërishëm me robërit e Tij është e bazuar mbi mëshirën dhe bekimin e Tij.

Ajo është *Es-Salat*, sepse është lutje e përsosur dhe e pashembullt. Ajo është *Ummul-Kitab*, sepse i përfshin të gjitha dijet që njeriu ka nevojë t'i komunikojë me të tjerët dhe se ajo është si nënë e Kuranit Famëlartë, që do të thotë se lutjet që janë përmendur në këtë sure qenë klithmat e njerëzve të sinqertë e të brengosur, lutje të cilat duke arritur gjer në *Arshin* madhështor, shkaktuan zbritjen e Kuranit Famëlartë.

Ajo është *Ummul-Kuran*, sepse përfshin të gjitha dijet që kanë lidhje me qenien njerëzore. Ajo është *Es-Seb'ul-Methani* (shtatëvargëshi i përsëritur), sepse ajetet e saj, edhe pse janë vetëm shtatë, do të citohen vazhdimisht për të zbuluar tema të ndryshme të jetës njerëzore, për të zgjidhur të gjitha çështjet shpirtërore dhe për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave të dijes. Ajo është e përsëritur edhe për arsye se recitohet në çdo rekat të namazit.

Ajo është edhe Kurani i Madhërishëm, domethënë, pavarësisht se quhet "Ama e Librit" dhe "Ama e Kuranit", kjo sure është pjesë e Kuranit Famëlartë dhe nuk është e ndarë nga ai, jo ashtu siç e kanë keqkuptuar disa njerëz, që pohojnë se ajo nuk është pjesë e Kuranit. Ashtu siç i themi dikujt: Na këndo Kuranin!, dhe nënkuptojmë që ai të këndojë ndonjë sure ose ndonjë pjesë të Kuranit, në të njëjtën mënyrë edhe surja El-Fatiha është quajtur Kurani i Madhërishëm.

Surja El-Fatiha është shërim sepse largon të gjitha ngatërresat që lindin në zemrën e njeriut rreth besimit. Ajo është *Rukje* (për të fryrë), sepse përveçse është e dobishme për të larguar sëmundjet trupore, recitimi i saj ia largon njeriut sulmet e djallit dhe të pjellës së tij. Ajo të jep forcë të tillë në zemër, aq sa i rrëzon sulmet e djallit. Ajo është thesar, sepse prej saj rrjedhin lumenj dijesh. Në gjuhën urdu kemi shprehjen – të mbyllësh lumin në kovë. Kuptimi i saj i vërtetë ndoshta aplikohet vetëm në suren El-Fatiha, madje për të mund të themi: "u mbyll deti në kovë".

Kështu që, me renditjen e emrave të El-Fatihës, të vendosur nga vetë Profeti Muhammed^{savs}, kisha qëllimin që t'u jepja lexuesve një pamje

sado të vogël të kuptimeve të thella të saj. Po të ishin të pakuptimtë emrat e saj, jo nëntë, por edhe njëqind sikur të ishin, nuk do të sillnin asnjë dobi. Një gjë e tillë, sigurisht, nuk pritet nga i Dërguari fisnik i Allahut^{savs}. Andaj, të mençurit kanë një dritë të fuqishme dhe udhëzim të plotë në këta emra.

Bekimet e sures El-Fatiha

Në hadithe janë përmendur shumë bekime të kësaj sureje. Disa jua kam përmendur më sipër, duke iu referuar emrave të saj, kurse më kryesoret, do t’i përmend në vijim.

Imam Nisaiu në sunenin e tij sjell rrëfimin e Ubej Ibni Ka’bit^{ra}:

قال رسول الله ﷺ ما انزل الله في التوراة والانجيل مثل ام القرآن وهي السبع المثاني و هي مقسومة بيني وبين عبدي ولعبدى ما سأل.

I Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Një sure të tillë si *Ummul-Kur’an* (Suren El-Fatiha) Zoti i Madhërishëm nuk e ka zbritur as në Tevrat e as në Ungjill. Ajo gjithashtu është shtatëvargëshi i përsëritur dhe rreth saj, Zoti më tha mua: Ajo është e ndarë në mënyrë të barabartë midis Meje dhe robit Tim dhe çfarëdo lutjeje që të bëjë robi Im përmes saj, do t’i pranohet”.²²

Kjo epërsi e sures El-Fatiha është shumë e rëndësishme, sepse na tregon një sekret që na përmirëson besimin dhe botën dhe që është: lutja që bëhet përmes saj, do të pranohet.

Nuk do të thotë se do t’ju pranohet çfarëdo lutjeje që të bëni përmes sures El-Fatiha, kjo dihet. Por, nëse do të përdorni mjetet ose parimet që janë përmendur në këtë sure për pranimin e lutjes, lutja juaj do të pranohet patjetër.

Shtatë parime të pranimit të lutjes, të përmendura në El-Fatiha

Shtrohet pyetja: cilat janë ato parime, që do t'ju mundësojnë pranimin e lutjes?

Siç na bëhet e qartë nga teksti i kësaj sureje, këto janë mjetet e pranimit të lutjes:

- 1) *Bismil-lah* (Me emrin e Allahut)
- 2) *El-Hadmu lil-lah* (Lavdia është e Allahut)
- 3) *Err-Rrahman* (I Gjithëmëshirshmi)
- 4) *Err-Rrahim* (Mëshirëbërësi)
- 5) *Maliki jeumid-din* (Sunduesi i Ditës së Gjykimit)
- 6) *Ijjake na'budu* (Vetëm Ty të adhurojmë)
- 7) *Ijjake nesta'in* (Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë)

Me pak fjalë, kjo sure ashtu siç ka shtatë vargje, na tregon po ashtu shtatë parime për pranimin e lutjes. Me fjalët "*Me emrin e Allahut*" (*Bismil-lah*) kjo sure tregon se qëllimi për të cilin do të luteni, duhet të jetë i mbarë. Domethënë, nëse dikush lutet për të bërë vjedhje, Zoti nuk ia pranon atë. Lutja që bëhet me emrin e Zotit dhe me ndihmën e Tij, patjetër që duhet të bëhet për një punë, ku qenia e Zotit të mund të shoqërojë qenien e robit. Shikoni pra, në fjalë kaq të pakta, si Zoti na i ka qartësuar kornizat e lutjes. Kam parë shumë njerëz që luten për shkatërrimin e njerëzve të tjerë dhe më pas ankohen se nuk u pranohen ato. Po ashtu, luten për kërkesat e tyre të padrejta dhe më pas ankohen

se nuk po u pranohen lutjet. Atyre, që vishen me petkun e dëlirësisë së rreme dhe u lëshojnë njerëzve "nuskë" ose "mbrojtëse" dhe "lutje" për çështjet e tyre të padrejta, sipas këtij parimi, të gjitha ato u refuzohen.

Parimi i dytë është: *Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve (El-Hamdulil-lahi Rabbil-alemin)*. Pra, lutja të jetë e tillë, që e gjithë bota ose njerëzit e tjerë të fitojnë dobi prej saj. Ose të paktën ata të mos pësojnë ndonjë humbje nga ajo. Pranimi i lutjes të provojë lavdinë e Zotit të Madhërishëm dhe Atij t'i mos etiketohet asnjë padrejtësi.

Parimi i tretë është që lutja juaj të nxisë mëshirën e pakufishme të Zotit dhe pranimi i saj të shfaqë atributin e Tij si *i Gjithëmëshirshmi (Rahman)*.

Parimi i katërt është që lutja juaj të ketë lidhje edhe me atributin *Mëshirëbërës (Rahim)*, që do të thotë se ajo duhet të hedhë rrënjët e një mirësie, e cila të jetë e vazhdueshme në botë dhe përmes së cilës njerëzit e mirë e të sinqertë vazhdimisht të përfitojnë, ose të paktën të mos krijohet asnjë pengesë për ta.

Parimi i pestë është që lutja juaj të ketë parasysh edhe atributin *Sunduesi i kohës së gjykimit (Maliki jeumid-din)*, që do të thotë se, kur të luteni, të mos anashkaloni mjetet materiale që janë të nevojshme për të realizuar me sukses punën tuaj, sepse ato i ka përcaktuar vetë Zoti i Madhërishëm. T'i lutesh Atij, pa përdorur mjetet dhe pa ndjekur rrugën që ka diktuar Ai, është e palogjikshme. Pra, lutësi duhet t'i përdorë mjetet materiale, nëse janë brenda mundësive të tij. Nëse nuk janë brenda mundësive të tij, atëherë atributi *Maliki jeumid-din* shfaqet me efektet e tij që i kapërcen mjetet materiale. Një tjetër pikë në këtë

ajet që na ka treguar Zoti është që lutësi duhet të ketë një qasje të mëshirshme ndaj të tjerëve, dhe nga ana tjetër, të mos jetë i rreptë për të kërkuar të drejtat e veta.

Vetëm Ty të adhurojmë. Parimi i gjashtë është që lutësi duhet të ketë lidhje dhe besnikëri të përsosur me Zotin e Madhërishëm. Ai duhet të jetë krejtësisht i pastër nga ndjenja dhe mendime *shirku*.

Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Parimi i shtatë është që ai të bëhet tërësisht i Zotit, të mbështetet vetëm tek Ai, shikimi i tij të largohet tërësisht nga dikush a diçka tjetër jashtë Zotit dhe të qëndrojë në pozitën, ku çfarëdo vështirësie ta godasë, ai t'i kërkojë ndihmë vetëm Zotit të Madhërishëm.

Këto janë shtatë parimet për pranimin e lutjes, të treguara në këtë sure. Ai që i zbaton, meriton fjalët e Zotit:

"Çfarëdo lutjeje që të bëjë rob i Im përmes saj, do t'i pranohet".

E vërteta është që lutje të tilla të përsosura shpesh i gjejmë te Profeti Muhammed^{savs} dhe te ndjekësit e tij të përsosur. Realisht, përmes atyre bota ka dëshmuar mrekulli të tilla të pranimit të lutjeve si: të verbrit fituan shikimin, të shurdhët morën dëgjimin dhe memecët filluan të flasin. Nuk është e mbyllur rruga për askënd për të qenë ndjekës i përsosur i Profetit Muhammed^{savs}. Kushdo që dëshiron, mund të përpiqet për ta arritur këtë pozitë e mund ta arrijë atë.

Surja më e madhe e Kuranit për nga kuptimi

Imam Buhariu^{ra} sjell një rrëfim të Seid Ibnul-Mu'al-la^{ra}, përmbledhja e të cilit është si vijon:

Profeti Muhammed^{savs} tha:

“Ejani t’ju mësoj suren më të madhe të Kuranit Famëlartë”.

Më pas, Profeti^{savs} u mësoi suren El-Fatiha.²³

Pra, Profeti^{savs} tha se El-Fatiha është “surja më e madhe” [أَعْظَمُ السُّورِ] dhe kjo do të thotë se kuptimet e saj janë më të shumta sesa ato të sureve të tjera më të gjata. Kështu do të ishte, përderisa ajo është pasqyrë e të gjithë Kuranit të Shenjtë.

Një përvojë personale

Do të doja t’ju tregoja këtu edhe përvojën time. Isha fëmijë kur pashë në ëndërr që po qëndroja në drejtim të Lindjes dhe përpara meje shtrihej një fushë e gjerë. Aty në fushë u përftua një tingull, si ai që bëhet kur përplas një enë. Tingulli filloi të ushtonte në hapësirë dhe m’u duk sikur e pushtoi gjithë atmosferën. Më pas, epiqendra e zërit zuri të merrte formë. Aty u shfaq një kornizë, si korniza e një pikturë, brenda së cilës filluan të përhapeshin ngjyra të lehta që vinin duke u theksuar. Përfundimisht, ato u shndërruan në një pikturë. Piktura bëri lëvizje dhe u bë një gjë e gjallë. M’u bë si të ishte engjëll. Engjëlli m’u drejtua dhe më tha: “A të të mësoj komentimin e sures El-Fatiha?” “Patjetër”, i thashë. Më pas, ai filloi të më mësonte komentimin e saj, derisa erdhi tek ajeti: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”. Këtu më tha: “Të gjitha komentimet që janë shkruar deri më tani, kanë arritur deri te ky ajet dhe nuk është shkruar komentim për pjesën e mëtejshme”. Pastaj më pyeti: “A dëshiron të të mësoj edhe komentimin e pjesës tjetër?” “Po”, iu përgjigja. Dhe

vazhdoi të më tregonte komentimin e sures El-Fatiha dhe kur e përfundoi, më doli gjumi.

Kur u zgjova, mbaja mend vetëm një a dy pika të këtij komentimi. Fjeta përsëri dhe kur u rizgjova, nuk mbaja mend asnjë gjë nga fjalët e tij. Pas pak ditësh, m'u dha mundësia të flisja në një mbledhje rreth kësaj sureje. Ndjeva që duke folur për këtë temë më vinin në mendje kuptime të reja të El-Fatijasë. U binda që ishte ky kuptimi i ëndrrës. Kështu, që prej asaj kohe e deri më sot, gjithmonë më janë zbuluar kuptime nga më të rejat të kësaj sureje. Qindra prej tyre i kam përmendur në libra dhe fjalime të mia të ndryshme, megjithatë, ky thesar nuk shterohet. Edhe parimet e pranimi të lutjes që i kam renditur pak më sipër, janë pjesë të kësaj përvoje. Sepse, teksa po shkruaja komentimin e kësaj sureje, më lindi dëshira që edhe në këtë rast, Zoti i Madhërishtëm të më mësonte ndonjë kuptim të ri të saj. Menjëherë pas kësaj, më janë zbuluar shtatë parimet e pranimi të lutjes që tregon kjo sure. **لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ** Lavdia është e Allahut për këtë!

Përveç kësaj, ajo që kam shkruar lart, është vetëm përmbledhje. Ka shumë tema të thella që fshihen në këto shtatë parime. **ذَلِكَ فَضْلُ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ** Ky është bekimi i Allahut, të cilin Ai ia jep kujt të dojë.

Zbritja e sures El-Fatiha

Rreth zbritjes së kësaj sureje, Ibni Abasi^{ra}, Katade dhe Ebul-Alije thonë se është mekase, kurse Ebu Hurejra^{ra}, Muxhahidi, Atau dhe Zuhriu thonë se është medinase. Por, nga Kurani Famëlartë del se kjo sure u zbrit që në Mekë, sepse ajo përmendet në suren El-Hixhr dhe

surja Hixhr unanimsht pranohet si sure mekase. Në suren El-Hixhr përmendet:

وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ سَبْعًا مِّنَ الْكُتُبِ وَالْقُرْآنَ الْعَظِيمَ

“Sigurisht, Ne të kemi dhënë një shtatëvargësh të përsëritur dhe Kuranin e Madhërishtëm”. (El-Hixhr 15:88)²⁴

El-Fatiha u zbrit edhe në Mekë, edhe në Medinë

Sipas disa dijetarëve, El-Fatiha është zbritur dy herë, herën e parë në Mekë, kurse herën e dytë në Medinë, andaj ajo është edhe mekase, edhe medinase. (Kjo përmendet në Kurtubi, duke iu referuar Tha’lebiut²⁵, por në komentimin e Tha’lebiut, që titullohet “Metbu’a el-xhezair” nuk përmendet ky fakt. Ndoshta Kurtubiu e ka marrë këtë të dhënë nga ndonjë libër tjetër i Tha’lebiut). Edhe sipas meje, ky është mendimi i saktë. Është e vërtetuar që ajo është mekase dhe është provuar nga rrëfime bindëse që ajo është edhe medinase. Pra, në realitet ka zbritur dy herë. E kur zbriti për herë të dytë në Medinë edhe Profeti Muhammed^{savs} e ka përmendur zbritjen e tij në ndonjë mbledhje, si duket, disa nga të pranishmit kanë kuptuar se ajo vetëm atë ditë ka zbritur, ndërkohë, qëllimi i Profetit^{savs} mund të ishte të thoshte se surja në fjalë u zbrit edhe në Medinë.

Një tjetër provë që El-Fatiha është mekase është që të gjithë rrëfimet pohojnë se ajo recitohej në namaz që nga fillimi. Ndërkohë, muslimanët që në Mekë e kishin filluar të falnin namazin, madje që në periudhën e parë.

Surja El-Fatiha është pjesë e Kuranit

Disa njerëz hodhën mendimin që surja El-Fatiha nuk është pjesë e Kuranit të Shenjtë dhe, si argument thonë se kopja e Kuranit që kishte Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} nuk e kishte El-Fatihanë. Por duhet ditur që kopja e Kuranit e Hazret Abdullah Ibni Mesudit^{ra} nuk kishte jo vetëm El-Fatihanë, por edhe dy suret e fundit, domethënë El-Felekun dhe En-Nasin. Pra, ai nuk i kishte shënuar këto tri sure në kopjen e tij. Ai mendonte që ngaqë surja El-Fatiha recitohet në çdo namaz, duhet të ishte si parathënie e çdo sureje dhe, mundet që edhe për dy suret e fundit të Kuranit, ai të kishte të njëjtin mendim, për shkak se ato përdoren si lutje për të shpëtuar nga shqetësime dhe dëme të ndryshme. Për këtë arsye, vlerësimi i tij për këto dy sure ishte që ato pavarësisht se janë pjesë e Kuranit, nuk janë pjesë e shkruar e tij. Ndoshta edhe për këto dy sure, ai mendonte se ishin të lidhura me të gjitha suret e tjera.

Mendimi i Abdullah Ibni Mesudit^{ra} i cituar më sipër rreth El-Fatihasë vërtetohet nga një rrëfim. Ebu Bekr El-Enbarij përmes A'meshit dhe Ibrahimit rrëfen: Kur u pyet Abdullah Ibni Mesudi^{ra} se përse nuk e kishte shkruar El-Fatihanë në kopjen e tij të Kuranit, ai iu përgjigj:

لَوْ كَتَبْتُهَا لَكَتَبْتُهَا مَعَ كُلِّ سُورَةٍ

"Po ta kisha shkruar atë, do ta kisha shkruar para çdo sureje".²⁶

Pra, sipas tij, po ta shkruante atë para El-Bekares, do t'i duhej ta shkruante para çdo sureje tjetër. Për këtë arsye, nuk e shkroi as para El-Bekares, në mënyrë që të mos lindte keqkuptimi se ajo ka lidhje vetëm me El-Bekaren.

Si duket, po ky ishte argumenti i tij edhe për dy suret e fundit të Kuranit, përndryshe, si mund të përjashtonte nga Kurani i Shenjtë suren që Profeti Muhammed^{savs} në veçanti e ka quajtur si suren e tij më madhore.²⁷

Surja El-Fatiha të thuhet në çdo rekat të çdo namazi

Surja El-Fatiha duhet të thuhet në çdo rekat të çdo namazi, përveç rastit kur namazfalësi i bashkohet xhematit në kohën kur imami ka shkuar në *ruku*. Në këtë rast, namazfalësi le të thotë *tekbirin* dhe, pa thënë asgjë tjetër, të kalojë direkt në *ruku*. Recitimi i imamit do të llogaritet edhe si recitimi i tij.

Porosia për leximin e sures El-Fatiha në namaz gjendet në hadithe të ndryshme. Muslimi thotë se Hazret Ebu Hurejre^{ra} rrëfen:

قال [رسول الله ﷺ] مَنْ صَلَّى صَلَاةً لَمْ يَقْرَأْ فِيهَا بِأَمِّ الْقُرْآنِ فَهِيَ خَدَا ح-

Ai që fal namazin, por nuk e thotë El-Fatihanë në të, namazi i tij është i mangët.²⁸

Buhariu dhe Muslimi sjellin rrëfimin e Ubade Ibni Samitit^{ra}, që i Dërguari i Allahut^{savs} tha:

لا صلوة لمن لم يقرأ بفاتحة الكتاب-

"Ai që nuk e thotë El-Fatihanë, nuk i vlerësohet namazi".^{29, 30}

E njëjta gjë rrëfhet nga Ebu Hurejre^{ra} që përmendet në Sahih Ibni Huzejme³¹ dhe në Ibni Hibban.³² (Kurtubiji). Gjithashtu, Ebu Davudi thotë se Hazret Ebu Hurejre^{ra} rrëfen:

أمرني رسول الله ﷺ ان أنادى أنه لا صلوة إلا بقراءة فاتحة الكتاب فما زاد-

“I Dërguari i Allahut^{savs} më urdhëroi të njoftoja që nuk ka namaz pa thënë El-Fatihanë dhe një pjesë tjetër nga Kurani”.³³

Ky ishte edhe mendimi i sahabëve të Profetit Muhammed^{savs}, si Hazret Omeri^{ra}, Abdullah Ibni Abasi^{ra}, Ebu Hurejre^{ra}, Ubej Ibni Ka’b r.a, Ebu Ejub Ensari^{ra}, Abdullah Ibni Amr Ibnil-Asi^{ra}, Ubadah Ibni Samiti^{ra}, Ebu Said Hudriu^{ra}, Othman Ibni Ebil-Asi^{ra}, Hevat Ibni Xhubejr dhe Abdullah Ibni Omer^{ra}.³⁴

Ibni Maxha përmend rrëfimin e Hazret Ebu Seid Hudriut^{ra}, i cili thotë:

قال رسول الله ﷺ لا صلاة لمن لم يقرأ في كل ركعة الحمد و سورة في فريضة أو غيرهما. [ابن ماجه كتاب الصلوة باب القراءة خلف الامام]

I Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Ai që nuk thotë *El-Hamdulil-lah*-in dhe një sure tjetër në çdo rekat, nuk i vlerësohet namazi. Dhe kjo porosi vlen edhe në namazet *farz*, edhe në namazet *jofarz*”.³⁵

Dijetarët e kanë quajtur të dobët këtë rrëfim, por ngaqë sahabët këtë e kanë pasur si praktikë, nuk mund të dyshohet në vërtetësinë e tij.

Një tjetër rrëfim që është ai i Ubade Ibni Samitit^{ra} dhe që gjendet në Sunenin e Ebu Davudit, e mbështet këtë pikë. Nafi Ibni Mahmud Ibnir-Rabi Ensari thotë:

Hazret Ubade Ibni Samiti ishte imami i një xhamie. Njëherë ai erdhi me vonesë dhe Ebu Nuajmi e filloi namazin. Gjatë namazit erdhi edhe Ubade. Edhe unë isha bashkë me Ubaden dhe ne u rreshtuam në namazin që po vijonte. Kur Ebu Nuajmi recitonte El-Fatihanë, dëgjova që edhe Ubade po e recitonte ngadalshëm. Pas namazit e pyeta Ubaden: Përse e thoshe El-Fatihanë gjatë

kohës kur Ebu Nuajmi po e recitonte me zë? Ai m'u përgjigj: "Kështu duhej", dhe shtoi: "njëherë i Dërguari i Allahut^{savs} na udhëhoqi namazin dhe pasi dha selam, na pyeti: Kur recitoj Kuranin me zë në namaz, a e përsëritni edhe ju? Disa thanë po, e disa të tjerë thanë jo. Atëherë i Dërguari i Allahut^{savs} na tha:

لَا تَقْرَأُوا بِسَيِّءٍ مِّنَ الْقُرْآنِ إِذَا جَهَرْتُ بِهِ إِلَّا بِأَمِّ الْقُرْآنِ

"Kur unë recitoj me zë, përveç nënës së Kuranit (El-Fatijasë), mos recitoni asgjë nga Kurani".³⁶

Ka edhe shumë hadithe të tjera në lidhje me këtë. Për shembull, Dare-Kutni në sunenin e tij sjell këtë rrëfim të Jezid Ibni Sherikut^{ra} dhe e quajti të saktë:

سَأَلْتُ عُمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ عَنِ الْقِرَاءَةِ خَلْفَ الْإِمَامِ، فَأَمَرَنِي أَنْ أَقْرَأَ. قُلْتُ: وَإِنْ كُنْتُ أَنْتَ؟ قَالَ: وَإِنْ كُنْتُ أَنَا. قُلْتُ: وَإِنْ جَهَرْتُ، قَالَ: وَإِنْ جَهَرْتُ.

Kam pyetur Omeri ibnil-Hatabin: A duhet ta përsëris El-Fatihanë mbrapa Imamit? Më tha: Po. E pyeta: Edhe atëherë kur ju udhëhiqni namazin? Më tha: Po, edhe kur unë e udhëheq namazin. E pyeta: Edhe kur e recitoni me zë? Më tha: Po, edhe kur e recitoj me zë.³⁷

Edhe Hazret Mesihu i Premtuar^{as} dha të njëjtën *fetva*, që surja El-Fatiha duhet recituar edhe mbrapa imamit, edhe në rast se ai e reciton me zë, përveçse nëse namazfalësi i bashkohet namazit në kohën kur imami është duke bërë *ruku*. Në këtë rast, ai le të thotë *tekbirin* dhe të kalojë në *ruku* dhe recitimi i imamit do të vlerësohet edhe si recitimi i tij. Ky është një përjashtim dhe përjashtimi nuk e thyen ligjin. Gjithashtu, përjashtim është edhe në rastin kur namazfalësi nuk e di El-Fatihanë. Për shembull, nëse ai është musliman i ri që ende nuk e

ka mësuar, ose ende është fëmijë që nuk di të lexojë asnjë pjesë të Kuranit. Namazi i tyre do të jetë i vlefshëm, edhe nëse nuk e thonë El-Fatihane apo ndonjë pjesë tjetër të Kuranit.

Përmbledhje e komentimit të Sures El-Fatiha

Siç është e qartë nga vetë emri i saj, temat e sures El-Fatiha janë si parathënie e Kuranit Famëlartë. Temat e Kuranit janë përmbledhur shkurtimisht në këtë sure, në mënyrë që lexuesi që në fillim të njoftohet për kuptimet e tyre.

Gjithçka fillon me *bismil-lahin* (me emrin e Allahut), që tregon se (1) muslimani beson me bindje në Zotin e Madhërishëm dhe (2) ai gjithashtu beson me bindje që Zoti i Madhërishëm nuk është siç përshkruajnë filozofët, që Ai mund të jetë thjesht shkaku kryesor i krijimit të gjithësisë, por të gjitha çështjet e botës realizohen me urdhrin e Tij, andaj ndihma e Tij është shumë e vyer për njeriun.

(3) *Allahu; Rrahmani; Rrahimi*: Ai nuk është thjesht një forcë sekrete, por është një qenie që ka një emër të përveçëm dhe që ka edhe attribute të ndryshme. (4) I Gjithëmëshirshmi (*Rrahmani*): Ai është burimi i të gjitha përparimeve dhe zotëron të gjitha mjetet që i duhen botës për të ecur përpara. (5) Mëshirëbërësi (*Rrahimi*): Ai e ka krijuar njeriun për të arritur nivele të larta. Nëse ai i përdor siç duhet mjetet që ka krijuar Zoti i Madhërishëm, do të bekohet dhe do të shohë sukses pas suksesi.

(6) Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve (*El-Hamdulil-lahi Rabbil-alemin*): Të gjitha punët e Tij janë të përsosura. Ai është përmbledhje e çdo bukurie dhe përfitues i çdo lavdërimi, sepse gjithçka tjetër përveç Tij, është krijesë e Tij. (7) Zotit të botëve (*Rabbil-alemin*): Askush dhe

asgjë përveç Tij nuk është e tillë që nuk ka një fillim dhe një fund, madje çdo gjë prej tyre nisen nga një gjendje fillestare dhe duke u përparuar arrijnë kulmin e saj. Andaj, Zoti i Madhërishëm është Krijues i gjithçkaje dhe përveç Tij asgjë nuk është e mëvetësishme.

(8) *Rabbil-alemin*: Kjo botë është me larmi të pafundme llojesh dhe karakteristikash dhe Zoti i Madhërishëm trajton çdokënd a çdo gjë sipas aftësive dhe karakteristikave të tij a të saj. Andaj, për të kuptuar një gjë të caktuar, duhet të studiojmë llojin e saj dhe jo tjetër për tjetër. Kështu, nëse vërejmë dallime në sjelljen e Zotit ndaj krijesave të botës, nuk duhet të nxjerrim përfundimin duke keqkuptuar se Zoti është i padrejtë ose i pavëmendshëm, por dallimet ekzistojnë në varësi të situatës së krijesave.

(9) I Gjithëmëshirshmi (*Rahmani*): Zoti është shkaktari i mjeteve, andaj nuk ka gjë në botë që mund të jetë e pavarur nga ndihma e Tij.

(10) Mëshirëbërësi (*Rahimi*): Përveç kësaj, Zoti ka zotësi të plotë edhe mbi rezultatet që dalin nga përdorimi i mjeteve. Për shembull, Ai ka krijuar edhe njeriun, edhe bukën që do të hajë njeriu, që ai e ka të nevojshme për të jetuar. Por, përveç kësaj, edhe gjaku i mirë apo i keq që do të përftohet nga konsumi i ushqimit, gjithashtu vjen me urdhrin e Tij.

(11) Pastaj, Ai ka vendosur një rregullore edhe për shpërblim e ndëshkim. Pra, çdokush do ta shohë një ditë rezultatin e vet të përgjithshëm, në varësi të rrethanave që ai ka pasur. Realisht, punët e njeriut japin dy lloj rezultatesh: një që mund ta quajmë të shpejtë, që vjen si shkak-pasojë e çdo veprimi që bëhet dhe një tjetër, që është

rezultat përfundimtar, i cili shfaqet si pasojë e shumë faktorëve të tjerë. Kështu, Zoti i Madhërisëm jo vetëm që ka lënë sistemin e rezultateve të shpejta siç na del nga emri Mëshirëbërës (*Rrahim*), por ka planifikuar që punët e njeriut të kenë edhe një rezultat të përgjithshëm dhe për këtë arsye ai quhet Sundues i kohës së gjykimit (*Maliki jeumiddin*).

(12) Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë (*Ijjake na'budu ve ijake nes'tain*): Vetëm kjo është Qenia që është e denjë për t'u adhuruar dhe për të pasur dashurinë absolute ndaj Saj. (13) Gjithashtu, këto fjalë tregojnë se zhvillimi i njeriut varet nga dy faktorë: veprat që ai i bën prej gjymtyrëve dhe prej gjendjes së zemrës (në të dytën nënkuptohen, mendimi, besimi, vullneti etj.) Ai ka nevojë t'i përmirësojë që të dy këta faktorë dhe ky përmirësim nuk mund të bëhet pa udhëzimin e Zotit të Madhërisëm.


(14) Na udhëzo në rrugën e drejtë (*Ihdinas-siratal-mustekim*): Zoti Vetë dëshiron të takojë robërit e Tij dhe t'i përmirësojë ata. Ajo që është e nevojshme është dëshira e robit për t'iu përlurur Atij dhe për t'i kërkuar takim me Të. (15) Më pas, El-Fatiha tregon se, mund të të duken shumë rrugë që të çojnë drejt Zotit, por nuk është e mjaftueshme vetëm njohuria për rrugën e Tij, madje: (a) rruga e drejtë *siratal-mustekim*: ajo rrugë duhet të jetë sa më e shkurtër, në mënyrë që njeriu të mos shkatërrohet vetëm gjatë rrugës. (b) në rrugën e atyre që i bekove (*Siratal-ledhine en'amte 'alejhim*): Ajo rrugë duhet të jetë e provuar, të cilën duke e ndjekur, njerëzit ta kenë arritur Zotin edhe në të kaluarën. Robi të njoftohet paraprakisht për rreziqet që mund t'i

dalim gjatë rrugës dhe për zgjidhjet e tyre, në mënyrë që të ketë qetësinë e duhur dhe të mos dëshpërohet. Gjithashtu, ai të ketë shoqërinë e mirë për këtë rrugë. Një rrugë të tillë duhet t'ia kërkojë Zotit.

(16) Jo në rrugën e atyre që tërhoqën zemërim (*Gajril-magdubi 'alejhim*): Pasi të ketë arritur suksese dhe përparime, robi duhet të ruhet nga ndjenjat etnocentrike dhe vetëpëlqyese, sepse ato e shkatërrojnë sërish. Gjithashtu, përparimet e tij, të mos i marrë si mundësi për të bërë padrejtësi e dhunë, por për t'u shërbyer të tjerëve dhe për të vendosur paqe, dhe për këtë vazhdimisht t'i lutet Zotit.

(17) E as të atyre që devijuan (*Veled-dal-lin*): Pas përparimeve, njeriu ashtu siç mund të kalojë në padrejtësi, mundet që ai t'i japë vlerë, mëshirë dhe dashuri të tepruar dikujt a diçkaje të caktuar. Ai duhet të ruhet edhe nga kjo praktikë dhe edhe për këtë, vazhdimisht t'i lutet Zotit.





Bismil-lāhīrr-Rrahmānīrr-Rrahīm

“Me emrin e Allahut (lexoj), të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit”.
(El-Fatiha 1:1)

Kuptime leksikore:

باء *ba*

Ba-ja është bashkëtingëllorja dhe shkronja e dytë e gjuhës arabe. *Ba*-ja që vjen në بِسْمِ اللَّهِ *Bismil-lah* nuk është bashkëtingëllore e thjeshtë, por është një prej bashkëtingëlloreve që kanë kuptim. Në arabisht ka disa shkronja, të cilat japin edhe kuptime dhe *ba*-ja është njëra prej tyre. Ajo jep kuptimet e shoqërimit dhe të kërkimit të ndihmës. Pra, fjalë për fjalë, ajo përkthehet: “me”, “prej”. Del kuptimi: *Lexoj këtë vepër duke u lidhur me Zotin e Madhërishëm dhe duke kërkuar ndihmë prej Tij*.

Në arabisht, *ba*-ja është një prej parafjalëve të quajtura *xhārrah* dhe emrave që u paravendosen këto parafjalë, në fund të tyre ata marrin zanoren i. Në gjuhën arabe, shpesh ka ndonjë fjalë të pathënë e të nënkuptuar përpara emrave të tillë, të cilën duhet ta nxjerrim në varësi të kontekstit. Për shembull, disa dijetarë thonë se në këtë ajet, përpara parafjalës *ba*, vjen folja urdhërore اِفْرَأْ أَوْ اِشْرَعْ *lexo ose fillo* dhe arsyeya është ajeti i sures El-Alak:

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

"Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi".³⁸

Pra, nënkuptohet e njëjta fjalë ose e ngjashme, që është përmendur në ajetin e mësipërm. Zamakhsheri, në vend të urdhërores, mendon që foljet e nënkuptuara duhet të jenë në të tashmen e mënyrës dëftore, pra: اقْرَأْ أَوْ اِشْرَعْ *lexoj a filloj*. Gjithashtu, sipas tij, këto folje e kanë vendin pas *Bismil-lah* e jo përpara saj, pra: *Me emrin e Allahut lexoj*. Duke arsyetuar mendimin e tij, ai thotë se me vendosjen e foljes së nënkuptuar në fund të frazës, theksi bie mbi fjalën *Allah*, kurse nëse do t'ia vendosësh para, theksi bie mbi foljen *lexoj*.³⁹

Ky interpretim i Zamakhseriut është i bukur, andaj, këtë e kam ndjekur edhe unë në përkthimin tim. Por, folja *lexo*, në suren El-Alak vjen para. Duke iu përgjigjur kësaj, Zamakhsheri thotë se në ajetin në fjalë theksi duhet të binte mbi foljen, sepse Profeti Muhammed^{sav} po ngurronte nga leximi. (Buhariu). Kurse në *Bismil-lah* theksi nuk duhet të bjerë mbi foljen, por mbi emrin e Allahut. Edhe ky interpretim i tij është mjaft i bukur dhe është në mbështetje të argumenteve që kam dhënë në përsëritjen e *bismil-lahit*.

إِسْم *ism*

Fjala *bismi* بِسْمِ është e përbërë nga *ba* dhe *ismun*. Zanorja *elif* e *ism*-it bie gjatë bashkimit dhe u bë *bismi*. Në arabisht, në disa raste, zanorja *elif* nuk shqiptohet dhe ajo quhet *vesli*. Por, në *bismil-lah* ajo as nuk është e shkruar. Gramatikanët arabë thonë se kjo ndodhi për shkak të përdorimit të shpeshtë. Kisai dhe Ahfeshi thonë se *elifi* i fjalës *ism* nuk shkruhet para asnjërit prej emrave të Allahut, por El-Ferrai thotë se

rënia e *elifit* është e provuar dhe e dokumentuar vetëm në rastin konkret, andaj, sipas tij, *elifi* i *ism*-it nuk shkruhet vetëm para emrit Allah, kurse para emrave të Tij të tjerë do të shkruhet.⁴⁰

إسم *ism* do të thotë cilësi, emër.⁴¹ Ajo nuk ndërtohet nga shkronjat *elif*, *sin* dhe *mim*, por nga *vav*, *sin* dhe *mim* ose *sin*, *mim* dhe *vav*. *Vav* u shndërrua në *elif*.

Ata që thonë se shkronjat burimore të kësaj fjale janë *vav*, *sin* dhe *mim*, nxorën kuptimin e shenjës, sepse *vesmun* do të thotë shenjë. Kurse ata që përcaktuan *sin*, *mim* dhe *vav*, thonë se kuptimi i kësaj fjale është: *me u lartësue*.⁴²

الله *Allahu*

Allah është emri i Atij që është i Përherhshëm dhe i Përjetshëm. Ai është i Gjallë, i Qëndrueshëm, Sundues dhe është Krijuesi, Zoti dhe Rritësi i të gjitha krijesave.

Emri Allah nuk është i përbërë

Allah nuk është mbiemër, por emër i përveçëm. Përveç arabishtes, asnjë gjuhë tjetër nuk ka një emër të përveçëm për Zotin, për Krijuesin dhe Sunduesin e Gjithësisë. Kurse në arabisht, emri Allah i referohet vetëm Krijuesit të Gjithësisë. Po ashtu, fjala Allah është fjalë e parme dhe jo e përbërë. Ajo as nuk rrjedh nga ndonjë fjalë tjetër dhe as nuk rrjedhin fjalë të tjera prej saj.

Disa thonë se fjala "Allah" është e përbërë nga لاه *laha-jelibi*, që do të thotë i padukshëm, i lartë,⁴³ por kjo nuk është e saktë. Kurse disa të tjerë thonë se ajo rrjedh nga لا اله *lahe-jeluhu*, kuptimi i së cilës është

shkëlqim. Sipas tyre لا اله الا الله do të thotë *Allahu i krijoi krijesat*.⁴⁴ Por, në Lisanul-arab⁴⁵ thuhet se ky kuptim është i panjohur. Andaj, ky mendim nuk mund të jetë i pranueshëm.

Disa të tjerë thonë se Allah është një fjalë e huaj në arabisht. Sipas tyre ajo rrjedh nga لاها *laha* e surjanishtes (një gjuhë e vjetër e Sirisë), por edhe kjo është e pasaktë, madje një mendim i tillë vjen për shkak të mosnjohjes së gjuhës surjane. Shkencëtarët evropianë thonë se fjala arabe *ilah* (i adhuruar) është më afër rrënjës fillestare. Shkencëtari gjerman Noldeke thotë se الله *ilah* e arabishtes dhe ايل *il* e hebraishtes ecin paralelisht prej shumë kohërave. Kjo fjalë përdorej në gjuhët semite edhe përpara kohës kur gjuha hebraike u nda nga arabishtja.⁴⁶

الرَّحْمَنُ *Err-Rrahman* (i Gjithëmëshirshmi)

Rrjedh nga fjala رحم *rrahm* dhe është në *veznin fa'lānun*. Emrat që vijnë në këtë *vezn*, kanë kuptimin e mbushjes e të mbizotërimit.⁴⁷ Andaj, *rrahman* do të thotë mëshirë e pakufishme që mbizotëron çdo gjë. Mëshira është ajo që bëhet pa këmbim të diçkaje dhe pa detyrime, sepse jo çdo njeri me të drejtë mund të kërkojë mëshirën.

الرَّحِيمُ *Err-Rrahim* (Mëshirëbërësi)

Edhe kjo rrjedh nga fjala رحم *rrahm* dhe është në *veznin feilun*, që zakonisht kanë kuptimin e përsëritjes dhe të sjelljes në bazë të një kriteri të caktuar.⁴⁸ Andaj, kuptimi i këtij emri është Ai që i shpërblen në mënyrën më të mirë atij që meriton mëshirën dhe vazhdimisht e mëshiron atë.

Gramatikani i shquar i gjuhës arabe imam Ebu Ali El-Farisiu thotë:

الرحمن إسم عام في جميع أنواع الرحمة، يختص به الله تعالى، والرحيم إنما هو من جهة المؤمنين، قال تعالى: وَكَانَ بِالْمُؤْمِنِينَ رَحِيمًا.

Err-Rahman është emër i përgjithshëm, që mbulon çdolloj mëshire dhe i referohet vetëm Zotit të Madhërishëm. Kurse *Err-Rrahim* është mëshira e Tij ndaj besimtarëve. (Pra, mëshira e *Rrahimit* është për mirëbërësit). Siç e thotë në Kuran: “Ai është Mëshirëbërës (*Rrahim*) ndaj besimtarëve” (El-Ahzab 33:44).⁴⁹

Abdullah Ibni Mesudi^{ra} dhe Ebu Seid Hudriu^{ra} rrëfen:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ الرَّحْمَنُ رَحْمَنُ الدُّنْيَا. وَالرَّحِيمُ رَحِيمُ الْآخِرَةِ.

I Dërguari i Allahut^{savs} tha: “*Err-Rahman* është mëshira ndaj botës. *Err-Rrahim* është mëshira ndaj ahiretit”.⁵⁰

Edhe kjo tregon se *Rrahmani* është ajo mëshirë që bëhet pa e kërkuar dhe pa kushtëzime, sepse mëshirë e tillë e Zotit vepron vazhdimisht në këtë botë. Kurse *Rrahimi* i referohet asaj mëshire që vjen në formë shpërblimesh të mëdha ndaj veprave të mira, sepse ahireti është vend shpërblimi.

Komentim

Bismil-lahi në krye të çdo sureje është shkruar sipas shpalljes së Zotit

Të gjitha *suret* e Kuranit fillojnë me بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*, përveç sures Bera’et (Et-Teube), por pohimi më i saktë rreth saj është që ajo nuk është sure më vete, por është pjesë plotësuese e sures El-Enfal, andaj, ajo nuk fillon me *bismil-lah* të ri.

Në Sunenin e Ebu Davudit përmendet një rrëfim nga Abdullah Ibni Abasi^{ra}, i cili thotë:

أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ لَا يَعْرِفُ فَصَّلَ السُّورَةَ حَتَّى يُتْرَلَ عَلَيْهِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ-

“Pa zbritjen e *bismil-lahit*, i Dërguari i Allahut^{savs} nuk e quante shpalljen si sure të re”.⁵¹

Pra, pas përfundimit të një sureje, surja e re fillonte të zbritej me zbritjen e *bismil-lahit*. Këtë rrëfim e sjell edhe Hakimi në *Mustedrekun* e tij.⁵²

Ky hadith tregon se para çdo sureje të re, zbriste *bismil-lahi* dhe fundi i sures së vjetër kuptohej vetëm kur zbriste *bismil-lahi* i një sureje të re. Andaj, kur nuk zbriti *bismil-lahi* para sures Bera’et, nënkuptohet që ajo nuk është ndonjë sure e re, por është pjesë e sures El-Enfal.

Ky hadith gjithashtu provon se *bismil-lahi* që përmendet para çdo sureje, çdo herë ishte shpallur prej Zotit dhe si i tillë, ai është pjesë e Kuranit dhe jo diçka shtesë.

Rreth *bismil-lahit* disa dijetarë menduan se ai nuk është pjesë e çdo sureje, por vetëm e sures El-Fatiha, ndërsa disa të tjerë thanë se ajo nuk është pjesë e asnjërës prej sureve të Kuranit. Por kjo nuk është e saktë. Këtë e hedh poshtë, në radhë të parë, hadithi që u citua më lart. Së dyti, ka shumë hadithe të tjera, në të cilat i Dërguari i Allahut^{savs} *bismil-lahin* e quajti si pjesë të sureve të Kuranit. Për shembull, lidhur me faktin se ai është pjesë e sures El-Fatiha, Darekutniu sjell një rrëfim nga Ebu Hurejre^{ra}, i cili thotë:

إِذَا قَرَأْتُمُ الْحَمْدَ فَاقْرَءُوا بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ، إِنَّهَا أَمُ الْقُرْآنِ، وَأَمُ الْكِتَابِ، وَالسَّعِ الْمَثَانِي، وَبِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ إِحْدَى آيَاتِهَا.

I Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Kur recitoni *El-Hamdulil-lab-in*, thoni edhe *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*, sepse El-Fatihaja

është nëna e Kuranit, nëna e Librit dhe Shtatëvargëshi i përsëritur, ndërkohë *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim* është njëri prej ajeteve të saj”.⁵³

Këtë rrëfim e ka sjellë edhe Imam Buhariu në librin e tij “Tarikh”.⁵⁴

Argumente që *bismil-lahi* është pjesë dhe ajet i çdo sureje

Ky hadith tregon se *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim* është pjesë jo vetëm e sures El-Fatiha, por edhe e sureve të tjera, sepse i Dërguari i Allahut^{savs} nuk tha vetëm se *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim* është pjesë e El-Fatihës, por dha argumentin se përse ai është pjesë e saj, duke thënë se El-Fatiha është nëna e Kuranit. Ky argument vlen edhe për të provuar se *bismil-lahi* është pjesë e sureve të tjera gjithashtu. Me fjalë të tjera, pohimi i të Dërguarit të Allahut^{savs} nënkupton se kur *bismil-lahi* është pjesë e sureve të tjera, përse nuk mund të jetë edhe pjesë e El-Fatihës, e cila është nëna e Kuranit.

Ka edhe argumente të tjera që e provojnë këtë fakt. Për shembull, në Sahihun e Imam Muslimit përmendet:

عن أنس قال، قال رسول الله ﷺ أنزلت على سورة أنفأ فقرأ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكُؤُورَ.

Enesi^{ra} rrëfen: I Dërguari i Allahut^{savs} tha: Sapo më zbriti një sure e re e cila është “*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim. In-na a’tajnakel-keuther*”.⁵⁵

Pra, i Dërguari i Allahut^{savs} e cilësoi ajetin *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim* si pjesë të sures El-Keuther. Rrëfime të ngjashme ka edhe për disa sure të tjera.

Dikush mund ta kundërshtojë këtë rrëfim duke thënë se kjo sure është mekase, ndërsa Enesi^{ra} është medinas dhe ishte 8 ose 9 vjeç. Ndërkohë, fjalët e hadithit të japin përshtypje sikur i Dërguari i Allahut^{savs} t’i ketë thënë këto fjalë menjëherë pas zbritjes së sures. E nëse kjo është e vërtetë, si ka mundësi që Enesi^{ra} t’i ketë dëgjuar këto fjalë?

Po të mos kishim prova të tjera mbështetëse të këtij hadithi, akuza e mësipërme pa dyshim që do ta dobësonte autenticitetin e tij. Por prania e provave të tjera e zhvlerëson akuzën. Në fakt, sahabët rrëfenin ngjarje të caktuara, nganjëherë, duke i dëgjuar edhe nga sahabët e tjerë. Të gjithë dijetarët e pranojnë që një hadith i caktuar, kur rrëfhet nga ndonjë sahab quhet i saktë, sepse për asnjë sahab të Profetit^{savs} nuk provohet që ai të ketë gënjer. Nëse Enesi^{ra} ia referon këtë thënie Profetit Muhammed^{savs}, me siguri ai duhet ta ketë dëgjuar nga ndonjë sahab muhaxhir. Andaj, mëdyshja në këtë hadith nuk qëndron.

Disa njerëz mendojnë se *hanefitë* (ndjekësit e Imam Ebu Hanifes) besojnë se *bismil-lahi* nuk është pjesë e Kuranit Famëlartë. Por, kjo është e pavërtetë. Imam Ebu Hanife nuk besonte kështu, përkundrazi, besonte që *bismil-lahi* është një ajet i mirëfilltë, por nuk është pjesë e sures.

Imam Ebu Bekr Razi që është njëri prej imamëve të hanefive, në pjesën e parë të librit të tij “Ahkamul-Kuran”, shkruan:

وَمَا ثَبَّتَ أَنَّهَا لَيْسَتْ مِنْ أَوَائِلِ السُّورِ وَأَنَّ كَانَتْ آيَةً فِي مَوْضِعِهَا عَلَى وَجْهِ الْفَصْلِ بَيْنَ السُّورَتَيْنِ أَمَرْنَا بِالْإِبْتِدَاءِ بِهَا تَبَرُّكًا.

"Ngaqë u provua se ky ajet nuk është pjesë e ndonjë sureje, por është ajet i mirëfilltë që tregon ndarjen e dy sureve, jemi porositur ta themi për bekim përpara se të fillojmë namazin".⁵⁶

Andaj, është vetëm padituri e atyre që thonë se *hanefitë* nuk e cilësojnë ajetin *bismil-lah* si pjesë të Kuranit. Pa dyshim që ata nuk e cilësojnë atë si pjesë të ndonjë sureje, por si pjesë të Kuranit patjetër që e cilësojnë. Megjithatë, sipas meje, edhe ky besim i tyre nuk është i saktë, sepse e vërteta është që *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim* është pjesë e çdo sureje të Kuranit dhe, siç do të provohet në vazhdim, vendosja e këtij ajeti përpara çdo sureje është bërë me shumë urtësi.

Rëndësia e *bismil-lahit*

I Dërguari i Allahut^{savs} i dha rëndësi të veçantë *bismil-lahit*. Ai thotë:

كَلَّ امر ذى بال لا يُبدأ فيه بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ اقطع.

"Çdo punë e rëndësishme që nuk fillon me *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*, është e pabekuar".⁵⁷

Vetë praktika e të Dërguarit të Allahut^{savs} na kërkon që të fillojmë çdo punë me *bismil-lahin*. Në një hadith përmendet:

أغلق بابك واذكر اسم الله عز وجل فإن الشيطان لا يفتح بابا مغلقا وأطفئ مصباحك واذكر اسم الله وخمر إناءك ولو يعود تعرضه عليه واذكر اسم الله وأولك سقاءك واذكر اسم الله عز وجل.

"Thuaj *bismil-lah* kur mbyll derën, sepse djalli nuk e hap një derë (të tillë) të mbyllur. Thuaj *bismil-lah* kur shuan llambën; kur i vë kapakun enës; kur i vë tapën shishes".⁵⁸

Gjithashtu, në hadithe të tjera thuhet që duhet të thuash *bismil-lah* duke shkuar te bashkëshortja, duke marrë abdes, duke ngrënë bukë, duke hyrë në banjë, duke u veshur etj.

Në Kuran flitet për një letër të Hazret Sulejmanit^{as}, që ai e kishte shkruar me *bismil-lah*. Ajeti i Kuranit thotë:

إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

“Pa dyshim, ajo (letër) është prej Sulejmanit dhe ajo është me *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*”.⁵⁹

Edhe për Hazret Nuhun^{as} përmendet në Kuranin Famëlartë që ai kishte porositur shokët e tij të anijes të luteshin duke thënë *bismil-lahin*:

بِسْمِ اللَّهِ مَجْرَاهَا وَمُرْسَاهَا إِنَّ رَبِّي لَغَفُورٌ رَحِيمٌ

“Hipni në të dhe thoni: me emrin e Allahut është nisja e saj dhe qëndrimi i saj”.⁶⁰

Përse *bismil-lahi* vjen para çdo sureje? Ja, pesë arsye

Bismil-lahi vjen para çdo sureje, sepse Kurani Famëlartë pohon se ai është një thesar, të cilin njeriu nuk mund ta hapë pa i kërkuar leje Allahut të Madhërishëm:

لَا يَمْسُهُ إِلَّا الْمَطْهُرُونَ

“Atë nuk mund ta prekë askush, përveç atyre që janë të pastruar”.⁶¹
Pra, përveç atyre që i ka zgjedhur Zoti i Madhërishëm, të tjerët nuk mund t’i zbulojnë sekretet e Kuranit Famëlartë. Allahu i Madhërishëm gjithashtu thotë:

يُضِلُّ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ كَثِيرًا

“Ai, nëpërmjet Kuranit, shumë njerëz i devijon dhe shumë të tjerë i udhëzon”.⁶²

Pra, në shkrim dhe në fjalë Kurani është njësoj për të gjithë, por në efekte është ndryshe. Lind pyetja: Çfarë duhet të bëjmë për ta zbuluar këtë thesar, për të pasur efekt pozitiv të tij dhe për t’iu shmangur efektit të tij negativ? Përgjigjen e jep vetë Kurani, duke na porositur:

فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ

“Kur të recitoni Kuranin kërkojini mbrojtjen Allahut”⁶³, dhe gjithashtu, duke vënë *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim* para çdo sureje. Kjo do të thotë se para se të recitojmë Kuranin, së pari duhet t’i lutemi Zotit që të na mbrojë nga sulmet e djallit dhe së dyti, t’i kërkojmë ndihmë nëpërmjet attributeve të tij, I Gjithëmëshirshëm (*Rrahman*) dhe Mëshirëbërës (*Rahim*). Në këtë mënyrë ne do të shpëtojmë nga devijimi dhe do të gjejmë udhëzimin.

Arsyeja e dytë – argumentim ndaj hebrenjve dhe të krishterëve Ka edhe një arsye tjetër që tregon se përse *Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim* vjen para çdo sureje, e cila është që në Bibël përmendet një profeci për ardhjen e një profeti të ngjashëm me Musain^{as}, ndaj të cilit Zoti do të kishte një sjellje të veçantë. Bibla thotë:

“Unë do të nxjerr për ta një profet nga gjiri i vëllezërve të tyre dhe do të vë në gojën e tij fjalët e mia, dhe ai do t’u thotë atyre të gjitha ato që unë do t’i urdhëroj. **Dhe do të ndodhë që, nëse**

dikush nuk i dëgjon fjalët e mia që ai thotë në emrin tim, unë do t’i kërkoj llogari”.⁶⁴

Sipas kësaj profecie, për të ngjashmin e Musait^{as} ishte caktuar që sa herë që ai do të sillte fjalët e Allahut të Madhërishëm, do të pohonte shprehimisht “*Unë këtë po jua them në emër të Zotit të Madhërishëm dhe jo nga ana ime*”. Pra, kjo profeci kërkonte që çdo sure e Kuranit të fillonte me *bismil-labin*, në mënyrë që të përmbushej profecia e Hazret Musait^{as} në njërën anë dhe, në anën tjetër, t’u jepej argument hebrenjve dhe të krishterëve se ata që nuk do ta dëgjonin këtë libër, sipas shpalljes së Musait^{as}, do të tërhiqnin ndëshkimin e Zotit.

Arsyeja e tretë – vërtetësia e Profetit Muhammed^{savs}

Arsyeja e tretë se përse ky ajet është vendosur para çdo sureje, është përsëri një thënie e Biblës, që thotë:

“Por profeti që pretendon të thotë në emrin tim një gjë për të cilën unë nuk e kam urdhëruar ta thotë, ose që flet në emër të perëndive të tjera, ai profet do të vritet”.⁶⁵

Sipas këtij vargu biblik, çdokush që gënjen në emër të Zotit duke thënë se është i dërguar, Zoti do ta shkatërrojë atë. Me *bismil-labin* para çdo sureje, hebrenjtë dhe të krishterët në veçanti dhe të gjithë të tjerët në përgjithësi ballafaqohen me argumentin se suksesi dhe përparimi i Profetit Muhammed^{savs} edhe pas ekzistencës së një ligji të tillë të Zotit, tregon se çdo gjë që tha ai, ishte prej Zotit të Madhërishëm. Përndryshe, ai duhej shkatërruar. Shkurt, duke sjellë *bismil-labin* para çdo sureje, sidomos hebrenjtë janë cilësuar plot 114 herë si fajtorë, dhe po aq herë Profeti Muhammed^{savs} është cilësuar si profet i vërtetë. Po

të ishte *bismil-labi* vetëm në fillim të Kuranit, nuk do të sigurohej ky përfundim.

Arsyeja e katërt – udhëzim për lexuesit e Kuranit

Arsyeja e katërt e vendosjes së *bismil-lahit* para çdo sureje është reformuese. Lexuesi i Kuranit duhet të jetë në njërën prej tri gjendjeve: ai mund të jetë krejtësisht në padijeni, ose mund të ketë provokuar zemërimin e Zotit të Madhërishëm për shkak të ligësive që ka bërë dhe si i tillë mund të jetë i privuar nga ndonjë shtytje për t'i kërkuar bekimin Allahut, ose mund të jetë sakrifikues në rrugën e besimit.

Që të tre duhet të kenë ndjesi të ndryshme para se të lexojnë Kuranin. I pari mund të jetë i hutuar, i dyti i zhgënjyer dhe i treti mund të mburret për atë që ka bërë. I pari do të jetë i hutuar sepse nuk do të kuptojë se ku mund të gjejë të vërtetën. I dyti do të jetë i zhgënjyer dhe i brengosur sepse nuk do të ketë fytyrë t'i kërkojë Zotit. Dhe i treti mund të jetë i ndikuar nga mendimi se ka arritur gjithçka që kishte për të arritur.

Të tria këto gjendje të zemrës, e privojnë njeriun që të përfitojë nga Kurani. Prandaj, në krye të çdo sureje është vendosur *Bismil-lahirrrahmanirrrahim*, në mënyrë që i padituri të udhëzohet se ekziston një Zot që bekon njerëzit, pa pasur në këmbim ndonjë vepër prej tyre. I humburi për shkak të veprave të liga që ka bërë, të ngushëllohet se nuk ka nevojë të zhgënjehet, sepse Ai Zot që ka zbritur këtë sure, është i gatshëm t'i falë të gjitha mëkatet. Kurse të tretit, që është krenar për sakrificat e tij, i është tërhequr vërejtja që thesaret e mëshirës së Zotit

janë të pakufishme dhe se ai si kërkimtar, nuk duhet të ndalet në asnjë vend, sepse edhe përparimet janë të pakufishme.

Kuptimet e Kuranit që mund t'ju hapen pas një reforme të tillë të zemrës, nuk mund t'ju vijnë përpara saj. Andaj, duke e vendosur këtë ajet para çdo sureje, Zoti i Madhërishëm na mundësoi një mjet shumë të fuqishëm për të zbuluar kuptimet e Kuranit.

Arsyeja e pestë – çelësi i çdo sureje

Arsyeja e pestë se përse ky ajet është vendosur përpara çdo sureje është sepse ky është çelësi i çdo sureje. Të gjitha çështjet fetare e shpirtërore vërtiten rreth dy attributeve të Zotit, që janë i Gjithëmëshirshëm (*Rrahman*) dhe Mëshirëbërës (*Rrahim*). Mundësia e keqkuptimit ekziston në dy rrafshe: 1) keqkuptimi që del nga shpjegimi dhe 2) keqkuptimi që del nga përmbledhja. Ndaj, Zoti i Madhërishëm përpara çdo sureje ka vendosur *bismil-lahin*, në mënyrë që për çdo kuptim që nxjerr lexuesi, ta analizojë atë nëse përputhet me atributet "i Gjithëmëshirshëm" dhe "Mëshirëbërës" apo jo. Nëse kuptimi që nxjerr lexuesi, përputhet me këto dy attribute, le ta pranojë, e nëse jo, le ta refuzojë. Në këtë mënyrë, *bismil-lahi* është përmbledhja dhe surja është shpjegimi i tij dhe të dyja bashkërisht, i japin lexuesit një vizion të qartë për kuptimet e tyre.

Rreth *bismil-lahit* në Librat e mëparshëm dhe përgjigja e një akuze

Disa jomuslimanë akuzojnë: *Bismil-lahi* për të cilin ju krenoheni, gjendet edhe në librat e tjerë. Për shembull, në literaturën e Zarathustrës, thuhet:

بنام یزدان بخشائش گردا وار

Në persishten e re, kjo është përkthyer si vijon:

بنام خداوند بخشاینده بخشائش گر

(Komentimi nga Revrend Very)

Ose thonë se edhe hebrenjtë kanë pasur traditën e *bismil-lahit* dhe nga ata ai ka hyrë edhe tek arabët dhe i pari që e futi në traditën arabe, ishte kryetari i Taifit.⁶⁶

Duke iu përgjigjur Rodwellit, duhet thënë se kjo është plotësisht e pavërtetë. Arabët nuk kanë pasur traditën e *bismil-lahit* të tillë. Madje, ata nuk dëshironin as ta përmendnin atributin *Rrahman* (I Gjithëmëshirshëm). Pra, pretenduesit kanë për detyrë të paraqesin argumentin historik, gjë që nuk ekziston.

Për sa i përket akuzës ku thuhet se edhe hebrenjtë e kanë pasur si traditë *bismil-lahin*, duhet sqaruar se nëse pretendohet që hebrenjtë e kohës së Profetit Muhammed^{savs} ose të një kohe të afërt me të, e përmendnin *bismil-lahin*, ose historia e tyre e dëshmon këtë, kjo absolutisht nuk është e vërtetë. Por, nëse pretendohet që vetë Sulejmani^{as} e përmendi *bismil-lahin* në letrën e tij, atëherë një akuzë e tillë vjen nga mungesa e sinjeritetit, sepse përdoret referenca e Kuranit për ta akuzuar Kuranin. Dihet që Kurani Famëlartë thotë që në letrën që Hazret Sulejmani^{as} ia kishte dërguar mbretëreshës së Sebas, kishte shkruar edhe këtë fjali:

إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

“Kjo është prej Sulejmanit dhe kjo është me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit”.⁶⁷

Pas kësaj dëshmie, vetë akuza e tyre mbetet e pakuptimtë. Islami nuk pretendon se tema e këtij ajeti është paraqitur vetëm nga ai. Emrat si *Allah, Rrahman, Rrahim* etj. ekzistojnë edhe para Islamit dhe përdoren. Ajo që pretendon Islami është që përdorimi i këtij ajeti, siç është në Islam, nuk gjendej më parë. Nëse kundërshtarët e Islamit paraqesin ndonjë dëshmi që e rrëzon këtë fakt, pa dyshim që do t'i kushtojmë rëndësi një dëshmie të tillë, por ekzistenca e saj është e pamundur. Sepse nuk ka ekzistuar asnjë libër përpara Kuranit Famëllartë që ka pretenduar se çdo fjalë e tij të jetë prej Zotit të Madhërishëm. Andaj, përveç Kuranit Famëllartë, asnjë libër qiellor nuk meritonte që përpara çdo kapitulli të tij, të thuhej një fjali e tillë.

Për sa i përket përmendjes së emrave të Zotit për bekim në fillim të ndonjë letre ose ndonjë teme, kjo natyrisht që praktikohej. Këtë nuk e mohojnë as Islami e as muslimanët. Si muslimanët, ashtu edhe shumë jomuslimanë e kanë pasur këtë si traditë.

Kështu, një përgjigje e akuzës së ngritur nga Revrend Veri u shënua më lart. Përgjigja e dytë është që të dyja thëniat ndryshojnë kuptimisht kaq shumë, sa që vetëm ai që nuk njeh gjuhën arabe mund t'i quajë të njëjta. Fjalët بخشايش گر “*bakhshaesh ger*” dhe داوار “*darvar*” nuk kanë as një të njëzetën e kuptimeve të fjalëve *Rrahman* dhe *Rrahim* (siç do të lexoni në komentim të kësaj sureje në vazhdim), ndonëse nuk e mohoj

bukurinë e kësaj thënieje. Islami pohon që të gjithë popujt e mëparshëm kanë pasur ndonjë profet. Sa qartë e thotë këtë:

وَإِنْ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ

"Në çdo popull ka ardhur alarmues".⁶⁸

Pas këtij fakti, nëse do të gjeni ndonjë thënie të bukur në librat e fesë së Zarathustrës, përse mund t'u vijë keq muslimanëve? Vetëm Revrend Verit dhe bashkëfetarëve të tij mund t'u vijë keq, të cilët e kanë bërë monopol bekimin e Zotit të Madhërishëm dhe thanë se nuk ka asnjë shenjë profetësie (*nuburvet*) apo shpalljeje, jashtë gjirit të bijve të Izraelit! Kurse nga këndvështrimi i Islamit, Zarathustra është profet i Zotit dhe si i tillë, ne atij i bëjmë plot nderime, sepse burimi i fjalës së tij është i njëjti me Kuranin. Andaj, ngjashmëritë dhe përputhjet midis tyre, nuk janë aspak të çuditshme.

Emri Allah është i përveçëm

Në kuptimet leksikore thamë që për fjalën "allah", disa njerëz mendojnë se është e përbërë, por e provuam se ky mendim është i gabuar dhe se gjuhëtarët arabë e rrëzojnë këtë. Kështu, Sibevejhi dhe Halili [El-Halil Bin Ahmedi] thonë se emri "allah" është i përveçëm (*alem*) dhe nuk është e prejardhur nga ndonjë fjalë tjetër.⁶⁹

Duke dhënë argumente për këtë pohim, dijetarë të ndryshëm thanë se (1) fjala "allah" nuk është përdorur ndonjëherë për asnjë qenie tjetër përpos Allahut të Madhërishëm. Madje, edhe idhujtarët arabë nuk e përdornin këtë fjalë për ndonjë idhull a zot tjetër të tyre. Fjala "allah", po të vinte me bashkimin e *elif*, *lam* dhe *ilah* ose *elif*, *lam* dhe *lehu*,

atëherë ashtu siç përdoren këto fjalë edhe për qenie të tjera, edhe "allah" do të përdorej. Por, arabët asnjëherë nuk kanë vepruar kështu.

(2) Cilësitë e Allahut gjithmonë janë përdorur si attribute të Tij, por emri Allah asnjëherë nuk është përdorur si atribut. Kjo pikërisht është shenjë që fjala "allah" është emër i përveçëm.

Disa thonë se në ajetin vijues të sures Ibrahim, Allahu është përdorur si atribut:

صِرَاطَ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ۝ اللَّهُ

"... drejt rrugës së të Plotfuqishmit, të Lavdëruarit, Allah".⁷⁰

Por kjo nuk është e saktë. Këtu fjala "allah" nuk është si atribut, por si një variant i enumeracionit. Në arabisht, lejohet përdorimi i tillë i emrave të përveçëm. Për shembull, thuhet:

هَذِهِ الدَّارُ مِلْكٌ لِلْعَالِمِ الْفَاضِلِ زَيْدٍ

Kjo shtëpi është pronë e dijetarit, të shkolluar, Zejd.

Në fakt, përdorimi i emrit të përveçëm në raste të tilla është për të larguar dyshimin dhe kuptimi i ajetit konkret është që atributet "i plotfuqishmi" dhe "i lavdëruari", i referohen Allahut dhe jo dikujt tjetër.

Disa thonë se ajeti:

وَهُوَ اللَّهُ فِي السَّمَوَاتِ وَفِي الْأَرْضِ

"Ai Allah është në qiej e në tokë"⁷¹

tregon se emri Allah nuk është i përveçëm, por është cilësues.

Përgjigjja është që kur një emër shquhet me cilësitë e tij, ai përdoret edhe si emër cilësues. Sikundër emrat Hatim, Rustem që janë emra të individëve të caktuar, ku i pari shquhet për bujarinë dhe i dyti për trimërinë dhe tanimë njerëzit personin bujar e thërrasin hatim dhe një që është trim, e thërrasin rustem. Në të njëjtën mënyrë, ngaqë emri Allah shënjon një Qenie të përsosur me gjithë cilësitë e Tij, lejohet të themi se është po Ai Allah në qiell, pra Ai që është i Përsosur në të gjitha cilësitë e Tij dhe është i Vetëm e askush tjetër nuk është ortak as në emrin e as në punën e Tij.

Shkronjat *elif* dhe *lam* të fjalës “Allah” janë të temës e jo shtesa

Disa thonë se fjala Allah është në formën (*veznin*) فَعَالٌ “*fe’a-‘alun*”, ndaj duhet të kishte shenjën e pashquarsisë (*tenvin*) dhe ngaqë nuk e ka, rezulton që *elif lam* ose *el* janë ato të shquarsisë. Pra, sipas tyre, shkronjat *elif* dhe *lam* të kësaj fjale nuk janë të veta, por shtesa dhe kështu, emri Allah është i përbërë.

Përgjigjja e saj është që çdo rregull ka edhe përjashtime dhe mungesa e *tenvinit* tek emri Allah është një përjashtim. Argumenti për këtë është që kur parashtesës së shquarsisë (pra, shkronjat *elif* dhe *lam*) i paravendoset thirrморja, mes të dyjave shtohet pjesëza أَيْهَا *ej-juba*. Për shembull, përpara fjalës النَّاس *en-nas*, nëse vendoset thirrморja يَا ja, themi يَا أَيُّهَا النَّاس *ja ej-juben-nas*. Por në rastin e emrit Allah, nuk thuhet يَا أَيُّهَا اللَّهُ *ja ej-juhellah* dhe kjo është dëshmi që shkronjat *elif* dhe *lam* të emrit Allah, janë të temës dhe jo parashtesë e shquarsisë.

Disa thonë se ngaqë *elif* ose *hemze* e fjalës Allah është *veslij* (që bie gjatë lakimit) do të thotë se ajo nuk është e saj, por shtesë. Gjithashtu,

kur fjalës Allah i vendoset para fjala *li*, pra لله *lil-lah*, shkronja *elif* bie dhe sipas tyre edhe kjo është provë që ajo nuk është e temës.

Përgjigjja e kësaj është që rënia e *hemzes* nuk është provë që ajo është e prejardhur. Kështu, në fjalët اسم *ism* dhe ابن *ibn*, *hemze* nuk është shtesë, por është zëvendëse e një shkronje tjetër, megjithatë bie gjatë lakimit. Andaj, në بسم الله *bismil-lah* shohim që *hemze* bie, edhe pse ajo nuk është shtesë, por thjesht e ndryshuar. Nga kjo kuptuam që *hemze* kur është *veslij* ose kur bie gjatë lakimit, nuk është provë që ajo të jetë shtesë.

Shkurt, përdorimi i emrit Allah në periudhën para dhe pas Islamit tregon se ai është i përveçëm dhe nuk është i prejardhur dhe se argumente që jepen për të kundërtën për shkak të disa cilësive të veçanta të këtij emri, nuk qëndrojnë dhe nga shembuj të tjerë, dalin të pabaza.

Përse është shtuar fjala “emër” në ajetin *bismil-lah* “në emër të Allahut”?

Shtrohet edhe një pyetje tjetër: *Bismil-lah* si lutje duhet të ishte: “Lexoj Kuranin me ndihmën e Allahut...” por është: “Lexoj me ndihmën e emrit të Allahut”. Pra, pse i është shtuar fjala “emër”? Përgjigjet me hollësi vijojnë:

1) Në arabisht, para fjala *bi*, përveç kërimit të ndihmës, përdoret edhe për t’u betuar. Po të ishte vetëm بالله *bil-lahi*, mund të lindte dyshim për lexuesin se kërkohet ose bëhet betimi me këto fjale. Për ta larguar këtë dyshim, kësaj lutjeje i është shtuar edhe fjala اسم *ism* “emër”.

2) Zoti i Madhërishëm është i Padukshëm dhe Ai njihet vetëm përmes cilësive të Tij, ndaj është shtuar fjala “emër”. Edhe cilësitë *Rrahman* i Gjithëmëshirshëm dhe *Rrahim* Mëshirëbërës kanë të njëjtin funksion, pra të thuash: i kërkoj ndihmë Allahut në saje të cilësive të Tij *Rrahman* dhe *Rrahim*.


3) Na është tërhequr vëmendje se emrat e Allahut janë të bekuar dhe se ne duhet të thellohemi në ta.

4) Kurani Famëlartë është thesar i kyçur. Kur dikush hyn në një shtëpi a institucion, ku hyrja nuk është e lirë për çdokënd, ai duhet të paraqesë para personave të sigurisë një leje të lëshuar nga pronari ose shefi, ose t’u thotë se më kërkon shefi juaj. Edhe policia kur hyn për të kontrolluar ndonjë shtëpi, u thotë banorëve se po hyjnë në emër të shtetit dhe po u konfiskojnë këtë ose atë pasuri. Kështu që, me shtimin e fjalës “emër”, edhe në ajetin konkret është thënë se ai që lexon Kuranin, pasi të lexojë *bismil-lahin*, u kërkon engjëjve të përcaktuar për shërbimin e Kuranit: “Zoti i Madhërishëm Vetë më dha urdhër ta lexoj këtë sure, andaj më hapni derën e kuptimeve të saj”, dhe me fjalë të shkurtra, lexuesi bën *dua* duke thënë: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit, lutem që të më hapet ky thesar”. Dihet që ai që thellohet në Kuranin Famëlartë me këtë përkushtim, me këtë urdhër të Zotit të Madhërishëm, do të përfitojë nga dijet e tij. Por ai që nuk i kushton rëndësi emrit të Allahut dhe urdhrit të Tij, madje e lexon me inat për të krijuar akuza, nuk do t’i hapen thesaret e tij.

5) dhe 6) Fjala “emër” u referohet dy profecive të Biblës që janë përmendur në vargun 18 dhe 20 të kapitullit 18 të librit Ligji i

Përtërirë, të cilat i kam shpjeguar nën pyetjen: Përse *bismil-lahi* vjen para çdo sureje? Dhe urtësia është që sipas këtyre dy profecive, Profeti i premtuar do t'u lexonte njerëzve Fjalën e Zotit me emrin e Tij. Pra, për të tërhequr vëmendjen e lexuesve te këto profeci, ishte e nevojshme që *bismil-lahit* t'i shtohet fjala "emër".





El-Hamdulil-lāhi Rabbil-‘ālemīn

“Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve”, (El-Fatiha 1:2)

Kuptime leksikore

الْحَمْدُ Lavdia:

حمد do të thotë lavdi. Në arabisht ka shumë fjalë për të shprehur këtë kuptim: حمد *hamd*, مدح *med’h*, شكر *shukr*, ثنا *thena*. Allahu i Madhërishëm jo pa qëllim zgjodhi fjalën *hamd*.

Fjala *shukr* përfshin pohimin e mirësisë së tjetrit dhe mirënjohjen ndaj saj, ndërsa kur ajo përdoret për Zotin e Madhërishëm, ka vetëm kuptimin e mirënjohjes. Kurse fjala *hamd* është më e gjerë se kaq, sepse ajo shpreh konstatimin e bukurisë, pëlqimin dhe, gjithashtu, mirënjohjen dhe falënderimin për mirësinë. Andaj, fjala *hamd* është më e gjerë për nga kuptimi.

Për sa i përket fjalës *thena*, kuptimi i saj i parë është *përsëritje*. Edhe lavdisë i thonë *thena*, sepse ajo përhapet mes njerëzve dhe njerëzit në mënyrë të përsëritur përmendin mirësitë e atij që i bëhet lavdi (*thena*).⁷² Kështu që, fjala *thena* më shumë nënkupton përmendjen e diçkaje të mirë nga njerëzit, sesa përjetimin personal të çdo individ. Edhe kjo pavarësisht se është një gjë e bukur, nuk mund të hedhë dot dritë mjaftueshëm mbi lidhjen personale të robit me Zotin e Madhërishëm,

madje as aq sa mund ta bëjë këtë gjë fjala tjetër e radhës, që është *med’h*.

Med’h përdoret për çdo lëvdatë, qoftë të vërtetë, apo të rreme. Kurse fjala *hamd* përdoret vetëm për lëvdatë të vërtetë. Në hadith thuhet:

أَحْثُوا فِي وُجُوهِ الْمَدَّاحِينَ التَّرَابِ.

“Hidhuni dhë fytyrave të atyre që thurin *med’h* (lëvdata të rreme)”.⁷³

Gjithashtu, lëvdata që përfshin fjala *med’h* mund të jetë edhe për veprat që bëhen pa vullnet, kurse *hamd* thuhet vetëm për punët e vullnetshme.⁷⁴

Andaj, fjala *hamd* është më e lartë sesa fjala *med’h* në kuptimet e saj dhe është më e përshtatshme për t’u përdorur për Zotin e Madhërishëm.

Ajo që thashë pak më parë, që fjala *thana* përdoret për një lëvdatë që përhapet mes njerëzve, edhe kjo është një gjë e mirë. Dikush mund të thotë se fjala *hamd* nuk e mbulon këtë kuptim pozitiv. Përgjigjja është që fjala *hamd* duke qenë në trajtën e shquar, pra *el-hamd*, e përfshin edhe atë, sepse *el* në arabisht jep edhe kuptimin e përgjithësimi, pra i përfshin të gjitha llojet dhe të gjithë njerëzit. Andaj, *El-Hamdulil-lah* do të thotë çdolloj lavdërimi dhe lavdërimi i çdo njeriu, i përket Zotit të Madhërishëm sepse është e drejta e Tij. Ky kuptim e përfshin kuptimin e fjalës *thana*, atë të përhapjes së lavdërimin mes njerëzve, madje edhe më shumë se kaq.

رب *Rab*:

Fjala *rabb* do të thotë:

إِنشَاءُ الشَّيْءِ خَالًا فَخَالًا إِلَى حَدِّ التَّمَامِ-

"Të krijosh diçka dhe ta çosh atë shkallë-shkallë deri në përsosmërinë e saj".⁷⁵

Fjala *rab* përdoret thjesht edhe në kuptimin e rritjes, sidomos kur kryefjala është njeriu. Për shembull, në lidhje me prindërit Kurani Famëlartë e përdor këtë fjalë:

رَبِّ أَرْحَمُهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا

"O Zoti im! Mëshiroji prindërit e mi, ashtu siç ata më rritën kur isha i vogël".⁷⁶

Rab gjithashtu do të thotë pronar, zot, prijës, ai që ndiqet,⁷⁷ siç Kurani Famëlartë na sjell fjalën e Hazret Jusufit^{as}:

أَذْكُرْنِي عِنْدَ رَبِّكَ

"Më përmend mua tek pronari yt".⁷⁸

Fjala *rabb* gjithashtu do të thotë reformues.⁷⁹ Në këtë kuptim kjo fjalë mund të përdoret edhe për njerëzit, pra edhe përveç Zotit të Madhërishëm. Por pa një të përkitur dhe në kuptimin absolut, fjala *rab* nuk përdoret për dikë tjetër përveç Zotit. Për shembull: رَبِّ الدَّارِ (*rabbuddar*) i zoti i shtëpisë ose رَبِّ الْفَرَسِ (*rabbul-feres*) i zoti i kalit dhe shprehje të tilla mund të përdoren për njerëzit, por kur përdoret vetëm fjala *rab* pa ndonjë përkatësi, për shembull *rab*-i tha këtë e *rab*-i tha atë, ajo i referohet vetëm Zotit të Madhërishëm.⁸⁰

Sipas komentuesve të Kuranit, fjala *rab* ka edhe kuptimin e krijuesit.⁸¹

العالمين *El-‘ālemīn* botët:

Është shumësi i fjalës *alem* dhe çdo lloj krijese quhet *alem*.⁸² Format e saj në shumës përveç *عالمون alemun* ose *عالمين alemin* janë edhe *عَالِمٍ alalim* dhe *عَوَالِمٍ avalim*. Ndër emrat jo të njerëzve, janë vetëm *عالم alem* dhe *يَاسِمٍ jasim* që marrin *ون* ose *يان* për të bërë shumësin. Krijesës i thonë *alem* sepse ajo shënjon krijuesin.⁸³

Disa komentues thonë se forma e shumësit *alemun* ose *alemin* të fjalës *alem* përdoren atëherë kur në kontekst ajo u referohet qenieve me intelekt, si njerëzit dhe engjëjt. Por këtë përcaktim e hedh poshtë edhe fjalori, gjithashtu edhe shprehja e Kuranit Famëlartë. Fjalorin e cituam pak më sipër, kurse ajeti i Kuranit për argument është:

قَالَ فِرْعَوْنُ وَمَا رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٠٠﴾ قَالَ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا إِن كُنْتُمْ مُوقِنِينَ ﴿٢٠١﴾ قَالَ لِمَنْ حَوْلَهُ أَلَا تَسْتَمِعُونَ ﴿٢٠٢﴾ قَالَ رَبُّكُمْ وَرَبُّ آبَائِكُمُ الْأَوَّلِينَ ﴿٢٠٣﴾ قَالَ إِنَّ رَسُولَكُمْ الَّذِي أُرْسِلَ إِلَيْكُمْ لَمَجْنُونٌ ﴿٢٠٤﴾ قَالَ رَبُّ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَمَا بَيْنَهُمَا إِن كُنْتُمْ تَعْقِلُونَ ﴿٢٠٥﴾

“Faraoni tha: E kush është Zoti i botëve (*Rabbil-alemin*)? (Musai) tha: Zoti (*Rabbi*) i qiejve dhe i tokës dhe i asaj që gjendet mes të dyve, po të kishit bindje. Ai u tha atyre që ishin përreth: A po dëgjoni? (Musai) tha: Zoti (*Rabbi*) juaj dhe Zoti (*Rabbi*) i etërve tuaj të parë. (Faraoni) tha: Ky i dërguari juaj që ju është dërguar juve, qenka i çmendur! (Musai) vijoi: Zoti (*Rabbi*) i Lindjes dhe i

Perëndimit dhe i asaj që gjendet mes të dyjave, po të kishit mend".⁸⁴

Në këtë ajet fjala *alemin* përveç njerëzve përfshin qiejt, tokën, të gjitha gjërat që janë midis tyre, Lindjen, Perëndimin dhe të gjitha gjërat që janë midis tyre. Gjithashtu, në suren HaMim Es-Sexhde (*Fussilet*) gjejmë këtë ajet:

قُلْ أَتُكْفُرُونَ بِالَّذِي خَلَقَ الْأَرْضَ فِي يَوْمَيْنِ وَتَجْعَلُونَ لَهُ أَنْدَادًا ذَلِكَ رَبُّ الْعَالَمِينَ
وَجَعَلَ فِيهَا رَوَاسِيَ مِنْ فَوْقِهَا وَبَارَكَ فِيهَا وَقَدَّرَ فِيهَا أَقْوَامًا فِي أَرْبَعَةِ أَيَّامٍ سَوَاءً لِّلْسَائِلِينَ ﴿٥١﴾

"Thuaju: A mohoni Atë që krijoi tokën në dy ditë (kohëra) dhe Atij i bëni ortakë?! Pikërisht Ai është Zoti i botëve (*Rabbil-alemin*). Ai bëri malet në të, në rrafshnaltat e saj, e bekoi atë dhe përcaktoi në katër ditë (kohëra) ushqimet e saj, në atë formë që ato janë njësoj për kërkuesit".⁸⁵

Kështu që, edhe ky ajet përdor shumësin *alemin* për tokën, malet, etj.

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} po ashtu thotë:

إِنَّ الْعَالَمِينَ عِبَارَةٌ عَنْ كُلِّ مَوْجُودٍ سِوَى اللَّهِ --- سَوَاءٌ كَانَ مِنْ عَالَمِ الْأَزْوَاجِ أَوْ مِنْ عَالَمِ الْأَجْسَامِ --- أَوْ
كَالسَّمْسِ وَالْقَمَرِ وَغَيْرِهِمَا مِنَ الْأَجْرَامِ.

"*Alemin* i referohet çdo gjëje që ekziston përveç Allahut ... po ashtu i referohet edhe diellit, hënës dhe trupave të tjerë qiellorë".⁸⁶

Shkurt, çdo gjë e gjallë a jo e gjallë përfshihet në këtë fjalë.

Ata që thonë se kjo fjalë flet vetëm për qeniet që kanë mendje, si argument japin këtë ajet të Kuranit:

وَمَا هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ

“Kurse ai është veçse këshillë për botët (*alemin*)”.⁸⁷

Por ky interpretim nuk është i saktë, për sa kohë që kjo fjalë është përdorur po nga Kurani Famëlartë për jofrymorët. Për ajetin konkret mund të themi se këtu një fjalë e përgjithshme është përdorur në një kuptim të veçuar. Kurani Famëlartë ka edhe një shembull tjetër ku fjala *alemin* është përdorur në një kuptim akoma më të veçuar. Zoti u drejtohet hebrenjve dhe thotë:

وَأَنِّي فَضَّلْتُكُمْ عَلَى الْعَالَمِينَ

“Unë ju dhashë epërsi mbi botët (*alemin*)”.⁸⁸

Në këtë ajet bëhet fjalë vetëm për njerëzit e kohës së tyre dhe jo të të gjitha kohërave, sepse për muslimanët Kurani Famëlartë thotë: خَيْرَ أُمَّةٍ “populli më i mirë”. Andaj një kuptim i veçuar i një fjale nuk mund të merret si i vetmi kuptim i saj, kur ajo fjalë është përdorur edhe në kuptimin e saj të përgjithshëm. Si përfundim, e vërteta është që fjala *alemin* përdoret për çdo gjë që është krijesë, qoftë e gjallë, qoftë jo e gjallë.

Komentim

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ El-Hamdulil-lah.

Arsyeja pse u përdor emri dhe jo folja

Nuk u tha: “lavdëroj ose lavdërojmë Allahun”, por thuhet “lavdia është e Allahut” dhe ky ndryshim sjell shumë kuptime. Duke përdorur jo foljen, por emrin në trajtën e shquar, Kurani Famëlartë përfshiu çdolloj lavdërimi, qoftë të njohur a të panjohur për njerëzit. Pra, të gjitha

lavdërimet që mund të bëjnë krijesat ose që i bëjnë, i takojnë Zotit të Madhërishëm. Nuk ka asnjë të mirë që Ai nuk e zotëron dhe nuk ka asnjë të keqe, së cilës Ai nuk i qëndron larg. Ky ajet gjithashtu tregon se edhe lavdërimin ndaj krijesave vetëm Zoti i Madhërishëm mund ta bëjë siç duhet, sepse Ai është Njohësi i të fshehtave. Robi lëvdon robin tjetër, por nganjëherë edhe jo të drejtë. Nganjëherë nuk arrin ta lavdërojë aq sa ka cilësitë tjetri dhe nganjëherë e lavdëron më shumë sesa duhet. Andaj, lavdërimi i vërtetë është ai që bën Zoti i Madhërishëm. Thamë për lavdërimin e njerëzve në raport me njëritjetrit, por njeriu shpesh gabon edhe në cilësimin e vetvetes. Por ajo që thotë Zoti për robin nuk mbetet as e mangët dhe as e tepërt. Ajeti në fjalë po të fillonte me foljen "lavdëroj" ose "lavdërojmë", nuk mund t'i kishte këto kuptime.

Gjithashtu, nëse ky ajet do të fillonte me folje, pra, "lavdëroj Allahun ..." do të nënkuptohej që njeriu e ka aftësinë t'i kuptojë të gjitha cilësitë e Zotit të Madhërishëm, gjë që nuk mund të jetë e vërtetë. Njeriu është i kufizuar dhe ai lavdëron vetëm në bazë të dijes së tij, kurse Zoti i Madhërishëm është i pakufizuar dhe zotëron cilësi të panumërta për t'u lavdëruar.

Shkurt, fjala *el-hamdu* "lavdia" i përfshin të gjitha kuptimet që mund të kenë fjalët "lavdëroj" ose "lavdërojmë", madje edhe kuptime të tjera. Andaj, ishte e nevojshme që kjo sure e shkurtër që është përmbledhja e të gjitha kuptimeve të Kuranit, të fillonte me fjalët *El-Hamdulil-lah* "Lavdia është e Allahut".

Kurani Famëlartë sigurisht që përmend edhe lavdërimin e Zotit nga ana e krijesave, siç thotë:

وَحْنُ نُسْبِحُ بِحَمْدِكَ

“Dhe ne të përkujtojmë Ty me lavdërimin Tënd”.⁸⁹

Por, në asnjë ajet të Kuranit nuk përmenden fjalët si “lavdëroj” ose “lavdërojmë” kur si kryefjalë janë krijesa. Janë përdorur fjalët *jusebbihu* “përkujton” *nusebbihu*, “përkujtojmë” *nukaddisu* “përmendim shenjtërinë Tënde”. Mendoj se kjo përzgjedhje fjalësh ka një kuptim, që robi nuk e rrok dot lavdërimin e plotë. Pavarësisht se në hadithe nuk është marrë parasysh kjo gjë, dihet që fjalët kur janë në librin e Zotit të Madhërishëm kanë një nivel tjetër kuptimor dhe kur vijnë nga robi kanë një tjetër nivel kuptimor. Një fjalë të caktuar kur e thotë robi, nuk merr kuptime aq të gjithanshme, sa kur e thotë Zoti i Madhërishëm, sidomos kur Ai e thotë në Librin dhe në Sheriatin e Tij.

لَّيْلٍ *Lil-lahi* “e Allahut”

Li në arabisht është parafjalë pronore, pra përdoret për të treguar pronësinë. Kjo pjesë sqaron se pavarësisht se lavdërimi bëhet edhe ndaj njerëzve, në të vërtetë dhe në mënyrë absolute ai i takon Allahut të Madhërishëm, kurse çdokush dhe çdo gjë tjetër përveç Tij, ka lavdërim relativ e të dhuruar. Kjo sepse vetitë e mira që ka njeriu, nuk i ka të tijat, por të dhuruara prej Zotit të Madhërishëm. Andaj, çdo lavdërim që i bëhet njeriut, në të vërtetë i përket Zotit të Madhërishëm.

Dhjetë kuptime të ajetit "*El-Hamdulil-lah ...*"

Disa kuptime të këtij ajeti shënohen sa vijon:

1) Krijuesi i gjithësisë është i pastër nga çdo e metë dhe zotëron çdo të mirë.

2) Ai është në dijeni të plotë të të gjitha krijesave deri në gjenezën e tyre dhe përveç Atij, askush tjetër nuk zotëron dije të plotë qoftë edhe për një gjë të caktuar. Kjo është e vërtetuar edhe nga zhvillimi i shkencës. Plot shkencëtarë merren me zbulimin e gjërave të ndryshme, por askush prej tyre nuk e ka zbuluar dot deri në fund qoftë edhe një gjë të vetme. Për çdo gjë bëhen zbulime të reja përditë.

3) Zoti do të zotëronte lavdërimin absolut vetëm nëse do të ishte edhe *Rabbi* (Krijuesi) i botëve, përndryshe jo. Andaj, është e nevojshme që ashtu siç sistemi lëndor i Tij është vënë në dobi të gjithkujt, në të njëjtën mënyrë, edhe sistemi i Tij shpirtëror të mbulojë çdokënd dhe asnjë vend e asnjë popull të mos privohet nga mjetet e zhvillimit shpirtëror. Kështu që, nëse një shpallje e caktuar është e veçuar për një popull të caktuar, është e nevojshme të zbresë shpallje më vete për popujt e tjerë. Dhe kur popujve të tjerë nuk u zbret shpallje më vete, duhet të zbresë një shpallje për udhëzimin e krejt botës. (Andaj, feja që beson se shpallja ka zbritur vetëm për udhëzimin e popullit të vet, ose që *shpëtimi* është vetëm e drejta e tyre dhe jo e të tjerëve, e ka gabim).

4) Të gjitha vetitë e mira që kanë njerëzit, janë të dhuruara prej Zotit të Madhërishëm, andaj, për çdo të mirë që ata bëjnë, lavdërimi i vërtetë i takon Zotit.

5) Duke e lidhur lavdinë me *Rabbil-‘ālemīn*-in (Krijuesin e botëve), kjo sure tregon që gëzimi i vërtetë i njeriut duhet të jetë me shfaqjen e cilësisë hyjnore “Krijuesi i botëve”. Ai që gëzohet vetëm për dobinë e vet dhe nuk shqetësohet kur sheh humbjen që pëson bota, nuk e kupton mësimin e Islamit. Gëzimi i vërtetë arrihet kur e gjithë bota gjën qetësi.

Ajeti pohon se evolucioni i krijimit ka ndodhur

6) Allahu është *Rabbi* (Krijuesi dhe Zhvilluesi) i botëve. Kjo tregon se çdo gjë tjetër përveç Allahut, është nevojtare e krijimit dhe e zhvillimit, që do të thotë se duhet të ndjekë ligjin e evolucionit për mbijetesën e vet. Ky ajet tregon se nuk ka gjë në botë që ka të njëjtin fillim e mbarim dhe se përveç Zotit të Madhërishëm, çdo gjë është e ndryshueshme dhe zhvillohet shkallazi nga një gjendje më e ulët, deri tek më e larta. Kjo dukuri provon dy gjëra: Së pari, çdo gjë përveç Zotit të Madhërishëm është krijesë dhe nuk është e mëvetësishme, derisa zhvillohet dhe pëson ndryshime. Së dyti, çështja e evolucionit është e saktë. Çdo gjë ka evoluar nga gjendja më e ulët deri tek më e larta, qoftë njeriu, apo kafshët, qoftë bimësia, apo sendet, sepse *Rabbil-‘ālemīn* do të thotë: Zoti sjell çdo gjë nga gjendja më e ulët deri tek e larta. Pra, tregon që gjithçka që ekziston në këtë botë, ndjek rrugën e evolucionit.

7) Mësuam se evolucioni ndodh në kohëra dhe në etapa të ndryshme, sepse fjala *rab* do të thotë:

إِنشَاءُ السَّيِّءِ حَالًا فَحَالًا إِلَى حَدِّ التَّامِّ

“Të krijosh diçka dhe ta çosh atë shkallë-shkallë deri në përsosmërinë e saj” (pra, jo ta përsosësh përnjëherë).

8) Gjithashtu mësuam se evolucioni nuk është kundër ekzistencës së Zotit, sepse thotë: “Lavdia është e Allahut, *Rabbit* të botëve”, pra krijimi në etapa të ndryshme nuk bie ndesh me praktikën e Zotit, madje kjo mënyrë e krijimit e bën Atë të Lavdishëm. Andaj, përpara fjalëve *Rabbil-alemin* (Zoti i botëve), thuhet *El-Hamdulil-lah* “Lavdia është e Allahut”.


Njeriu është krijuar për përparime të pakufishme

9) Ky ajet gjithashtu tregon se njeriu është krijuar për përparime të pakufishme, sepse thotë se lavdia është e Allahut se Ai e përsos çdo krijesë duke e çuar atë deri në gjendjen më të lartë. Kjo tregon se derisa të ekzistojnë krijesat, gjithmonë do të ketë një gjendje më të avancuar sesa e tanishmja.

10) Dhe e fundit, duke filluar Kuranin Famëlartë me suren El-Fatiha si përmbledhje e kuptimeve kuranore, dhe duke e filluar El-Fatihinë me fjalët “Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve”, tregon se koha e lavdisë së përsosur të Zotit, tani ka filluar, sepse Islami përfaqëson Zotin e botëve dhe është një fe për të gjithë botën. Në këtë mënyrë, me ardhjen e Islamit, është krijuar një bashkim në botën shpirtërore, siç vërejmë bashkimin në botën lëndore. Përpara Islamit, profetët vinin për popuj të caktuar. Ihtarët e një feje të caktuar me naivitet mohonin mësimet e profetëve të tjerë. Për shembull, hindutë deklarorin se njihnin *Përmeshverin* dhe jo *Jehovain*, ndërsa hebrenjtë e përqeshnin *Përmeshverin*. Por me ardhjen e Islamit, u krijua një fe e vetme për të

gjithë botën dhe edhe indianët, edhe kinezët, edhe egjiptianët, edhe persët, edhe lindorët edhe perëndimorët, të gjithë filluan ta lavdërojnë Zotin dhe u pranua se jo çdo popull ka Zotin e vet, por të gjithë popujt kanë një Zot të Vetëm.

~~~~~ ❁ ~~~~~



### *Err-Rrahmānirr-Rrahīm*

të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit; (El-Fatiha 1:3)

### **Kuptime leksikore**

Për kuptimet leksikore të fjalëve *Err-rrahman* dhe *Err-rrahim*, shihni shënimin për ajetin e parë të kësaj sureje.

### **Komentim**

*Err-Rrahmānirr-Rrahīm*, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit: Kuptimet e këtyre fjalëve i kemi shkruar në komentimin e ajetit "*Bismil-lah* ...".

Përse u përsëritën këto dy attribute?

Disa njerëz kritikojnë se përderisa këto dy cilësi u përmendën një herë në "*Bismil-lah* ..." përse të përsëriten edhe këtu?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është që ajeti "*Bismil-lah*" sjell një temë më vete dhe se ajo është çelësi i çdo sureje. Andaj, rimarrja e këtyre cilësive në temën e sures, nuk është përsëritje. Për këtë arsye, surja El-Fatiha i sjell këto dy cilësi si pjesë të temës së saj.

Në fjalët *Rabbil-alemin* (Zoti i botëve) u tha që Zoti i Madhërishëm krijon një gjë dhe shkallë-shkallë e çon atë drejt përsosmërisë. Duke përmendur cilësitë: të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit, ajeti në fjalë na tregon mënyrat që ka ndjekur Zoti i botëve për këtë krijim, që janë:

1) Zoti i Madhërishëm është *Err-Rrahman* i Gjithëmëshirshmi. Pra, për çdo gjë Ai, së pari krijoi mjetet, që janë të nevojshme për zhvillimin e saj. Duke krijuar mjetet nga më të imëtat, Ai krijoi mundësinë për çdo forcë që të shfaqet dhe të hapë rrugën e zhvillimit. Njerëzit, shtazët, bimët, sendet, që të gjitha janë në kontakt dhe ndikim me gjithçka që i rrethon dhe njëherësh marrin mjetet e duhura të qëndrueshmërisë dhe të përsosmërisë së tyre.

2) Ai është *Err-Rrahim* Mëshirëbërësi. Kur njerëzit si krijesa përmbushin detyrat e tyre siç duhet, Ai ua çmon mundin, i bekon dhe u ngjall shpresa për zhvillime të mëtejshme. Në këtë mënyrë ky rregull funksionon në mënyrë të pandalshme.

### ***Rrahmani* si veti e përveçme është vetëm e Zotit**

*Err-Rrahman* i Gjithëmëshirshmi është një cilësi që nuk përdoret për dikë tjetër përveç Zotit të Madhërishëm, si dhe për të treguar përkatësi, si për shembull Musejleme *Kedh-dhabi* (gënjeshitari) e quante veten *Rrahmani* i Jemames.

### ***Rrahmani* hedh poshtë doktrinën e *shlyerjes***

Në kuptimet e fjalës *Err-Rrahman*, siç kemi thënë, ajo përfshin mëshirën e gjithanshme që bëhet pa kërkuar. Dhe ky kuptim i kësaj fjale hedh poshtë doktrinën e *shlyerjes*, sepse baza e saj është që Zoti i Madhërishëm nuk mund të mëshirojë pa meritë. Të krishterët janë kaq të ndjeshëm në këtë pikë, saqë të krishterët arabë në librat ose letrat e tyre kur thonë "me emrin e Allahut", pas kësaj përmendin cilësi të tjera të Zotit dhe jo të *Rrahmanit*. Disa prej tyre ata që janë të ndikuar nga kultura islame, thonë, për shembull, *Bismil-labil-Kerimirr-Rrahim*, por

cilësinë e *Rrahmanit* nuk e përmendin. Kjo sepse ata janë të bindur se po e pranuan këtë cilësi të Zotit, Zoti mund t'i falë njerëzit edhe pa *shlyerjen* e Mesihut të tyre.


### ***Rrahimi* hedh poshtë doktrinën e *rimishërimit***

Cilësia *Err-Rrahim*, Mëshirëbërësi, hedh poshtë doktrinën e *rimishërimit* [të hinduve], sepse baza e kësaj doktrine është besimi se Zoti nuk mund të japë shpërblim të pakufishëm për një veprë të kufizuar. Cilësia *Err-Rrahim* nuk tregon se vepra e kufizuar shpërblehet në mënyrë të pakufizuar, por tregon se vepra e mirë e ka cilësinë të përsëritet, andaj edhe shpërblimi vjen i shumëfishuar. *Rrahimi* do të thotë që mëshiron vazhdimisht. Kjo nuk do të thotë se vetëm një veprë e caktuar merr shpërblim në mënyrë të vazhdueshme, por se njeriu që kupton se çfarë është vepra e mirë, vazhdimisht e bën atë, ose të paktën gjithnjë dëshiron ta bëjë atë në mënyrë të vazhdueshme. Andaj, kur çdo herë robi merr shpërblimin e një veprë të mirë, atij i shtohet edhe dëshira edhe forca për të bërë vepra të tjera të mira. Kjo shkakton mëshirën e vazhdueshme të Allahut të Madhërishëm. Në këtë mënyrë, besimtari e vijon këtë rrugëtim dhe, edhe mëshira vijon të zbresë mbi të. Me fjalë të tjera, mëshira e Zotit nuk është thjesht si shpërblim për mirësinë e bërë, por mbjell edhe farën e mirësisë së ardhshme.

Realisht, hindutë menduan për veprën e kufizuar sepse ata e pandehën xhenetin si një vend pa punë e pa vepra. Ata kështu duhej të besonin, sepse në konceptin e tyre *shpëtimi* është *nirvana*, që do të thotë të bësh jetë asketike, pra të çlirohesh nga çdo lloj dëshire dhe veprë. Andaj,

sipas tyre, vepra e njeriut përfundon vetëm në këtë botë dhe si e tillë, ajo është e kufizuar. Dhe ngaqë ajo është e kufizuar, sipas tyre, edhe shpërblimi i saj duhet të jetë i kufizuar. Por Islami jep konceptin e mëshirës së vijueshme dhe të veprave të vijueshme. Ai edhe xhenetin e cilëson si vend veprash. Allahu është Zoti i botëve dhe në fjalën "botët" përfshihet edhe xheneti. Derisa Zoti do të jetë *Rab* edhe në xhenet, do të thotë se edhe atje do të ketë zhvillim, përndryshe cilësia e *Rabbil-aleminit* nuk do të ketë kuptim atje. Dhe derisa njeriu do të vijojë zhvillimin edhe atje, atij patjetër do të vijojë t'i shtohet druajtja dhe dashuria ndaj Zotit. E kur këto gjëra vijnë të shtohen, edhe mëshira e Zotit të Madhërishëm vijon të shkaktohet. Kur kjo marrëdhënie mëshirë-vepër do të vazhdojë në këtë mënyrë, *shpëtimi* nuk mbetet më diçka e kufizuar. I vetmi ndryshim që kanë veprat e mira të kësaj bote me veprat e botës tjetër, është që këtu ekziston rreziku i rënies, kurse në botën tjetër do të ketë vetëm përparim dhe jo rënie. Zhvillimi shpirtëror do të bëhet edhe atje. Andaj, nuk lind fare pyetja për veprën e kufizuar dhe për shpërblimin e pakufizuar.





### Mālīkī jeumiddīn

Sunduesit të ditës së gjykimit. (El-Fatiha 1:4)

### Kuptime leksikore

مالِك *Malik* Sundues

Fjalët مالِك *malik*, ملك *melek* dhe مَلِك *melik* janë homonime. *Malik* do të thotë ai që ka pushtetin me të drejtë mbi diçka. *Melek* do të thotë engjëll. Kurse *melik* do të thotë mbret, pra ai që ka pushtetin politik.

يَوْم *Jeum* ditë

Fjala *jeum* do të thotë kohë. Kurani Famëllartë thotë:

وَإِنَّ يَوْمًا عِنْدَ رَبِّكَ كَأَلْفِ سَنَةٍ مِّمَّا تَعُدُّونَ

“Sigurisht, një ditë (*jeum*) tek Zoti yt është sikur një mijë vjet që ju llogarisni”.<sup>90</sup>

Një poet shprehet:

يوماه يوم ندى و يوم طعان

“Ai ka vetëm dy kohë (*jeum*): kohën kur bën bujari dhe kohën kur shkatërron armiqtë”.<sup>91</sup>

Gjithashtu, arabët thonë:

يوماه يوم نُعم و يوم بُؤس أي الدَّهر

“Çdo kohë sjell njërin prej të dyve: gëzimin ose hidhërimin”.<sup>92</sup>

Po ashtu, Sibevejhi thotë se arabët thonë:

أَنَا الْيَوْمَ أَفْعَلُ كَذَا لَا يُرِيدُونَ يَوْمًا بِعَيْنِهِ وَلَكِنَّهُمْ يُرِيدُونَ الْوَقْتَ الْحَاضِرَ. [لسان العرب]

“Kur thuhet se “unë ditën e sotme punoj kështu”, nuk bëhet fjalë për ditën e plotë, por për kohën aktuale”.<sup>93</sup>

Gjithashtu, edhe ajeti i Kuranit “Sot ju kam përsosur fenë tuaj ...” nuk flet për ditën siç e llogarisim, por për epokën dhe kohën.

Më pas është shkruar:

وقد يُراد باليوم الوقتُ مطلقاً و منه الحديثُ تلك أيام الهرج أى وقته

“Fjala *jeum* do të thotë vetëm kohë, siç thuhet në një hadith: “këto *ditë* janë të trazirës”, që do të thotë se është *kohë* trazirash”.<sup>94</sup>

الدّين Ed-din:

ألفهر والغلبة shpërblim; ألعطة bindje; ألعاب llogaritje a gjykim; ألعاءة fitore; ألعاءة sundim, qeverisje; ألعاءة karakter; ألعاءة strategji; ألعاءة ما ألعاءة به ألعاءة të gjitha mënyrat për të adhuruar Zotin e Madhërishëm emërtohen si “din”, pra, sheriat; ألعاءة feja; ألعاءة mirësi; ألعاءة mosbindje; ألعاءة gjendje; ألعاءة vendim; ألعاءة zakon; ألعاءة gjendje e veçantë.<sup>95</sup>

## Komentim

Në bazë të fjalorit, kuptimet e ajetit janë:

Zoti i Madhërishëm është Sunduesi i ditës së gjykimit; Sunduesi i kohës së shëritit; Sunduesi i kohës së vendimmarrjes; Sunduesi i epokës së fesë; Sunduesi i kohës së mirësisë; Sunduesi i kohës së ligësisë; Sunduesi i kohës së llogarisë; Sunduesi i kohës së bindjes; Sunduesi i kohës së triumfit; Sunduesi i situatave të veçanta e të rëndësishme.



Në përgjithësi, njerëzit mendojnë se ky ajet aplikohet vetëm për sundimin e ditës së gjykimit që bëhet pas kiametit. Por, siç u sqarua edhe nga fjalori, ky nuk është kuptim i drejtpërdrejtë, por një interpretim. Një kuptim i fjalës *din* është shpërblim dhe ndëshkim, dhe ngaqë kjo, në mënyrën më të plotë, do të bëhet në ditën e gjykimit, komentuesit e Kuranit këtë kuptim e nxorën për këtë ajet. Ndërkohë, gjuhësisht fjala *din* ka kuptime të ndryshme dhe të gjitha ato mund të aplikohen në kontekstin kuranor, andaj nuk ka arsye që të marrim vetëm një kuptim të caktuar të saj e t'i lëmë anash kuptimet e tjera.

Siç ju thashë se komentuesit në përgjithësi pohojnë se kuptimi i këtij ajeti është “Zoti i Madhërishëm është Sunduesi i ditës së gjykimit, ditën kur do të shpallen shpërblimet dhe ndëshkimet”, po ashtu, ky ajet thotë se Zoti i Madhërishëm është Sunduesi i ditës së gjykimit, sepse atë ditë, askush nuk do të ketë mundësi për të ndërhyrë në gjykim.

Në këtë mënyrë, ky ajet tregon se si ndryshon ahireti nga bota për nga rezultatet. Ndërsa në këtë botë shpërblimet dhe ndëshkimet mund t'i japin edhe njerëzit, të cilët edhe mund të gabojnë, ditën e gjykimit do të jetë vetëm Zoti i Madhërishëm që do të ketë këtë autoritet. Atëherë nuk do të bëhet padrejtësi ndaj askujt. Asnjë i pafajshëm nuk do të dënohet dhe askush nuk do të ndëshkohet në mënyrë të tepruar. Po ashtu, edhe fajtori nuk do të ketë mundësi ta fshehë fajin e tij me mashtrim e të shpëtojë nga ndëshkimi.

### **Dallimi mes *Malikut* dhe *Melikut***

Ky ajet gjithashtu tregon se ditën e gjykimit Zoti i Madhërishëm nuk do të jetë thjesht “*melik*” (mbret ose gjykatës), por do të jetë “*malik*”,

pra Sundues. Gjykatësit, përfshi edhe mbretërit e kësaj bote, kur gjykojnë, janë të detyruar të zbatojnë drejtësinë, për t'i dhënë atë që i takon secilit, paditësit dhe të paditurit. Ata nuk kanë të drejtë të falin dikë. Por Zoti i Madhërishëm nuk është thjesht mbret, por edhe "*malik*", Sundues. Ai ka të drejtë të falë nga pjesa e Tij sa të dojë e për këtë të dojë Ai.

### **Pesë kuptime të ajetit "*Sunduesit të ditës së gjykimit*"**

Ky kuptim të jep shpresë nga njëra anë dhe, të shpëton nga dëshpërimi nga ana tjetër, të zgjon që të jesh vigjilent, që të mos ëndërrosh të abuzosh me mëshirën e Zotit. Duke qenë Sundues, Ai edhe mund të të mëshirojë pafund, por edhe mund të mos veprojë kështu, për të mos lejuar ligësi në krijimin e Tij. Kështu që, ky ajet në mënyrë të baraspeshuar të siguron shpresë dhe frikë që të veprosh drejt Zotit.

Për *shpëtimin*, Kurani nuk mëson si krishterimi i sotëm. Ky i fundit jep një koncept të gabuar të drejtësisë, duke ia hequr shpresën njeriut dhe, nga ana tjetër i nxit njerëzit për të bërë mëkate, duke sjellë konceptin e *shlyerjes*. Pra, të dyja anët e kësaj doktrine mbështesin jo pastërtinë, por mëkatin. Gjendja tejet e pashpresë ka sjellë mëkate, dhe lirimi i tepruar gjithashtu ka sjellë mëkate. Disa njerëz do të heqin dorë nga mirësia e adhurimi, sepse nuk do të kenë shpresë për pastrimin shpirtëror, e disa të tjerë do të marrin guximin për të bërë mëkate, sepse do të mbështeten tek shlyerja e mëkateve të tyre.

Si shfaqet atributi *Malik* në kohën e profetëve?

**Kuptimi i dytë** i këtij ajeti është: Zoti është Sunduesi i kohës së sheriatit, i kohës së fesë. Ky kuptim hedh dritë mbi ligjet e Zotit. Zoti i

Madhërishëm e trajton botën me ligjet e Tij të përgjithshme, por në kohën kur themelohet një shariat ose një fe, vepron atributi i Tij i Sundimit. Me fjalë të tjera, në atë kohë, jo vetëm që vepron atributi i gjykimit, por edhe manifestohet në mënyrë të veçantë atributi i Tij i sundimit. Zoti i Madhërishëm bën punë të veçanta. Ata që nuk i njohin mirë atributet e Zotit, mund t'u duket se po thyhen ligjet e natyrës dhe dëshmojnë të pamundurën duke parë se si një njeri i thjeshtë, i gjorë dhe i papërkrahur deklaroi para botës dhe e gjithë bota e kundërshtoi atë, por pavarësisht se faktorët e kësaj bote nuk janë në favor të tij, ai ngadhënjën. Gjithashtu, në shumë çështje të tjera, ndodhin të tilla ngjarje me anë të lutjeve dhe të mrekullive, sa që bota befasonet duke i parë ato.

Urtësia që qëndron në këto ngjarje është që kur themelon Zoti i Madhërishëm ndonjë shariat ose ndonjë xhemat të Tij, shfaq në mënyrë të veçantë jo atributin e tij të gjykimit, por atë të Sundimit. Të dashurit e Tij në atë kohë, Ai i trajton me ligjin e Tij të veçantë dhe jo me ligjin e Tij të zakonshëm. Për këtë arsye, ato ditë ndodhin ngjarje të çuditshme e të jashtëzakonshme. Kjo ka qenë praktika e Zotit në kohën e çdo profeti dhe kjo sure bëri profeci që edhe në kohën e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> kështu do të ndodhte. Pra, kjo sure deklaroi se Zoti i Madhërishëm do ta mbështeste Profetin Muhammed<sup>savs</sup> me mrekulli e me ngjarje të jashtëzakonshme, të cilat do të dukeshin kundër ligjeve të zakonshme të Zotit. Dhe kjo do të ishte një provë se ajo epokë ishte epoka e vendosjes së shariatit dhe se Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ishte i dërguari i Zotit të Madhërishëm.

Një kuptim tjetër i këtij ajeti, siç thamë, është se Zoti i Madhërishtëm është Sunduesi i kohës së mirësisë dhe i kohës së ligësisë. Ky kuptim tregon se bota kalon në dy faza të ndryshme. Në një kohë të caktuar, mirësia dhe ligësia veprojnë paralelisht me të njëjtën fuqi në botë. Në këtë kohë vepron ligji i zakonshëm i Zotit. Por vjen një kohë kur botën e kaplon ligësia. Atëherë Zoti i Madhërishtëm shfaqet si Sundues, merr masat për ta shpëtuar kopshtin e Tij, dërgon një profet, përmes të cilit ngrihet një popull që thajse i gjithi qëndron në mirësi. Edhe në këtë kohë, Zoti e mbështet popullin e Tij me caktimet e Tij të veçanta, derisa vjen një kohë kur ky popull e humb vlerën e vet dhe te ta, mirësia dhe ligësia fillojnë të veprojnë me të njëjtën fuqi. Atëherë Zoti e trajton me ligjet e Tij të zakonshme. Kështu vazhdon derisa ai popull pëson rënie totale. Atëherë sërish vjen në fuqi atributi i Sundimit, sërish vjen ndonjë profet, sërish shpartallohet ligësia dhe sërish ngrihet një xhema i Zotit. Në këtë mënyrë, ky atribut e mban gjallë këtë cikël.

**Një kuptim tjetër** i këtij ajeti është se Zoti i Madhërishtëm është Sunduesi i kohës së bindjes. Që do të thotë se ligji që u përmend më sipër dhe që vepron për të gjithë popujt në përgjithësi, ka edhe një shfaqje individuale. Pra, kur dikush e kalon jetën në përputhje dhe me bindje të plotë ndaj Zotit të Madhërishtëm, Zoti edhe për të tregon fuqinë e Tij të veçantë dhe në atë kohë, ai njeri nuk mbetet më si njerëzit e tjerë të zakonshëm, por shumë i veçantë për shkak të fuqisë së Zotit.

**Një kuptim tjetër** i këtij ajeti është se Zoti i Madhërishtëm është Sunduesi i gjendjes së rëndësishme. Ky kuptim tregon se çdo punë në

këtë botë nuk është e vetmuar, por është hallkë e një zinxhiri të gjatë. Kur njeriu sëmuret, sëmundja e tij nuk vjen për shkak të ndonjë gabimi që ai sapo ka bërë dhe as shëndeti nuk qëndron tek ai për shkak të ndonjë ushqimi apo ushtrimi që ka bërë atë ditë. Me fjalë të tjera, veprat e njeriut japin dy lloj rezultatesh: një të përkohshëm dhe një tjetër të qëndrueshëm e përfundimtar.

Dikush tregohet i pakujdesshëm ndaj syve. Atij fillojnë t'i dhembnin sytë. Mjekohet dhe shërohet, por ai sërish e lë pas dore dhe sërish i dhembnin sytë. Ai prapë mjekohet dhe shërohet. Por vjen një kohë kur atë nuk e ndihmon më aspak mjekimi dhe në fund e humb fare shikimin. Një student i mirë mëson mirë dhe merr notë të mirë nga mësuesi. Ai çdo ditë mëson mirë dhe çdo ditë merr notë të mirë nga mësuesi. Ky veprim i tij sjell një rezultat të përditshëm. Por nga kjo punë e tij e palodhur, përveç mësimëve të librit, ai fiton një mendje të ndritur dhe fillon të kuptojë imtësisht çështjet e dijes e të urtësisë. Këto gjëra, një ditë, e bëjnë të shquar e të lavdëruar. Ky quhet rezultati përfundimtar, i cili shfaqet gati-gati pa u vënë re nga askush. Edhe shokët e tij habiten se ku ishte ai dhe ku gjendet sot.

Ajeti në fjalë tregon se rezultati përfundimtar është në dorën e Zotit. Pavarësisht se njeriu duke zbatuar ligjin e zakonshëm, fiton nder a pozitë në shoqëri, ai që duhet kërkuar është rezultati përfundimtar, i cili vjen vetëm nëse plotësohen të gjitha hallkat e zinxhirit. Sidomos, ai rezultat që shfaqet në formë besimi në fund të jetës së njeriut, mbi të cilin bazohet edhe jeta vijuese e njeriut, pra ajo e botës tjetër.

Me fjalët “Zoti është Sunduesi i *Jeumud-dinit*” nuk do të thotë se Zoti nuk është Sunduesi i kësaj bote. Edhe sikur ta kuptojmë këtë ajet si “Zoti është Sunduesi i Ditës së Kiametit”, kuptimi i tij është që atë ditë nuk do të ketë asnjë sundues tjetër përveç Zotit. Siç e thotë Kurani në një ajet tjetër:

وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ۖ ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ۚ يَوْمَ لَا تَمْلِكُ نَفْسٌ لِّنَفْسٍ  
شَيْئًا وَلَا أَمْرٌ يُومِئِذٍ لِلَّهِ ۚ

“E çfarë dini ju se çka është dita e gjykimit (*jeumud-dini*)? Sërisht, çfarë dini ju se çka është dita e gjykimit (*jeumud-dini*)? Dita kur asnjë shpirt nuk do t’i vlejë shpirtit tjetër aspak dhe vendimi atë ditë do të jetë i Allahut”.<sup>96</sup>

Pra, ky ajet tregon se *malikë* (sunduesit, mbretërit dhe gjykatësit) e kësaj bote do të ndërpriten që në këtë botë dhe nuk do të vijnë në botën tjetër. Kjo nuk do të thotë se Zoti nuk është *Malik* (Sunduesi, Mbreti dhe Gjykatësi) i kësaj bote.

## Renditje kuptimplote e katër emrave të Zotit

Mënyra siç janë renditur këto katër attribute, tregojnë bukur një kuptim shumë të lartë të rrugëtimit drejt Zotit.

## Raporti i Zotit me robin dhe i robit me Zotin

Ne e dimë që Zoti i Madhërishëm ka pozitën e lartë, kurse robi e ka të ulët. Andaj, kuptojmë që nëse Zoti dëshiron t’i kushtojë vëmendje robit Ai zbret nga lart poshtë. Por nëse robi i kushton vëmendje Zotit të Madhërishëm, nga poshtë atij i duhet të shkojë lart. Duke e marrë parasysh këtë pikë, na zbulohet se këta katër emra të Zotit të

Madhërishëm janë vendosur me një renditje të veçantë, të cilët na shpjegojnë rrugëtimin e Zotit drejt robit por edhe anasjelltas.

Zoti i Madhërishëm zbret drejt robit shkallazi përmes attributeve:

- *Rabbil-alemin: Zoti i botëve*
- *Rrahman: I Gjithëmëshirshëm*
- *Rrahim: Mëshirëbërës*
- *Maliki jeumid-din: Sunduesi i kohës së gjykimit*

Që do të thotë, kur Ai dëshiron të shfaqet për robin e Tij, së pari i tregon cilësinë e *Zotit të botëve*. Ai krijon të gjitha ato mjete, të cilat janë të nevojshme për lindjen dhe rritjen e robit të Tij të dashur. Pastaj, atij i mundëson edhe mjetet të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e tij shpirtëror. E kur robi përfiton nga këto mjete, Zoti i jep rezultate sa më të mira dhe pas një zinxhir bekimesh që shkaktohet, vjen rezultati përfundimtar i përpjekjeve të robit. Në atë kohë, Zoti e mundëson robin ta triumfojë botën. Kështu, përmes tij shfaq cilësinë e Sundimit të Vet.

Por kur e shohim këtë rrugëtim nga krahu tjetër, pra robi dëshiron t'i kushtojë vëmendje Zotit të Madhërishëm, ai së pari duhet të krijojë cilësinë e *malikut* (gjykatësit) në vete. Kjo do të thotë se më së pari ai duhet të përvetësojë drejtësinë në këtë botë. Por duke qenë rob i Zotit, drejtësia e tij duhet të ketë edhe aspektin e mëshirës dhe të *afvit*, që do të thotë se ai nuk duhet t'i shkaktojë dëm tjetrit.

Kur robi përparon edhe më shumë, ai shfaq atributin mëshirëbërës (*rrahim*). Që do të thotë se njerëzit që kanë lidhje me të, ai jo vetëm i

nderon, por edhe i shpërblen më shumë se sa u takon. Pra, ai fillon të krijojë në vete cilësinë e të shkaktuarit mirësi ndaj të tjerëve. Kësaj i thonë *ibsan* (mirësi).

Robi përparon akoma më shumë dhe fillon të shfaq cilësinë e të gjithëmëshirshmit (*rrahman*) të Zotit, duke u bërë mirësi jo vetëm njerëzve të vet, por edhe të tjerëve. Ndien zemërgjerësi. Si pasqyrim i të Gjithëmëshirshmit (*Rrahmanit*), ai ndien dashuri edhe ndaj besimtarit, edhe ndaj mohuesit, edhe ndaj atij që i ka bërë mirësi, edhe ndaj atij që nuk i ka bërë ndonjë mirësi. Kjo është gjendje që reflektohet në fjalët e Kuranit: *إِنِّئَاء ذِي الْقُرْبَىٰ* "dashamirësinë si ajo që u tregohet të afërmeve". Pra, ashtu siç një nënë që i shërben fëmijës pa marrë parasysh se e ka detyrim ndaj tij ose pa pritur ndonjë shpërblim prej tij, në të njëjtën mënyrë njeriu i kësaj grade ka një dashuri amnore dhe bëhet dashamirës për mbarë njerëzimin.

Nga grada e *Rrahmanit*, kur rob i përparon akoma më shumë, fillon të reflektojë cilësinë *Rabbil-alemin* (Zoti i botëve) të Zotit. Kjo do të thotë se në shikimin e tij, ai nuk sheh më vetëm individët, por gjithë sistemin dhe ai bëhet mbikëqyrës i botës. Ai përqendrohet në reformën e botës dhe arrin ta ndryshojë gjendjen e shoqërisë.

Ky rrugëtim nga lart poshtë dhe nga poshtë lart, që është përmendur në këto attribute të Zotit, fsheh sekretin e gradave të larta dhe për kërkimtarët është një mëshirë shumë e madhe.





إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾

*Ijjāke na'budu ve ijjāke neste'in*

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. (El-Fatiha 1:5)

### Kuptime leksikore

إِيَّاكَ *Ijjake* vetëm Ty

Si ligjërim i thjeshtë duhet të ishte نَعْبُدُ Të adhurojmë Ty, por për të theksuar, *k*-ja është vendosur përpara foljes, dhe *k*-ja “ty” nuk mund të vendosej, po shtuar *ijja* që i referohet përmrit. Andaj, kuptimi i fjalisë *ijjake na'budu* është “vetëm Ty të adhurojmë” ose “Ty të veçojmë për adhurimin”.

نَعْبُدُ *Na'budu* adhurojmë

Forma e kohës së kryer të thjeshtë është عَبَدَ ‘*abede* adhuroi dhe ajo ka kuptimet si më poshtë:

عَبَدَ اللَّهُ طَاعَ لَهُ وَ خَضَعَ وَ ذَلَّ وَ خَدَمَهُ وَالْأَرْمَ شَرَائِعَ دِينِهِ وَ وَحَدَّهُ.

“*Abede Allabe* do të thotë iu nënshtrova Atij, uli kokën përpara Tij, i shërbeu, zbatoi me rregullsi porositë e fesë së Tij dhe pranoi njëshmërinë e Tij”.<sup>97</sup>

Një kuptim tjetër i fjalës ‘*abd* është të ndjekësh gjurmët e tjetrit. Kështu që, thuhet طَرِيقُ مَعْبُدٍ që do të thotë مَذَلٌّ, pra një rrugë është shkelur kaq shumë saqë ka pranuar në vete gjurmët e këmbëve.

Kjo tregon që عبادة *'ibadet* (adhurim) mund t'i bësh atij që është i vetëm në cilësitë e tij, që është i pashoq dhe të cilit ke mundësi t'i nënshtrohesh. Sepse nëse nuk bëhet dot nënshtrimi ndaj tij, adhurimi është i pakuptimtë.

Dihet që një qenie e tillë është vetëm e Zotit të Madhërishëm, sepse nuk ka asnjë tjetër përveç Tij, që njeriu në kuptimin e plotë të mund t'i nënshtrohet, ta zgjedhë atë dhe të bëhet i atij. Çdo nënshttrim tjetër që i bën njeriu ndokujt tjetër përveç Zotit, mbetet i kufizuar dhe ai detyrohet të shoqërojë edhe persona të tjerë ose ligje të tjera në nënshttrimin e tij.

نَسْتَعِينُ *Neste'in* ndihmë kërkojmë

Vjen nga fjala *isti'aneh* që do të thotë "të kërkuarit ndihmë". Kështu që, *ijjake neste'in* do të thotë: Ty të veçojmë për të kërkuar ndihmë dhe askënd tjetër nuk e quajmë të denjë për këtë.

## Komentim

Arsyeja pse ndryshoi narracioni nga ky ajete?

Në ligjërimin nga *El-Hamdulil-lah* (Lavdia është e Allahut) deri te *Maliki jeumid-din* (Sunduesit të ditës së gjykimit) duket sikurse për robin Zoti është i fshehtë dhe ai e përshkruan atë, por nga ajeti *Ijjake na'budu* (Vetëm Ty të adhurojmë), papritmas ai i drejtohet Zotit. Disa të paditur ngritën akuzë se gjoja ky ligjërime nuk është i një niveli letrar. Përkundrazi, është shembull i një ligjërimi shumë të bukur. Qenia e Zotit të Madhërishëm është e fshehtë pas të fshehtave dhe nuk është e dukshme për shikimin fizik të robit. Robi mund ta njohë Atë vetëm nëpërmjet cilësive të Tij dhe, duke e përmendur Atë, kaq shumë mund

t'i afrohet, saqë mund ta shohë Atë me sytë e zemrës. Këto ajete zbulojnë në mënyrë të këndshme që kur robi thellohet në *Rabbil-alemin*, *Rrahman*, *Rrahim* dhe *Maliki jeumid-din*, ai do ta kuptojë realitetin dhe zemra e shpirti i tij kaq shumë do të pushtohen nga dashuria ndaj Zotit, saqë vetvetishëm ai do të shpërthejë duke thënë:

*"O Zot, vetëm Ty të adhuroj dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkoj".*

Pra, me ndërrimin e vetave është shpalosur se nëse robi përsiatet për këto attribute të Zotit që ka treguar Kurani Famëlartë, ai arrin takimin me Zotin, duke iu zbuluar Qenia e Tij e bekuar.

Në një hadith thuhet:

عن أبي هريرة عن رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول الله قسمتُ الصلاة بيني وبين عبدي نصفين ولعبيدي ما سأل، فإذا قال العبد : الحمد لله رب العالمين، قال الله تعالى : حمدني عبدي، وإذا قال : الرحمن الرحيم، قال الله تعالى : أثني علي عبدي، وإذا قال : مالك يوم الدين، قال : مجدني عبدي، وقال مرة : فوض إلي عبدي، فإذا قال : إياك نعبد وإياك نستعين، قال : هذا بيني وبين عبدي ولعبيدي ما سأل، فإذا قال : إهدنا الصراط المستقيم، صراط الذين أنعمت عليهم، غير المغضوب عليهم ولا الضالين، قال : هذا لعبدي ولعبيدي ما سأل-

Hazret Ebu Hurejre<sup>ra</sup> ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> duke thënë: "Allahu tha: Unë e kam ndarë përgjysmë suren El-Fatiha mes Meje dhe robit Tim. Çdo gjë që më kërkon robi Im (përmes saj), do t'ia jap. Kur robi thotë: "Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve", Allahu i Madhërishëm thotë: "Robi Im Më lavdëroi", (*hamd*). Dhe kur ai thotë: "Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit", Allahu i Madhërishëm thotë: "Robi Im Më përshkroi", (*bëri thena*). Dhe kur ai thotë: "Sunduesit të ditës së gjykimit", Zoti thotë: "Robi Im përmendi lartësimin Tim", (*mexhd, temxhid*) dhe gjithashtu thotë: "Robi Im u dorëzua tek

Unë". Dhe kur ai thotë: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë", Allahu i Madhërishëm thotë: "Kjo pjesë është e ndarë mes Meje dhe robit Tim dhe robi Im do ta ketë atë që Më kërkoi". Dhe kur ai thotë "Na udhëzo në rrugën e drejtë ... (e deri në fund të sures)", Allahu i Madhërishëm thotë: "Kjo (lutje) është e robit Tim, dhe robi Im do ta ketë atë që Më kërkoi".<sup>98</sup>

Sipas hadithit të mësipërm, kuptojmë:

- 1) *Hamd, thena dhe temxhid* kanë ndryshime me njëra-tjetrën.
- 2) Ajeti *Maliki jeumid-din* "Sunduesit të ditës së gjykimit" nënkupton mbështetje të plotë ndaj Zotit. Pra, tregon që njeriu që Allahun e Madhërishëm në çdo gjë e konsideron si dhënësi i rezultatit përfundimtar dhe thotë: "*El-Hamdulil-lah*", pranon me bindje të plotë çdo vendim të Allahut. Dhe kur ai mbështetet kaq fuqimisht dhe kaq bindshëm ndaj Tij, pse Allahu të mos e mëshirojë dhe të mos e falë atë?!
- 3) Lutja për të kërkuar bekime që përmendet në suren El-Fatiha, do t'u pranohet muslimanëve dhe ata me siguri do t'i gëzojnë ato bekime, sepse hadithi thotë "robi Im do ta ketë atë që Më kërkoi".

**Dy arsye përse vjen "adhurojmë", përpara se "ndihmë kërkojmë"**

Siç shohim në këtë ajet, së pari themi *na'budu* adhurojmë dhe pastaj *neste'in* ndihmë kërkojmë. Disa ngrenë pyetje se derisa edhe adhurimin

e Zotit mund ta bëjmë vetëm me ndihmën e Tij, përse themi "Të adhurojmë" së pari? Pra, sipas tyre, duhet të ishte *neste'in* së pari.

Përgjigjja: Pa dyshim që edhe adhurimin mund ta bëjmë vetëm me ndihmën e Zotit, por këtu nuk përmendet *i'anet*, por *isti'anet*. Kush mund të mohojë që robi mund t'i kërkojë ndihmë Zotit, vetëm pasi të bëhet rob i Tij? Ai që nuk priret fare nga adhurimi ndaj Zotit, pse mund t'i kërkojë ndihmë Atij? Kështu që, pavarësisht se robi nuk mund ta adhurojë Zotin pa pasur ndihmën dhe bekimin e Tij, ai do të mendojë t'i kërkojë ndihmë, vetëm pasi ta ketë ulur kokën te pragu i Tij. Andaj, së pari vjen *na'budu* dhe pastaj *neste'in*.

Përgjigjja e dytë e kësaj pyetjeje është që vullnetin e bën njeriu dhe mundësia për ta realizuar veprën vjen prej Zotit të Madhërishëm. Po të ishte edhe vullneti prej Zotit, veprat e njeriut do të quheshin të imponuara. Kështu që, ky ajet tregon se kur robit i lind dëshira për ta adhuruar Zotin, ai Zotit duhet t'i kërkojë ndihmë për ta realizuar dëshirën duke thënë:

*O Zoti im! Dua të të adhuroj Ty, por këtë nuk e bëj dot pa pasur ndihmën Tënde, andaj, më ndihmo dhe më mundëso që të të adhuroj vetëm Ty dhe askënd tjetër.*

## **Kuptimi i adhurimit**

*Ibadeti*, adhurimi është përlësia e skajshme dhe e sinqertë. Andaj, *ibadet* do të thotë që robi të krijojë brenda vetes atributet e Zotit të Madhërishëm. Format e jashtme të *ibadetit* janë vetëm për të krijuar nxitje në zemër. Pa dyshim, *ibadeti* pasqyron gjendjen e zemrës dhe veprat që burojnë për shkak të asaj gjendjeje. Kurse ngritja në kohë të

veçanta, qëndrimi drejt Qabes, *rukutë* (përkuljet) dhe *sexhdet* nuk janë adhurimi i vërtetë. Ato janë shenjat fizike që synojnë përqendrimin e robit në adhurim, sepse gjendja e jashtme e njeriut ndikon në zemrën e tij. Pra, lëvizjet fizike janë si enë, të cilën duhet ta mbushim me qumështin e njohjes së Zotit, ose janë si lëvozhgë, por që e ruan bërthamën.

### **Arsyeja pse ky dhe ajetet vijuese kanë narracion në shumës**

Ky dhe ajetet vijuese flasin në numrin shumës. Pra, thonë “adhurojmë”, “ndihmë kërkojmë” dhe “na udhëzo në rrugën e drejtë”. Kjo tregon se Islami është një fe që synon qytetërim. Ai kërkon zhvillim për të gjithë dhe jo thjesht për individin. Gjithashtu që, çdo musliman është caktuar si mbikëqyrës për muslimanin tjetër. Muslimani ka për detyrë jo vetëm të adhurojë vetë, por të nxitë edhe të tjerët në adhurim dhe të mos dorëzohet në këtë përpjekje, derisa t'i bashkojë të gjithë në këtë detyrë. Ai të ketë mbështetje ndaj Zotit jo thjesht si individ, por të përpiqet maksimalisht derisa edhe të tjerët t'i bashkohen për t'iu mbështetur tërësisht Zotit. Ai të kërkojë udhëzim jo thjesht për veten e vet, por të këshillojë edhe të tjerët që edhe ata t'i bashkohen atij për t'i kërkuar singërisht ndihmë Zotit. Robi kështu duhet të veprojë, derisa në çdo lutje të mos thotë vetëm “unë”, por “ne”. Ky është shpirti i *tebligut* (thirrjes drejt Zotit) dhe i *terbijetit* (edukimit) që e çoi Islamin shumë përpara, brenda pak vitesh. Dhe sot muslimanët mund të përparojnë vetëm duke e krijuar këtë ndjenjë në zemrat e tyre. Derisa muslimanët nuk do të përpiqen për të shprehur denjësisht “adhurojmë”, “ndihmë

kërkojmë" dhe "na udhëzo", ata nuk do të gëzojnë pozitë as në këtë botë e as në botën tjetër.

Realisht, edhe adhurimi, edhe kërkimi i ndihmës dhe edhe kërkimi i udhëzimit mund të bëhen vetëm kolektivisht, sepse një individ mund të bëjë adhurimin në një kohë dhe në një masë të kufizuar. Rrethin e adhurimit e zgjeron ai që bashkon me vete edhe fëmijët, edhe fqinjët dhe në këtë mënyrë, ai e zgjeron edhe kohën e vet. Adhuresi i vërtetë është ai që nuk lejon që gjërat që i përkasin Padronit të tij, të bien në duart e armiqve, kurse ai që rri duarlidhur duke parë se përmishtëja e Padronit po plaçkitet dhe nuk përpiqet për ta mbrojtur atë, kurrësi nuk mund të jetë adhures i vërtetë.

### **Ajeti hedh poshtë mendimet e gabuara rreth imponimit dhe lirisë së pakufizuar**

Ajeti *Ijjāke na'budu ve ijjāke neste'in* hedh poshtë edhe mendimet që po përhapen për sa i përket imponimit dhe lirisë së pakufizuar. Në lidhje me veprat njerëzore, janë krijuar dy keqkuptime. Disa thonë se të gjitha veprat që bën njeriu, janë të imponuara, që do të thotë se ai është i detyruar t'i bëjë ato. Ky mendim është i përhapur edhe te fetarët, edhe te filozofët. Dhe tanimë një shtresë e psikoanalistëve, në një aspekt, po e beson këtë mendim. Përfaqësuesi i kësaj shkolle është profesori austriak Dr. Freud (Frojdi).

Për sa u përket fetarëve që e kanë keqkuptuar këtë temë për shkak të besimit të devijuar, ata thonë se Allahu i Madhërishëm është Sunduesi i gjithçkaje, dhe si një inxhinier që kur ndërton një godinë, një tullë e vendos në lartësi e një tjetër në ultësi, edhe Allahu ushtron vullnetin e

Tij për të bërë të mirë a të ligë kë të dojë. Kështu që, sipas tyre, Ai disa i krijoi të mirë dhe disa të këqij.

Të krishterët e sollën çështjen e imponimit, për shkak se pranuan teorinë e mëkatit të trashëguar. Sepse, për sa kohë që njeriu nuk mund të lirohet nga mëkati i trashëguar pa e pranuar *shlyerjen*, të gjithë ata që nuk e pranojnë teorinë e shlyerjes, janë të detyruar të mbeten mëkatarë.

Edhe teoria e *mishërimit* (تناسخ *tenasub*) [e fesë hindu] përkrah pikëpamjen e imponimit, sepse jeta që njeriu ka pësuar për shkak të mëkateve të jetës së mëparshme, nuk mund të lirohet nga pasojat e mëkateve të vjetra.

Për sa u përket filozofëve, ata e bazonin mendimin vetëm në përvojën e tyre, që disa njerëz, pavarësisht nga përpjekja, nuk shpëtojnë dot nga mëkati. Por Dr. Freud këtë e shtroi si një çështje shkencore. Sipas tij, periudha kur njeriu merr dije fillon që në fëmijëri, përpara moshës së pjekurisë, kurse veprimet me vullnetin e lirë ai i bën kur është i pjekur, andaj, nuk mund të thuhet se vullneti i tij është i lirë, përkundrazi është i ndikuar nga prirjet dhe nga shoqëria e fëmijërisë. Sipas tij, edhe pse njeriu mendimet dhe veprimet e tij i konsideron të bëra me vullnet të lirë, ato janë thjesht rrjedhojë e ndikimeve të fëmijërisë, të cilat i bëhen pjesë e qenies së tij, andaj nuk i quan si të jashtme, por rezultat i vullnetit të vet.

Ky mendim i Dr. Freud nuk është i ri, madje edhe Islami e ka përmendur atë. Për shembull, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> thotë se fëmija lind në natyrën e Islamit (nënshtrimin), por:

أَبَوَاهُ يَهُودَانَهُ أَوْ يُنَصِّرَانَهُ-



“prindërit e bëjnë hebre ose të krishterë”.<sup>99</sup>

Pra, sipas këtij hadithi, fëmija përpara se të rritet pranon mendimet e gabuara të prindërve dhe pa menduar, ndjek rrugën e tyre.

Gjithashtu, duke porositur se fëmijëve të porsalindur t'u këndohet ezani në vesh, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> tregoi rëndësinë dhe ndikimin e gjerë që kanë mbresat e fëmijërisë te njeriu.

### **Hidhet poshtë teoria se njeriu nuk është i lirë në vullnetin e tij**

Në ajetet *Māliki jeumid-dīn* (Sunduesit të ditës së gjykimit) dhe *Ijāke na'budu* (Vetëm Ty të adhurojmë), Kurani Famëllartë rrëzon pjesën e gabuar të këtyre mendimeve. Zoti është Sunduesi i kohës së gjykimit. Nëse veprat janë të imponuara, shpërblimi dhe ndëshkimi nuk kanë asnjë kuptim. Kurse me fjalët “vetëm Ty të adhurojmë”, Kurani tregon se njeriu si qenie është i lirë. Ndonëse pjesërisht ai është i kufizuar, por është i lirë deri në atë masë sa, kur të gjendet përpara udhëzimit, të zgjedhë vetë një rrugë të re. Për shembull, një njeri që është i ndikuar nga pasojat negative, nëse përsiatet në atributet e Zotit të Madhërishëm, mund t'i lindë në shpirt thirrja “vetëm Ty të adhurojmë”, madje i lind. Këtë gjë nuk e mohon dot njeri. Dr. Freud dhe nxënësit e tij çfarë përgjigje i japin faktit se rrethanat ndryshojnë, mendimet ndryshojnë dhe edhe bota nuk mbetet në një gjendje të vetme? Ndikimet e fëmijërisë po të ishin aq të forta sa që njeriu të mos mund të lirohej prej tyre, duhej që, që nga Ademi e gjer më sot, bota të ndiqte vetëm një rrugë. Por shohim që bota po ndryshon vazhdimisht, gjë që tregon se ekziston edhe mundësia që njeriut t'i ndryshojë kahu edhe i atyre mendimeve, të cilat drejtoheshin nga ndikimet e fëmijërisë

së tij. Kurani Famëlartë ka dhënë argumente të fuqishme për këtë temë, por ky nuk është momenti t'i parashtroj ato dhe më duhet të mjaftohem me përfundimin përgjithësues që thashë sa më sipër.

### **Hidhet poshtë teoria se njeriu është tërësisht i lirë në vullnetin e tij**

Mendimi tjetër kundër teorisë së imponimit është që njeriu është tërësisht i lirë në punët e tij dhe se Zoti i Madhërishëm nuk ndërhyr aspak në to. Islami e hedh poshtë edhe këtë mendim dhe thotë se njeriu nuk mund t'i anashkalojë tërësisht ndikimet që i bëhen nga rrethi i tij shoqëror, andaj duhet që një Qenie superiore e lirë nga të gjitha ndikimet, ta mbikëqyrë njeriun dhe sa herë që situata t'i dalë jashtë kontrollit njeriut, Ai ta ndihmojë dhe ta shpëtojë atë.

Duke na mësuar lutjen "Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë", Kurani Famëlartë na bën me dije që Zoti juaj nuk rri duarlidhur, por sheh problemet tuaja, andaj, lutjuni Atij, Ai do t'ju japë; trokitini në derë, Ai do t'ju hapë.



## أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾

### *Ihdinas-sirātal-mustekīm*

Na udhëzo në rrugën e drejtë! (El-Fatiha 1:6)

### Kuptime leksikore

أَهْدِنَا (*Ihdina*) dhe tri kuptime të saj

*Ihdina* rrjedh nga هَدَى “*beda*”. هَدَى إلى الطريق do të thotë بَيَّنَّه له “ia tregoi rrugën”. هَدَى الْعُرُوسَ إِلَى بَعْلِهَا do të thotë زَفَّهَا إِلَيْهِ “nusen e çoi deri te dhëndri”. هَدَى فَلَانًا do të thotë تَقَدَّمَه “eci përpara tij”. جَاءَتِ الْخَيْلُ يَهْدِيهَا فَرَسٌ اشْقَرُ do të thotë يَتَقَدَّمُهَا “Erdhën kuajt, atyre u printe një kalë i kuq.”<sup>100</sup>

Kështu që, folja “*beda*” ka tri kuptime: (1) i tregoj dikujt rrugën, (2) përcjell dikë deri te rruga dhe (3) i prij dikujt rrugën duke ecur vetë përpara.

Fjala *bidaje* në Kuran, në kuptime të ndryshme

Edhe Kurani Famëlartë ka përdorur fjalën *bidaje* në kuptime të ndryshme:

T’i japësh dikujt aftësitë e punës dhe t’ia vësh në funksion. Për shembull, Kurani Famëlartë thotë:

أَعْطَى كُلَّ شَيْءٍ خَلْقَهُ ثُمَّ هَدَى

“Është Ai që i dha çdo gjëje krijimin (trajtën dhe forcat) dhe më pas *ia vuri në funksion*”.<sup>101</sup>

Një kuptim tjetër i kësaj fjale, sipas Kuranit Famëlartë, është të thërrasësh dikë drejt udhëzimit:

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أَئِمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا

“Dhe Ne kemi bërë prej tyre dijetarë, që thërrisinin (drejt Tevratit) me urdhrin Tonë”.<sup>102</sup>

Kuptimi i tretë i kësaj fjale që tregon Kurani Famëlartë është që t’i prijesh dikujt për ta sjellë në një vend të caktuar.

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي هَدَانَا لِهَذَا

“Lavdia është e Allahut që na udhëzoi për këtë”.<sup>103</sup>

Pra, sipas këtij ajeti, besimtarët do të shprehen: të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, që na priu dhe na solli deri në xhenet.

Një kuptim tjetër i kësaj fjale është të krijosh dashuri në zemrën e tjetrit për rrugën e drejtë. Siç thotë Kurani Famëlartë:

وَمَنْ يُؤْمِنْ بِاللَّهِ يَهْدِ اللَّهُ قَلْبَهُ

“Atij që beson në Allah, Ai ia udhëzon zemrën”,<sup>104</sup> pra që do të thotë krijon dashuri për udhëzimin dhe për gjërat e mira. Folja jehdi në këtë ajet, nuk mund të ketë vetëm kuptimin e tregimit të rrugës, sepse bëhet fjalë për një njeri që tashmë ka besuar në Allah. Ai që ka besuar në Allah, e ka gjetur rrugën.

Një tjetër kuptim i kësaj fjale që na tregon Kurani Famëlartë është sukses. Duke folur për hipokritët, në suren En-Nur, Zoti i Madhërishëm thotë se hipokritët thonë se po t’u jepet urdhri i luftës,

ata patjetër do të dalin për luftë, por veprat i kanë të dobëta. Të tillëve duhet t’u thuash:

Mos u betoni, por praktikisht tregoni bindje të plotë, sepse Allahu është i mirinformuar për veprat tuaja.

Pastaj thotë: O i Dërguar: Thuaju: Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit të Tij, e nëse e ktheni shpinën edhe pas këtij urdhri, i Dërguari ka përgjegjësinë e tij dhe ju keni përgjegjësinë tuaj, dhe mbajeni mend:

وَإِنْ تُطِيعُوهُ تَهْتَدُوا

“Nëse do t’i bindeni të Dërguarit (në këtë çështje) *do të keni sukses dhe do të fitoni*”.<sup>105</sup>

Kurani Famëlartë gjithashtu thotë:

وَالَّذِينَ أَهْتَدُوا زَادَهُمْ هُدًى

“Ata që e pranojnë këtë *hidajet* (që Allahu ua ka sjellë dhe e përthithin në veten e tyre) Ai do t’i shtojë ata akoma më shumë në *hidajet*”.

Nga Kurani Famëlartë gjithashtu kuptojmë se *hidajet* nuk i referohet një gjëje të vetme, por ai ka nivele të pafundme. Ata që njihen me bekimet e njërit nivel, Zoti ua tregon bekimet e nivelit tjetër.

صراط *Sirat*: rrugë

Kjo fjalë shkruhet edhe me shkronjën *sad*, edhe me shkronjën *sin*. Pra, صراط dhe سراط do të thotë “rrugë e hapur, pa pengesa”. Në arabisht thuhet: سَرَطْتُ الطَّعَامَ, që do të thotë “hëngra ushqimin lehtësisht”. Një

rruge të pastër e të sheshtë i thonë *sirat*, sepse ai që e përshkon një rrugë të tillë është sikur e ha atë.<sup>106</sup>

مستقيم *Mustekim*

Vjen nga إستقامة *istikameh*. Në Mufredat thuhet:

الإستقامة يُقال في الطريق الذي يكون على خطٍ مُوسْتَوٍ و به شُبّه طريقُ المحقِّ نحو إهدانا الصراط المستقيم.

*Istikameh* i thonë rrugës që është e drejtë dhe nga kjo cilësohet edhe rruga e atij që ndjek të vërtetën. Kështu është kuptimi edhe në ajetin: "Na udhëzo në rrugën e drejtë".<sup>107</sup>

## Komentim

Një lutje e përsosur në këtë ajet

Në këtë ajet Zoti i Madhërishëm na ka mësuar një lutje që është e pashembullt në përsosmërinë e saj. Kjo lutje nuk është vetëm për një gjë të caktuar, madje lidhet me çdo nevojë të vogël apo të madhe, me çdo çështje të besimit apo të botës.

Çdo punë që bëjmë, qoftë e besimit apo e botës, kërkon një metodë të caktuar për t'u realizuar. Do të kemi sukses vetëm nëse zbatojmë metodën e saj të duhur, përndryshe jo. Përveç kësaj, nganjëherë për një punë të caktuar na dalin shumë metoda për ta realizuar. Disa prej tyre mund të jenë të lejuara e disa të tjera edhe të palejuara. Edhe nga ato metoda që janë të lejuara, disa mund të na çojnë te rezultati më shpejt e disa me vonesë.

Në lutjen *Ihdinas-siratal-mustekim* Zoti i Madhërishëm na mësoi t'i lutemi që Ai të na udhëzojë për çdo punë drejt metodës që është e

mbarë dhe që na çon sa më shpejt drejt suksesit. Sa e thjeshtë, e përsosur dhe e gjerë është kjo lutje! A ekziston ndonjë punë në jetën tonë, ku nuk na duhet kjo lutje?!

### **Tri parime të arta për përmirësimin e veprave**

Gjithashtu, një njeri që është mësuar ta bëjë këtë lutje vazhdimisht, sa shumë do të përpiqet për t'i sjellë rezultat pozitiv përpjekjes së vet?! Sepse atij që i jepet mësimi se çdo punë ka mënyra edhe të lejuara edhe të ndaluara për të realizuar dhe se gjithmonë duhet të kërkojë ato që janë të lejuara dhe edhe ndër to, ato që janë më të mundshme dhe më shpejt të realizueshme, ai do ta bëjë këtë mësim pjesë të jetës së tij. Ai që i lutet Allahut të Madhërishëm: "Më udhëzo në *siratal-mustekim*", me siguri do të jetë edhe i ndikuar nga lutja dhe edhe përpjekjet do t'i bëjë në kërkim të metodës që quhet *siratal-mustekim*. Pra, a mund të dyshojmë në lartësinë e synimeve, në mbarësinë e veprave dhe në përpjekjet e singerta të atij që në punët e tij i merr parasysh këto parime:

- 1) të gjitha punët t'i kryejë me metoda të lejuara,
- 2) të mos ndalet në një pikë të caktuar, madje të ketë dëshirë për përparime të pakufishme,
- 3) të mos humbë kohën duke bërë devijime, madje të ndjekë një rrugë, me të cilën sa më shpejt ta përfundojë punën,

Mendoj se nëse muslimanët e bëjnë këtë *dua* me qëndrueshmëri dhe singëritet të plotë dhe thellohen edhe në kuptimet e saj, përveç dobisë

që do të kenë për shkak të lutjes, ata do të fitojnë shumëçka për të përsosur edhe karakterin e tyre.

## **Një akuzë e jomuslimanëve rreth këtij ajeti dhe përgjigja**

Disa jomuslimanë kundërshtojnë duke thënë:

Muslimanët në çdo namaz e bëjnë lutjen: “Na udhëzo në rrugën e drejtë” dhe këtë e bënte përditë edhe Profeti i tyre. Po pse, akoma nuk e kanë gjetur rrugën e drejtë ata?!

Sa qesharake është kjo akuzë! Habitesh që shumë nga të krishterët dhe hindutë e shkolluar e bëjnë këtë pyetje me bindje se muslimanët nuk kanë asnjë përgjigje.

Së pari, ju kam treguar më sipër që në arabisht “*ihdina*” pra, fjala “*hidajet*” nuk do të thotë vetëm “na trego”, por do të thotë “na udhëzo dhe na merr në këtë rrugë, duke na prirë përpara”. Andaj, njerëz të ndryshëm mund të gjejnë kuptime të ndryshme nga kjo lutje. Ata që ende nuk e dinë se çka është udhëzimi (*hidajeti*) dhe ku dhe në cilën fe gjendet ai, do të mjaftohen me kuptimin:

*O Zot na trego se çfarë është udhëzimi Yt dhe se ku gjendet ai!*

Kurse disa të tjerë që e dinë se cila është rruga e Zotit, por kanë vështirësi ta ndjekin atë qoftë për shkak të dobësive të veta, qoftë për shkak të kundërshtimeve nga të afërmit apo shokët, ose qoftë për shkak të largësisë fizike me njeriun e udhëzuar, ose qoftë për shkak të mungesës së njerëzve të dëlirë në shoqërinë e tyre, ata do të bëjnë po këtë lutje, por me kuptimin:



*O Zot më ço deri tek udhëzimi. Unë e kam kuptuar me anë të argumenteve se cila është rruga Jote, por kam pengesa për të arritur tek ajo, ndaj, Ti m'i largo këto pengesa.*

Kurse një tjetër që e ka kuptuar se cila është rruga e drejtë, e ka pranuar atë, edhe ai ka pjesën e vet në këtë lutje, sepse ai do të lutet:

*O Zot! Rruga Jote është e gjerë. Metodatat e kërkimit Tënd janë të pakufishme. Me mirësinë Tëndë gjithmonë më bëj të përparoj në këtë rrugë, që unë të mos ndalem në një vend, madje të zbuloj sekretet e reja të vërtetësisë dhe mënyrat e reja të përpjekjeve në drejtimin Tënd.*

## **Kurani me këtë ajet e ka zgjeruar botëkuptimin e njeriut për dijen**

Duke i marrë parasysh këto tri kuptime, a ka njeri në botë që mund të pretendojë se nuk i nevojitet kjo lutje?! Profeti i muslimanëve, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, pa dyshim ishte njeri i përsosur, por Zoti i Islamit gjithashtu zotëron fuqi të pakufishme. Sado të përparojë njeriu, Zoti do t'i krijojë horizonte të reja, rrjedhimisht, ai do të jetë nevojtar i lutjes:

*Ihdinas-sirātal-mustekīm: Na udhëzo në rrugën e drejtë!*

Jo vetëm në çështjen e besimit, dija e njeriut edhe në shkencat e kësaj bote gjithmonë ka nevojë të zhvillohet. Andaj, edhe në punët e kësaj bote njeriu ka nevojë të bëjë lutjen: *Ihdinas-sirātal-mustekīm*, në mënyrë që përmes saj, ai ta shtojë dijen e tij.

E vërteta është që kjo jo vetëm që nuk lë vend për kundërshtim, por tregon pikëpamjen e gjerë që ka Islami për dijen dhe përbën një

argument të fuqishëm të epërsisë së Kuranit Famëlartë. Kurani zbriti në një kohë kur ekzistonin fetë e tjera dhe deklaroi që ai e përsosi fenë dhe i shfuqizoi fetë e mëparshme. Megjithatë, ai nuk deklaroi si fetë e tjera që dija ka përfunduar në kohën e tij, por tregoi që përmes tij, dija do të shtohet gjithnjë e më shumë. Dhe për këtë Kurani u mësoi edhe këtë lutje muslimanëve dhe i porositi që ta bënin rreth 35 herë çdo ditë. Në këtë mënyrë, Kurani Famëlartë sa shumë e ka zgjeruar botëkuptimin e njeriut për dijen!

### **A do të shfuqizohet edhe Kurani për shkak të zhvillimit të dijes?**

Disa njerëz ngrenë akuzë duke thënë se ky ajet tregon se Kurani Famëlartë nuk qenka udhëzimi i fundit, sepse nëse pranojmë që dija e njeriut do të vijojë të përparojë, pse mos të pranojmë që dikur edhe Kurani Famëlartë do të shfuqizohet dhe atë do ta zëvendësojë ndonjë libër tjetër më i mirë.

**Përgjigja** e kësaj pyetjeje është që në radhë të parë, ne nuk kemi ndonjë kundërshtim nëse vjen ndonjë libër më i mirë se Kurani Famëlartë dhe që arrin ta shfuqizojë atë, por kanë kaluar trembëdhjetë shekuj dhe nuk erdhi një libër i tillë. Filozofët dhe ndjekësit e feve të gabuara nuk kanë lënë përpjekje pa bërë, por deri më tani dështuan. Andaj, derisa nuk paraqitet ndonjë libër më i mirë se ai, pse të shqetësohemi për këtë pyetje?

**Përgjigja e dytë** është që Kurani Famëlartë në fakt është një gjithësi shpirtërore, sikur gjithësia fizike. Pra, kur njeriu çdo ditë përparon në shkencat e kësaj bote dhe atij nuk i nevojitet një botë e re, madje ai

vijon të zbulojë sekrete të reja po të kësaj bote, në të njëjtën mënyrë pas zbritjes së Kuranit Famëlartë që është si një botë shpirtërore, nuk nevojitet ndonjë libër i ri, sepse Kurani nuk e ndaloi zhvillimin e dijes. Ashtu siç studimi i ligjeve të kësaj bote i shton njeriut dijet, në të njëjtën mënyrë, edhe Kurani Famëlartë zotëron dije të pakufishme që do të zbulohen në varësi të ngritjes shpirtërore të njeriut. Pra, sa më shumë që njerëzit thellohen dhe tregohen të singertë ndaj lutjes: *Ihdinas-sirātal-mustekīm*, aq më shumë atyre u zbulohen sekretet e Kuranit Famëlartë. Andaj, me zbritjen e Kuranit si libër i fundit, nuk u ndal zhvillimi i dijes, përkundrazi, ajo ka përparuar edhe më shumë. Këtë gjë na tregon Kurani Famëlartë edhe në një ajet tjetër:

وَالَّذِينَ آمَنُوا زَادَهُمْ هُدًى

“Ata që udhëzohen, Zoti ua shton udhëzimin (*hidajetin*) edhe më shumë”.<sup>108</sup>

Kështu që, *hidajeti* nuk është diçka fizike, por është zinxhir i gjerë i të vërtetave. Sapo të kapni një hallkë të këtij zinxhiri, do t’ju shfaqet hallka tjetër. E them nga përvoja personale që nuk ka ndonjë çështje shpirtërore, për të cilën Kurani Famëlartë nuk na siguron dije të përsosur. Pas studimit të Kuranit, kur studion një çështje të caktuar në librat e tjerë, të duket sikur kërkon ujë në vende të tjera, edhe pse qëndron te burimi.

### **Kuptimet e Kuranit nuk mbarojnë me *tefsiret* e mëparshme**

Habitem edhe për ata të cilët përditë bëjnë lutjen: *Ihdinas-sirātal-mustekīm*, por mendojnë se kuptimet e Kuranit janë gjithçka që kanë shkruar komentuesit e mëparshëm dhe se çdo komentim tjetër është i

ndaluar. Po të ishte e vërtetë kjo gjë, përse Zoti i Madhërishëm do të na mësonte këtë lutje? Sipas besimit të tyre del që Zoti i Madhërishëm nuk paska ndonjë gjë të re për t'u dhënë! Atëherë ata më mirë t'i blejnë ose t'i huazojnë dikujt tjetër *tefsiret* e vjetra, t'i lexojnë dhe të mos lodhen duke bërë lutjen: *Ihdinas-sirātal-mustekīm*

### **Ky ajet është lutje për çdo çështje të botës e të besimit**

Kjo lutje është caq e përsosur saqë njeriu mund ta bëjë në çdo çështje që ka lidhje qoftë me besimin, qoftë me botën. Gjithashtu, kërkimtari i udhëzimit çfarëdo feje t'i përkasë, nuk ka arsye që ta kundërshtojë këtë lutje. Sepse në *Ihdinas-sirātal-mustekīm* kërkohet vetëm rruga e drejtë dhe jo e shtrembër. Ajo nuk përmend ndonjë fe, ndonjë rrymë apo ndonjë metodë të caktuar, por ju mëson të kërkon vetëm e vetëm të vërtetën e pastër, lutje të cilën mund ta bëjë çdo njeri, pa e dëmtuar bindjen ose mendimin e vet. Pra, këtë lutje nuk mund ta kundërshtojë as një i krishterë, as hebre, as hindu, as i fesë së Zarathustrës, as budist dhe as ateist. Ateisti pavarësisht se nuk beson në Zot, të paktën mund të thotë: *Nëse ka Zot, i lutem që të më tregojë rrugën e drejtë!*

Andaj, kjo lutje është e përsosur, e padëmshme dhe e përgjithshme, të cilën çdo njeri në çdo çështje mund ta bëjë pa pasur asnjë kundërshtim.

E them nga përvoja. Atyre jomuslimanëve që u kam thënë ta bënin këtë lutje dhe që e bënë, Zoti i Madhërishëm ua tregoi vërtetësinë e Islamit dhe në bazë të përvojës, kam bindje të plotë se kushdo që e bën këtë lutje me zemër të sinqertë, Zoti i Madhërishëm patjetër do t'i hapë ndonjë rrugë që ai ta gjejë udhëzimin. Nuk është e mundur që të

ekzistojë Krijuesi i botës, dhe përgjëruesi, pasi të ketë kërkuar udhëzimin, të kthehet duarbosh nga dera e Tij.



صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ  
غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

*Sirātal-ledhīne en‘amte ‘alejhim  
gajril-magdūbi ‘alejhim ve led-dāl-līn.*

“Në rrugën e atyre që i bekove, që nuk tërhoqën zemërimin dhe që nuk devijuan”. (El-Fatiha 1:7)

### Kuptime leksikore

أَنْعَمْتَ *en‘amte*

Vjen nga إِنْعام *in‘am*, që do të thotë të jap bekim dhe të jap diçka shtesë.<sup>109</sup>

Kjo fjalë përdoret atëherë kur marrës të bekimit janë njerëzit.<sup>110</sup> Për shembull, nuk thuhet që filan njeri bekoi kalin ose lopën, por thuhet se filan njeri bekoi filanin.

الْمَغْضُوبِ *El-Magdūbi*

Vjen nga أَلْغَضَبُ *el-gadabu* që do të thotë:

ثَوْرَانُ دَمِ الْقُلْبِ إِرَادَةُ الْإِنْتِقَامِ

“Furia e gjakut në zemër që shkaktohet nga mendimi për të ndëshkuar”.

قال عليه السَّلَام: إِتَّقُوا الْغَضَبَ فَإِنَّهُ جَمْرَةٌ تَوْقِدُ فِي قَلْبِ ابْنِ آدَمَ- أَلَمْ تَرَوْا إِلَى إِنْتِفَاحِ أَوْدَاجِهِ وَ حُمْرَةِ عَيْنَيْهِ-

I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha: “Ruhuni nga zemërimi sepse ai është një shkëndijë që ndizet në zemrën e birit të Ademit. A nuk keni parë kur dikush zemërohet, i fryhen damarët dhe i skuqen sytë?”<sup>111</sup>

وَإِذَا وَصَفَ اللَّهُ تَعَالَى بِهِ فَالْمُرَادُ الْإِنْتِقَامُ دُونَ غَيْرِهِ.

“Dhe kur kjo fjalë i atribuohet Allahut të Madhërishëm, nënkupton vetëm ndëshkimin, pa vetitë e tjera”.<sup>112</sup>

Andaj, *gajril-magdubi ‘alejhim* u referohet atyre, që Zoti i Madhërishëm ua cilësoi veprat të këqija dhe vendosi t’i ndëshkojë.

وَلَا الضَّالِّينَ *Ve led-dāl-līn*: as të devijuarit,

Vjen nga *ضَلَّ dal-le*, që do të thotë *devijoi nga rruga e drejtë* dhe kjo folje përdoret si antonim i fjalës *hidajet*. *Dalal* përdoret për çdo veprim që bie ndesh me rrugën e drejtë, veprim i cili bëhet qoftë me vetëdije a pavetëdije, qoftë i vogël a i rëndë.<sup>113</sup>

Një kuptim tjetër i fjalës *ضَلَّ dal-le* është të përqendrohesh në një punë të caktuar. Në Kuranin Famëlartë thuhet:

الَّذِينَ ضَلَّ سَعْيُهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا

“Ata që përqendruan gjithë përpjekjen e tyre vetëm në jetën e kësaj bote”.<sup>114</sup>

Kuptimi i fjalës *dal-le* në ajetin e sures Ed-Duha

Po këtë kuptim e ka kjo fjalë në ajetin:

وَوَجَدَكَ ضَالًّا فَهَدَىٰ

“Dhe ty të gjetëm të zhytur a të përqendruar (në dashurinë Tonë), andaj të udhëzuam (drejt Nesh)”.<sup>115</sup>

Edhe në gjuhën urdu përdoret në kuptimin “i përhumbur”. Për shembull, thuhet se filani këto ditë rri si i përhumbur, që do të thotë se rri i zhytur në një mendim të caktuar. Kjo si shprehje përdoret edhe në gjuhën angleze. Me këto referenca, dua t’ju them se kjo është si shprehje që reflekton një karakter të natyrës njerëzore dhe si e tillë shumë gjuhë e kanë pranuar atë. Në ajetin: “Ty të kemi gjetur të përhumbur dhe të udhëzuar” fjala **دالـ** *dal-le* pikërisht këtë kuptim ka. Pra, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> ishte i zhytur në dashurinë ndaj Zotit dhe gjithnjë rrinte i përhumbur dhe këtë e pëlqeu Zoti i Madhërishtëm. Dashuria e Profetit<sup>savs</sup> tërhoqi dashurinë e Zotit. Me një fjalë, i dashuruari nga përhumbja e vet e arriti dashurinë e Zotit. Por duhet ditur që fjala **دالـ** *dal-le*, përgjithësisht përdoret në kuptimin negativ. Për të pasur kuptim pozitiv, ajo ka nevojë për një kontekst, sikundër në këtë ajet, ku thuhet: **فَهْدَى** “*e udhëzoi ose e përrudhi*”.

## **Komentim**

### **Një synim madhor për muslimanët**

Në ajetin e mëparshëm, Zoti na mësoi lutjen me të cilën t’i kërkojmë rrugën e drejtë. Në këtë ajet shtoi edhe një gjë tjetër: kjo rrugë e drejtë të mos jetë e thjeshtë, por të jetë e atyre që i ka bekuar Zoti dhe që janë të përparuar shpirtërisht.

Sa i madh është ky qëllim, të cilin Islami ia ka dhënë çdo muslimani që në suren e parë të Kuranit! Pra, muslimani nuk duhet të ketë vetëm dëshirë për të bërë mirësi, por të synojë t’i bashkohet xhematit të fituesve.



Ai që është i dashuruar me Allahun, nuk mund të mjaftohet me një shkallë të vogël, sepse dashuria ndaj Zotit nuk e lejon të bëjë përparime në mënyrë të kufizuar. A ka ndonjë gjë tjetër në botë që mund t'ia shuajë etjen, kur ai është në kërkim të Zotit të Madhërishëm?! Pra, ai që kërkon Zotin, kërkon të gjitha përparimet. Ndaj, ai që e njeh Zotin e Madhërishëm, nuk mund të quajë asnjë përparim si të fundit.

Gjëja më e bukur për besimtarin është që kjo nuk mbetet thjesht një dëshirë në zemrën e tij, por Vetë Zoti i tij këtë ia mëson duke thënë: Mos u kënaq me një gradë të vogël! Më kërko bekim, por jo të thjeshtin, madje bekimin që kanë marrë njerëzit e kohërave të mëdha dhe, gjithashtu, jo bekimin që kanë marrë njerëzit e një kohe të vetme, por të të gjitha kohërave.

### **Kuptime të ndryshme të bekimit (*in'am*)**

Në kuptimet leksikore kam shpjeguar se në kuptimin e fjalës *in'am* (bekim) nuk mund të përcaktohet një bekim i vetëm, por çdo gjë e mirë që mund t'ia japësh dikujt për të shprehur gëzimin, quhet *in'am*, që mund të jetë qoftë materiale, qoftë shpirtërore. Edhe Kurani Famëllartë, në ajete të ndryshme, e përdor këtë fjalë në kuptimin e saj të gjerë.

Në suren *Beni Israil* [*Isra*], Zoti i Madhërishëm thotë:

وَإِذَا أَنْعَمْنَا عَلَى الْإِنْسَانِ أَعْرَضَ وَنَسَىٰ بِنِعْمَةِ رَبِّهِ

“Kur i japim ndonjë mirësi (*in'am*) njeriut, ai e kthen shpinën dhe mënjanohet”.<sup>116</sup>

Pra, në vend që të bëhet mirënjohës për bekimin që i ka dhënë Zoti, bëhet i pavëmendshëm ndaj Tij. Ky ajet tregon se fjala *in'am* përfshin edhe gjërat materiale, dijen, profesionin, nderimet tokësore etj., sepse janë pikërisht këto gjëra që janë si mirësi dhe shumë njerëz, pasi i gëzojnë ato, në vend që t'i përkushtohen Zotit të Madhërishëm, e harrojnë Atë.

Kurani Famëlartë quan *in'am* edhe shpëtimin nga vështirësitë dhe gjëmat. Ai thotë:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اذْكُرُوْا نِعْمَتَ اللّٰهِ عَلَيْكُمْ اِذْ هُمْ قَوْمٌ اَنْ يَّبْسُطُوْا اِلَيْكُمْ اَيْدِيَهُمْ  
فَكَفَّ اَيْدِيَهُمْ عَنْكُمْ ۖ وَاتَّقُوا اللّٰهَ ۚ وَعَلَى اللّٰهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُوْنَ ﴿١١٧﴾

“O ju që besuat! Kujtojeni bekimin e Allahut që keni mbi vete, kur një popull kishte vendosur t'i zgjaste duart drejt jush (për t'ju dëmtuar), por Ai i pengoi ato. Kini druajtje ndaj Allahut. Allahut le t'i mbështeten besimtarët”.<sup>117</sup>

Në këtë ajet shpëtimi nga sulmi i armikut është cilësuar si bekim (*ni'met*).

Megjithatë, pavarësisht se çdo mirësi mund të quhet bekim, nuk mund të mohohet se ka të atilla që mund të quhen si bekime (*ni'met* ose *in'am*) shumë të mëdha. Kështu që, Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِۦ يُقَوْمِ اذْكُرُوْا نِعْمَةَ اللّٰهِ عَلَيْكُمْ اِذْ جَعَلَ فِيْكُمْ اَنْبِيَآءَ وَجَعَلَ لَكُمْ مُلُوْكَ  
وَءَاتٰكُمْ مَّا لَمْ يُؤْتِ اَحَدًا مِّنْ اَلْعٰلَمِيْنَ ﴿١١٨﴾

“Dhe (kujtojeni) kur Musai i tha popullit të vet: “O populli im! Kujtojeni bekimin e Allahut që keni mbi vete, kur Ai caktoi profetë mes jush, ju bëri mbretër dhe ju dha atë që nuk i dha askujt nëpër botë”.<sup>118</sup>

Ky ajet numëron gjërat që mund të cilësohen si bekime për njeriun dhe iu tha hebrenjve se Zoti ua kishte dhënë një pjesë të madhe të tyre.

### **Tri llojet e bekimeve dhe të përparimeve për njeriun**

Përparimet e njeriut mund t'i ndajmë në tri lloje:

1. Përparimet personale tokësore.
2. Përparimet personale në besim, pra shpirtërore.
3. Përparimet relative shpirtërore dhe tokësore.

Pra, përveç përparimeve tokësore dhe shpirtërore, ka edhe një lloj tjetër përparimesh që maten si epërsi e një individi a e një populli ndaj tjetrit. Njeriu si natyrë më shumë pëlqen këtë lloj përparimi. Pra, ai nuk do thjesht një përsosmëri, por një përsosmëri që i jep epërsi ndaj bashkëkohësve dhe rivalëve të tij. Në ajetin e mësipërm, Hazret Musai<sup>as</sup> ua numëroi bijve të Izraelit të tria llojet e përparimeve:

1. Ata patën bekime tokësore, aq saqë trashëguan mbretërinë për një kohë të gjatë. Mbretëria përmbledh të gjitha përparimet tokësore, sepse një popull që e gëzon mbretërinë, gëzon çdo mjet të përparimit tokësor, ata në daç të përfitojnë prej këtyre përparimeve në daç jo. Kështu që, kur thuhet se një popull i caktuar ka trashëguar mbretërinë për një kohë të gjatë, do të thotë se atij iu hapën të gjitha rrugët e përparimeve të kësaj bote.

2. Ashtu siç mbretëria është kulmi i përparimeve tokësore, në të njëjtën mënyrë, profetësia (*nubuwwet*) është kulmi i përparimeve shpirtërore. Duke e numëruar këtë bekim, Hazret Musai<sup>as</sup> u tha hebrejve se ata e gëzuan edhe këtë bekim, jo në formë një a dy profetësh, por në formën e një serie të gjatë profetësh.

3. Bekimi i tretë është përparimi relativ. Pra, nuk bëhet fjalë për vetëm bekime tokësore dhe shpirtërore, por bëhet fjalë për këto bekime në krahasim me popujt e tjerë. Hazret Musai<sup>as</sup> u tha bijve të Izraelit:

“dhe ju dha atë që nuk i dha askujt nëpër botë”.

Pra, Hazret Musai<sup>as</sup> u tha: Zoti ju dhuroi edhe bekimin e epërsisë mbi popujt e tjerë. Zoti nuk ju dha veç mbretërinë, por diçka mbi mbretërinë, Zoti nuk ju siguroi vetëm profetësinë (*nubuwwet*), por ju dha profetë, të cilët janë udhëzues për profetët e tjerë. Andaj, ju gëzuakeni të tria llojet e bekimit: edhe bekimin tokësor, edhe bekimin në besim, gjithashtu edhe epërsinë mbi popujt e tjerë në dy bekimet e para.

Kjo (ajeti) është thënie e Hazret Musait<sup>as</sup>, por e citon Kurani Famëlartë. Një mendimtar nuk mund të mbetet pa u mbresuar nga kuptimet e thella që janë futur në formulime kaq kompakte!

## **Synimi i muslimanit**

Fjalët صراط الذين انعمت عليهم “*në rrugën e atyre që i bekove*” duke e pasuar lutjen إهدنا الصراط المستقيم “*na udhëzo në rrugën e drejtë*”, kanë marrë kuptime shumë të gjera. Këto fjalë përcaktojnë se muslimani nuk duhet të synojë t'i kërkojë Zotit vetëm një rrugë të drejtë, por t'i kërkojë edhe metodat, mësimet dhe njohuritë për rrugën e drejtë, që Zoti ua ka

dhënë njerëzve të bekuar më përpara. Duke ngjallur shpresa kaq të mëdha, Zoti i Madhërishëm i bëri mirësi shumë të madhe *umetit* të Muhammedit<sup>savs</sup>.

### **Argumente nga Kurani për vazhdimësinë e profetësisë (*nebuwwet*) brenda *umetit* të Muhammedit<sup>savs</sup>**

Me praninë e një mësimi kaq të qartë që thotë se muslimanët mund të gëzojnë çdo përparim individual e shpirtëror, nuk kemi nevojë të sjellim dëshmi të tjera. Por sot në përgjithësi, muslimanët janë të dëshpëruar, andaj le të hyjmë më në detaje të Kuranit Famëlartë se si e shpjegon ai vetë këtë lutje të kërkimit të udhëzimit. Gjithashtu, a ka ndonjë premtim në Kuran apo jo që kjo lutje do t’u pranohet muslimanëve?

Në suren En-Nisa, Zoti i Madhërishëm thotë:

وَلَوْ أَنَّهُمْ فَعَلُوا مَا يُوعَظُونَ بِهِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ وَأَشَدَّ ثَبَاتًا ۖ وَإِذَا لَا تَأْتِنُهُمْ مِّنْ لَّدُنَّا أَجْرًا عَظِيمًا ۖ وَلَهْدَيْنَهُمْ صِرَاطًا مُّسْتَقِيمًا ۖ وَمَن يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِم مِّنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا ۖ

“(Muslimanët e dobët që u treguan mosbindës), sikur të bënin atë që u është këshilluar, do të ishte mirë për ta dhe kjo do t’i forconte fuqishëm ata. Në këtë rast, Ne me siguri do t’u jepnim prej Vetes shpërblim të madh, dhe do t’i udhëzonim ata në *rrugë të drejtë* (*sirāt mustekīm*). Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të dërguarit (pra, Profetit Muhammed<sup>savs</sup>), do të jetë me *ata që Allahu i ka bekuar* (domethënë), ndër profetët, të vërtetët, dëshmorët dhe të dëlirët. Sa shoqëri e mbarë janë këta!”<sup>119</sup>

Ky ajet rendit bekimet që janë caktuar për muslimanët dhe fjalët janë po të njëjtat që janë edhe në suren El-Fatiha, pra “*sirat mustekim*”, “*rruga e drejtë*” dhe edhe rruga e drejtë e atyre që Allahu i ka bekuar. Vjen edhe sqarimi se cilët do të jenë këta: profetët, të vërtetët, dëshmorët dhe të dëlirët. Nga kjo nxjerrim përfundimin se lutja për të kërkuar bekimet që përmendet në suren El-Fatiha, në aspektin fetar u referohet bekimeve madhore shpirtërore dhe Allahu i Madhërishëm pohon se muslimanët do t’i gëzojnë të gjitha ato.

Disa kundërshtojnë duke thënë se përderisa ajeti i sures En-Nisa thotë: *مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ* “do të jenë me ata që Allahu i ka bekuar”, do të thotë se ata do të jenë me ta, por jo prej tyre.

Kundërshtimi në fjalë e zbulon vetë dobësinë e tij. Parafjala “me” po t’i ishte paravendosur emrit “profetët”, mund të thuhej se nuk do të kishte profet në *umetin* e Muhammedit<sup>savs</sup>, por do të kishin njerëz, që do të qëndronin bashkë me profetët. Por, Kurani Famëlartë këtë parafjalë e vendos përpara fjalëve *أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ* “ata që Allahu i ka bekuar”. Andaj, në këtë rast nëse nxirri përfundimin se muslimanët nuk do ta kenë atë pozitë, dhe do të kenë vetëm shoqërinë e njerëzve të asaj pozite, ajetin në fjalë do t’ju duhet ta kuptoni se gjoja askush nga muslimanët nuk do të jetë i bekuar nga Zoti, dhe se vetëm disa prej muslimanëve do të gëzojnë shoqërinë e njerëzve të bekuar. Por një kuptim të tillë e hedhin poshtë edhe Kurani, edhe hadithet, edhe logjika e shëndoshë.

Nëse thonë se parafjala “me” i referohet sqarimit që vjen pas frazës “ata që Allahu i ka bekuar”, edhe në këtë rast, ky argument vetvetiu bie poshtë. Sepse, në sqarim kemi katër grada: profetët, të vërtetët,

dëshmorët dhe të dëlirët. Tani, nëse parafjala “me” dhënka vetëm kuptimin e shoqërimit dhe të përfshirjes, del që muslimanët nuk do të bëhen profetë, por vetëm se do të shoqërojnë profetët (e mëparshëm); muslimanët nuk do të jenë të vërtetë, por vetëm se do të shoqërojnë të vërtetët; muslimanët nuk do të jenë dëshmorë, por vetëm se do të shoqërojnë dëshmorët; muslimanët nuk do të jenë të dëlirë, por vetëm se do të shoqërojnë të dëlirët. A mund të imagjinohet kuptim më negativ sesa ky?! A mund të përfytyrohet fyerje më e madhe sesa kjo që në *umetin* e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> profetët nuk do të vijnë, jo e jo, por nuk do të ketë as të vërtetë, as dëshmorë dhe as të dëlirë?!

Disa e kundërshtojnë duke thënë se *nubuwweti*, pra, profetësia është dhuratë, ndaj, cili është kuptimi i lutjes për të?

Përgjigjja është që robi nuk lutet për profetësinë, por si pjesëtar i *umetit* të Muhammedit<sup>savs</sup> lutet për të gëzuar bekimet sa më të larta. Ky është kuptimi i ajetit. Pastaj është vullneti i Zotit që një bekim të caktuar Ai t’ia japë kujt të dojë. Zoti thotë:

اللَّهُ أَعْلَمُ حَيْثُ يَجْعَلُ رِسَالَتَهُ

“Allahu e di më së miri se ku të vendosë mesazhin e Tij”.<sup>120</sup>

Profetësia pa dyshim është dhuratë, por ajo pse iu bë Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe jo Ebu Xhehlit? Pra, edhe për të pranuar profetësinë, njeriu duhet të ketë bërë sakrifica.

Së dyti, nuk themi se Zoti po i mëson robit të lutet: O Zot! Më bëj profet! Lutje të tilla janë të papëlqyeshme jo vetëm në çështjet shpirtërore, madje nganjëherë edhe në çështjet materiale. Një

zdrukthëtar të lutet: O Zot, më bëj drejtor të shkollës! Ose një që është i gjymtuar nga këmba, të lutet: O Zot, më bëj komandant të ushtrisë! Pra, lutje të tilla janë të pakuptimta. Pranimi i lutjeve varet nga rrethanat dhe urtësitë hyjnore. Andaj, nuk është mirë për besimtarin që ai të lutet për pozita të caktuara shpirtërore. Për profetësinë jo e jo, nëse dikush lutet, o Zot, më bëj *siddik* ose *kutb* ose dëshmor, edhe lutje të tilla nuk janë të pëlqyeshme.

### Një arsye pse lutja është në shumës

Pikërisht për këtë arsye, Zoti na mësoi lutjen *ihdina* (na udhëzo) në shumës dhe jo *ihdini* (më udhëzo) në njëjës, sepse forma e shumësit tregon zhvillimin e mbarë *umetit*. Zoti i Madhërishëm e zgjedh Vetë personin që dëshiron t'i dhurojë një pozitë të caktuar pranë Vetes.

Gjithashtu, nuk duhet harruar se kjo lutje është për të kërkuar bekime. E kur edhe profetësia (*nubuuveti*) është dhuratë, pra një bekim, atëherë ku qëndron problemi nëse këtë gjë ia kërkojmë Zotit për mbarë popullin?! Shkurt, lutja në fjalë na mëson të kërkojmë çdolloj bekimi si dhe udhëzimin në të gjitha punët. Kurani Famëlartë pohon se të gjitha këto bekime do t'u jepen muslimanëve dhe ndër to, ai vetë e përfshin edhe profetësinë, prandaj, askush nuk ka të drejtë ta përjashtojë këtë bekim nga kjo lutje.

### Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është *Vula e profetëve*, si mund të vijë profet pas tij?

Dikush mund të kundërshtojë duke thënë: Profeti Muhammed<sup>savs</sup> është vula e profetëve, atëherë si mund të vijë profet pas tij?



Përgjigjen e kësaj pyetjeje e jep po ky ajet i sures En-Nisa. Sepse ajeti thotë:

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ

Do t'i ketë këto bekime vetëm ai që i bindet Allahut dhe Profetit Muhammed<sup>SAWS</sup>. Dihet që ai që është shërbëtor i Profetit Muhammed<sup>SAWS</sup>, nuk do të ketë ndonjë mision tjetër përtej misionit të Profetit<sup>SAWS</sup>. Andaj, ai nuk mund të sjellë ndonjë shariat të ri. Kështu që, profeti që vjen duke qenë nën urdhrat e Profetit Muhammed<sup>SAWS</sup>, nuk është kundër kuptimit të Vulës së Profetëve (*Hatemun-nebijjin*), madje e përforcon kuptimin e saj.

Një zotëri që njihet si një ndër komentuesit e sotëm të Kuranit dhe që e reklamon shpesh përkthimin e tij të Kuranit të Shenjtë, në *tefsirin* e tij shkruan se kjo lutje po të ishte për të fituar profetësinë, Zoti duhet t'ia mësonte Profetit Muhammed<sup>SAWS</sup> përpara se ta bënte atë profet, por ngaqë ajo përmendet në Kuran, do të thotë se Zoti ia ka mësuar pasi e zgjodhi si profet. Dhe në këtë mënyrë, ai nxjerr përfundimin se lutja në fjalë nuk ka lidhje me profetësinë.

Ky kundërshtim është kaq i pabazë saqë dëshmon mungesë thellimi të autorit në kuptimet e Kuranit. Lutja është mësuar në ajetin: "Na udhëzo në rrugën e drejtë", është një lutje e natyrshme. Të lutesh me këto fjalë është bekim sepse janë fjalët e bekuara të Kuranit dhe si të tilla ato janë të pastra nga gabimet. Por njëherësh, të gjithë kërkimtarët e së vërtetës, cilëso do feje t'i përkasin a të mos i përkasin, kur ndiejnë në

zemër dëshirën për të gjetur të vërtetën, bëjnë lutje të ngjashme pikërisht me këtë lutje dhe thonë:

*O Allah! Na trego rrugën e drejtë! Na trego rrugën e të dashurve të Tu!*

A mund të pranojë ndokush që ka pak mend që Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, përpara se të bëhej profet, të mos i kishte lindur dëshira që Zoti t'ia tregonte rrugën e drejtë dhe t'ia mundësonte rrugën e të dashurve të Tij? Shkrepja e një mendimi të tillë të mjafton ta humbasësh besimin. Ishte pikërisht dëshira e flaktë e zemrës së Profetit Muhammed<sup>savs</sup> ajo që solli bekimin e Zotit të Madhërishëm. Pikërisht kjo dëshirë reflektohet edhe në lutjen:

*"Na udhëzo në rrugën e drejtë!"*

Ajo që ka bërë Kurani Famëlartë është që, së pari, zgjodhi fjalët më të përshtatshme, të përsosura dhe të pastra nga gabimet, dhe së dyti, u hapi zemrën shumë njerëzve që vetë nuk merrnin dot nismën, së treti, krijoi shpresë te të gjithë se nëse bëjnë një lutje të tillë, ajo pranohet. Madje, urdhëroi besimtarët ta bëjnë këtë lutje. Mendimi që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> nuk kishte pasur një ndjenjë të tillë të ngjashme me këtë lutje, është një fyerje ndaj tij, madje edhe ndaj Zotit të Madhërishëm, sepse del që Ai caktoi me zor si profet një njeri që nuk kishte pasur fare dëshirë për të pasur rrugën e drejtë. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga këto mendime të gabuara!

Nëse kjo akuzë ka ndonjë peshë logjike, dikush mund të shtrojë edhe pyetjet se Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, përpara zbritjes së Kuranit, a ishte i dëlirë apo jo, a ishte i dashuruar me Zotin apo jo, a e kishte afërsinë

me Zotin apo jo, etj. Nëse përgjigjet janë pohuese, dikush mund të thotë: Mirë atëherë, çfarë nevojë kemi për namazin që përmendet në Kuran; ç'na duhen agjërimet që na mëson Kurani; ç'na hyn në punë xhihadi dhe porositë e tjera që na jep Kurani, për sa kohë që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> e fitoi druajtjen (*takvanë*) dhe dashurinë e Zotit, pa i zbatuar këto porosi?! Pra, ata do të thonë: edhe ne kështu do t'i arrijmë.

E lëmë punën e fesë, edhe në çështjet e kësaj bote, bota do ta quajë naiv atë që thotë se nuk dimë nëse në fillim ka ardhur pula apo veza, ose pema apo fara dhe, edhe tani e në të ardhmen, nuk kemi nevojë të punojmë, çdo gjë do të lindë vetvetiu sipas ligjeve të natyrës. Pra, ligji i Zotit në kohën kur mungon fara është tjetër dhe në kohën kur është krijuar fara është tjetër. Përpara se t'i zbritet Kurani Famëlartë Profetit Muhammed<sup>savs</sup>, bota e kishte humbur mësimin e pastër të besimit. Profeti<sup>savs</sup> pati ndjenja të pastra dashurie ndaj Zotit dhe Zoti i Madhërishëm ia pranoi dhe ia bekoi, pa qenë nevoja që ato të konkretizoheshin në fjali të caktuara. Por kur u zbrit Kurani Famëlartë dhe u vendosën parimet për çdo çështje, nuk mund të fitojmë më ato bekime, pa i ndjekur këto parime. Përmes Profetit Muhammed<sup>savs</sup> u vu themeli i besimit dhe i sheriatit, andaj, nga ajo kohë e tutje, ai që dëshiron të qëndrojë jashtë këtyre parimeve dhe këtij sheriatit, nuk do të ketë sukses.

## **Pozita e profetit**

Kësaj pyetjeje mund t'i qasemi edhe nga një këndvështrim tjetër. Duhet ditur nëse të qenët profet është thjesht ndonjë pozitë, apo është

e kushtëzuar me *takvanë* (druajtjen) dhe afërsinë me Zotin e Madhërishëm? Nëse këto gjëra janë të nevojshme për të qenë profet, a mundet vallë që një joprofet në *takvanë* dhe në afërsinë e tij me Zotin, të jetë më i lartë sesa një profet? Ky komentues dhe bashkëmendimtarët e tij nëse i përgjigjen me pohim kësaj pyetjeje, atëherë debati është thjesht i emërtimit. E nëse i përgjigjen me mohim, pra, një joprofet në këto cilësi nuk mund të jetë i lartë me një profet, atëherë ai që pohon se *umeti* i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> nuk mund të ketë as profet në formën e shërbëtorit të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> dhe të Islamit, me fjalë të tjera, pohon se asnjë njeri në këtë *umet* nuk mund të arrijë gradën që njerëzit e tjerë në *umetet* e tjera e kanë arritur. Sigurisht, ai që beson një gjë të tillë, tenton ta privojë *umetin* e Profetit Muhammed<sup>savs</sup> nga bekimi.

### **Pse nuk u bë asnjë profet gjatë 13 shekujve të Islamit?**

I njëjti komentues ngriti një pyetje tjetër si akuzë duke thënë se cila është arsyeja që Zoti nuk ka dëgjuar lutjen e asnjërit prej muslimanëve gjatë 13 shekujve të kaluar?

Përgjigjja është që pranimi i lutjes varet nga shkalla dhe lloji i lutjes. Komentuesi në fjalë e pranon që muslimanët mund të arrijnë gradën e *siddikut*. Atëherë e njëjta pyetje mund të ngrihet mbi besimet e tij se, gjatë 13 shekujve të kaluar, sa veta e kanë arritur këtë pozitë? Nëse e ka arritur vetëm Hazret Ebu Bekri<sup>ra</sup>, do të lindë pyetja tjetër se përse nuk ia ka pranuar Zoti lutjen asnjërit prej muslimanëve, përveç Ebu Bekrit<sup>ra</sup>, përgjatë 13 shekujve? E nëse Zoti ia ka dhënë edhe dikujt tjetër pozitën e *siddikut*, a ishte ai më i lartë në pozitë sesa Omeri<sup>ra</sup>, sesa

Osmani<sup>ra</sup> dhe sesa Aliu<sup>ra</sup> apo më i ulët? Nëse ishte më i ulët, pse vallë ndokush me një nivel më të ulët e ka arritur pozitën e *siddikut*, kurse të tjerët që ishin më të fortë në besim, u bënë dëshmorë (*shehid*) dhe nuk u bënë dot të vërtetë (*siddikë*)?

Shkurt, akuza që ata ngrenë kundër vazhdimësisë së profetësisë, ngrihet edhe për të qenët *siddik*, për sa kohë që e pranojnë se dera e *siddikut* është e hapur në *umetin* e Muhammedit<sup>savs</sup>. Andaj, një akuzë e tillë vjen nga mungesa e thellimit në kuptimet e Kuranit dhe se ajo nuk ka bazë logjike.

## Dy emrat e sures El-Fatiha dhe lidhja e tyre e ndërsjellë

Në lidhje me këtë ajet është e udhës të përmend edhe një pikë tjetër. Dy ndër emrat e sures El-Fatiha që ka përmendur Profeti Muhammed<sup>savs</sup> janë *Ummul-Kuran* (Nëna e Kuranit) dhe *Ummul-Kitab* (Nëna e Librit).<sup>121</sup>

Sipas meje, këta emra vijnë nga vetë Kurani Famëlartë dhe burimi i tyre është pikërisht ky ajet. Ky dhe ajeti paraardhës thonë se destinacioni përfundimtar i adhurimit është që njeriu t'i kërkojë Zotit rrugën e drejtë që ndoqën njerëzit që janë bekuar prej Tij. Kjo do të thotë se lutja në fjalë mund të përmbushet. Kështu që, në një situatë kur ka rënie shpirtërore, kur disa njerëz të një populli dhe, po ashtu, edhe njeriu i përsosur dhe i dëlirë i kohës, të cilin Zoti do ta zgjedhë si reformator të kohës, i drejtohen Zotit të Madhërishëm me sinqeritet të plotë, britmat e tyre nxisin mëshirën e Zotit të Madhërishëm dhe bekimi i Tij do t'u zbresë në formë komunikimi dhe udhëzimi prej Tij.

Kështu ndodhi në çdo kohë dhe kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen.

Gjatë kohës së Nuhut<sup>as</sup>, kur lutjet e të shtypurve iu bashkuan lutjeve që buronin nga zemra e pastër e Hazret Nuhut<sup>as</sup>, ato bashkërisht sollën fjalën e Zotit që iu zbrit Hazret Nuhut<sup>as</sup>. Gjatë kohës së Hazret Ibrahimit<sup>as</sup> po ashtu, klithmat e të sinqertëve kur u bashkuan me klithmat që buronin nga zemra e pastër e Hazret Ibrahimit<sup>as</sup>, shkaktuan zbritjen e Fletëve (*Suhuf*) të Ibrahimit<sup>as</sup>. E njëjta gjë ndodhi gjatë kohës së Hazret Musait<sup>as</sup> dhe gjatë kohës së Hazret Isait<sup>as</sup> dhe po ashtu edhe gjatë kohës së Pejgamberit Muhammed<sup>savs</sup>.

Sipas haditheve të sakta (*sihab*), përpara zbritjes së Kuranit, i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> shkonte në shpellën Hira që të shkëputej nga njerëzit e tjerë dhe bënte adhurim dhe lutje. Kjo ishte gjendja e zemrës më të pastër, e cila dinte t'i lexonte ndjenjat e veta. Por përveç tij, shumë klithma të pavetëdijshme gjithashtu po ngriheshin drejt qiellit. E gjithë kjo shkaktoi bekimin e Zotit të Madhërishëm dhe si rrjedhojë u zbrit Kurani Famëlartë.

Andaj, lutja "*na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekojnë*" na jep pikërisht pamjen e gjendjes së botës para zbritjes së fjalës së Zotit. Ai veçanërisht na përshkruan gjendjen e shpirtrave të mira të një kohe, kur zemrat dënesin dhe mendjet dallgëzohen aq fuqimisht, sa që Zoti i Madhërishëm e zbret fjalën e Tij.

E tillë është kjo lutje që përmendet në suren El-Fatiha dhe që tregon shkakun e zbritjes së fjalës së Zotit. Për këtë arsye, Hazret Profeti Muhammed<sup>savs</sup> e quajti suren El-Fatiha si *Ummul-Kuran* (Nëna e

Kuranit) dhe *Ummul-Kitab* (Nëna e Librit), pasi ajo përmend temën që u bë shkak i zbritjes së Kuranit. Dihet, shkaku i krijimit të diçkaje konsiderohet si nëna e saj, andaj edhe surja El-Fatiha u quajt Nëna e Kuranit.

**“El-Fatiha është Kurani i Madhërishëm”, çfarë do të thotë kjo?**

Profeti Muhammed<sup>savs</sup> thotë se El-Fatiha është قرآن عظیم “Kurani i Madhërishëm”. Kjo nuk do të thotë se pjesa tjetër e Kuranit është e vogël, sepse realisht nuk është kështu. Andaj, duhet kërkuar arsye tjetër e këtij emërtimi. Sipas meje, arsyeja gjendet tek emrat “Nëna e Kuranit” dhe “Nëna e Librit”. Kur Pejgamberi<sup>savs</sup> e emërtoi El-Fatihanë me këta dy emra, ndoshta mendoi se njerëzit do të mendonin që kjo sure është e ndarë nga Kurani, andaj, ai e emërtoi edhe si “Kurani i Madhërishëm”, në mënyrë që muslimanët ta kenë të qartë se El-Fatiha nuk është jashtë Kuranit, por është pjesë e tij. Dihet që edhe pjesa e një gjëje të caktuar, e merr emrin e asaj që i përket. Ne shpesh kur duam të dëgjojmë ndonjë pjesë të Kuranit Famëlartë, i themi Hafiz *sahibit*: Na recitoni Kuranin Famëlartë, ose themi: Filani po reciton Kuranin, ose rreth një teme të një ajeti të caktuar, themi: Kurani thotë kështu. Në të gjitha këto raste, ne nënkuptojmë një pjesë të caktuar të Kuranit dhe jo gjithë Kuranin, pavarësisht se përmendin fjalën Kuran.

**Një kuptim i bukur i emrave *Nëna e Kuranit* dhe *Kurani i Madhërishëm***

Emërtimet Nëna e Kuranit (*Ummul-Kuran*) dhe Kurani i Madhërishëm (*El-Kuranul-adhim*) na sjellin edhe një kuptim tjetër

shumë të bukur. Në njëren anë, Profeti<sup>savs</sup> e quajti shkakun e krijimit dhe, në anën tjetër, e quajti edhe atë që erdhi në dritë. Kjo hedh dritë mbi një proces shpirtëror shumë të fuqishëm. Në botën shpirtërore, gjendja e parë shkakton gjendjen e dytë që vijon. Në këtë rast, gjendja e parë simbolizohet si nënë dhe e dyta si fëmijë. Në këtë kuptim El-Fatiha u quajt edhe "Nëna e Kuranit" dhe ngaqë ajo vetë është pjesë e Kuranit, u quajt edhe "Kurani i Madhërishëm".

Metafora të tilla përdoren edhe për njerëzit, për t'iu referuar ndryshimeve të tyre shpirtërore. Kështu, në suren Et-Tahrim, Zoti i Madhërishëm thotë se besimtarët u përngjajnë gruas së Faraonit si dhe Merjemes, të bijës së Imranit. Dhe për ata besimtarë që i përngjajnë Merjemes, të bijës së Imranit, në fund të ajetit, Zoti thotë:

فَنفَخْنَا فِيهِ مِنْ رُوحِنَا وَصَدَقْتَ بِكَلِمَاتِ رَبِّهَا وَكُنَّ مِنَ الْقَانِطِينَ ﴿١٢٢﴾

"Ne frymë shpirtin (fjalën) Tonë në të dhe ajo besoi fjalët e Zotit të saj dhe librat e Tij dhe (përfundimisht) u bë ndër të bindurit".<sup>122</sup>

Pra, ata që i përngjajnë natyrës së Merjemes, duke përparuar kur marrin fjalën e Zotit, arrijnë të bëhen Mesihë.

Kështu që, emërtimet e sures El-Fatiha "Nëna e Kuranit", "Nëna e Librit", dhe "Kurani i Madhërishëm" hedh dritë mbi disa fenomene islame dhe ky është udhëzim për ata që nuk perceptojnë dot çështjen se si një person i *umetit* të Muhammedit<sup>savs</sup> u quajt Merjeme dhe gjithashtu edhe Isa. Derisa Pejgamberi i Allahut<sup>savs</sup> e quan suren El-Fatiha edhe Nëna e Kuranit, edhe Kurani i Madhërishëm, një musliman i vërtetë nuk duhet të ketë ndonjë vështirësi për të kuptuar



se Zoti i Madhërishëm quan një njeri edhe Merjeme, edhe Isa. Gjendja e tij kur ai këlthiste përpara Zotit që bota ka nevojë për një Mesih, ishte ajo e Merjemes, dhe për këtë arsye, ai u quajt Merjeme. Njësoj siç surja El-Fatiha u quajt Nëna e Kuranit dhe Nëna e Librit për shkak të lutjes "Na udhëzo në rrugën e drejtë!", lutje e cila ishte një klithmë për të kërkuar udhëzim hyjnor. Por kur u dëgjua lutja e njeriut të përsosur të kohës dhe Zoti i Madhërishëm të njëjtin njeri e zgjodhi duke i fryrë shpirtin mesihian për botën, ai u quajt Isa. Njësoj siç El-Fatiha u quajt Kurani i Madhërishëm, kur lutja "Na udhëzo në rrugën e drejtë" u dëgjua te Zoti dhe tërhoqi Kuranin e Shenjtë, për t'u bërë më pas pjesë e tij edhe vetë.

### **Një synim madhor për udhëzimin dhe përparimin e muslimanëve**

Një tjetër pikë që vlen të përmendet në kuadër të komentimit të këtij ajeti, të cilën sahabët e Profetit<sup>sav</sup> e kishin parasysh dhe si të tillë i dhanë botës shembullin e tyre të përkryer, të pangjashëm në ndonjë popull tjetër të botës. Edhe muslimanët e mëvonshëm po t'i përmbaheshin mësimi që jep ky ajet, do të mbeteshin model në gjithë historinë e botës, por, me keqardhje, ata e harruan dhe rrjedhimisht, ranë nga niveli, ku Allahu i Madhërishëm donte të qëndronin. Edhe sot nëse muslimanët do ta zbatojnë atë, të gjitha problemet do t'u zgjidhen dhe ata përsëri mund të bëhen një popull me vlera të larta e të pashembullta.

Cili është ai mësim? Çdo popull ka një synim, për të cilin ai përpiqet. Edhe krijimi i botës ka një qëllim të caktuar. Populli që do ta plotësojë

këtë qëllim, ndryshe mund të quhet popull për të cilin është krijuar bota. Hazret Ademi<sup>as</sup> erdhi dhe i mësoi botës disa mirësi, gjë që për njerëzit e kohës së tij, ishin mësimet më të larta të kohës. Ata që i zbatuan ato mësimet, sollën në vete një ndryshim madhor si në aspektin shpirtëror, ashtu edhe në atë moral, dhe si rrjedhojë, atyre iu ngritën edhe aftësitë mendore në krahasim me njerëzit e mëparshëm. Megjithatë, njeriu nuk kishte arritur ende kulmin e qëllimit për të cilin ishte krijuar. Andaj, rrugëtimi duhej të vijonte. Gjersa erdhi Hazret Nuhu<sup>as</sup>, i cili e çoi njeriun në një gradë akoma më të lartë zhvillimi, prapëseprapë, nuk ishte arritur qëllimi i krijimit të njeriut ende. Kështu që, pas tij erdhi një profet tjetër, pas të cilit një tjetër dhe ky rrugëtim kështu vijoi, derisa erdhi Hazret Profeti Muhammed<sup>savs</sup>. Ai i tregoi njeriut të gjitha sekretet shpirtërore që ishin të fshehura për të, duke i dhënë të gjitha mësimet e nevojshme për zhvillimin e tij shpirtëror, mendor dhe moral. Me ardhjen e tij, në kuptimin shkencor të fjalës, feja u përsos. Andaj, përmes tij Zoti i Madhërishëm njoftoi botën:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي

“Sot, kam përsosur fenë tuaj për ju dhe jua kam plotësuar bekimin Tim”.<sup>123</sup>

Por, për sa kohë ky mësim nuk vihej në zbatim, nuk mund të plotësohej as qëllimi i zbritjes së tij dhe as qëllimi i ardhjes së Profetit Muhammed<sup>savs</sup>. Andaj, Zoti i Madhërishëm që në suren El-Fatiha u mësoi muslimanëve lutjen:

أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

“Na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekove!”

Në këtë mënyrë, Zoti u dha mesazh muslimanëve: Ju duhet ta arrini qëllimin përfundimtar të krijimit të njeriut që është ajo gradë e lavdëruar (*mekam mahmud*),<sup>1</sup> për të cilën qenia njerëzore nisi rrugëtimin e saj shpirtëror dhe profetë të ndryshëm erdhën dhe e çuan njeriun në stacione të ndryshme të tij dhe të cilën përfundimisht Profeti Muhammed<sup>savs</sup> do ta përsoste!

Kështu që, lutja “na jep bekimet e grupit të bekuar” na mëson të lutemi: O Zot! Na mundëso të bëjmë edhe mirësitë e *umetit* të Ademit<sup>as</sup>; na ndriço mendjen siç ua ke ndriçuar mendjen popullit të Nuhut<sup>as</sup>; na çoj edhe në gradën e *umetit* të Ibrahimit<sup>as</sup>; na dhuro mrekullitë që i ke dhënë edhe popullit të Musait<sup>as</sup>; na jep ndikimin shpirtëror që pati Mesihu<sup>as</sup> dhe, duke na ngritur shkallë-shkallë, na vendos në gradën e lavdëruar (*mekam mahmud*), në mënyrë që Profeti Muhammed<sup>savs</sup> të gëzojë sukses në ardhjen e tij dhe ai të shquhet në gradën *mekam mahmud*.

Me fjalë të tjera, lutja “na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekove” i referohet destinacionit përfundimtar të përsosmërisë njerëzore, drejt së cilës vijon rrugëtimi i njeriut. Me anë të kësaj lutjeje, anëtarët e *umetit* të Muhammedit<sup>savs</sup>, shprehen: O Zot! Ti e ke përsosur fenë përmes të Dërguarit Tënd Muhammed<sup>savs</sup>. Tani, mbetet

---

<sup>1</sup> *Mekam mahmud* si gradë përmendet në Kuranin Famëlartë, në ajetin 80 të sures 17. (Përkthyesi)

që edhe ne t'i përshtatim veprat tona në përputhje me këtë fe dhe të arrijmë të shfaqim të gjitha fuqitë dhe aftësitë, që janë kultivuar nga profetë të ndryshëm dhe që përbëjnë edhe qëllimin e përsosur dhe përfundimtar të krijimit të njeriut; andaj, për këtë po qëndrojmë para Teje; Ti na ndihmo për ta bërë gjithë rrugëtimin, të cilin popujt e mëparshëm, nën udhëzimin e profetëve të tyre, e bënë pjesë-pjesë, në mënyrë që *umeti* i Profetit Muhammed<sup>savs</sup> të arrijë ta plotësojë qëllimin e krijimit të njeriut.

Sahabët e morën parasysh këtë qëllim dhe rrëfyen shembullin e tyre duke rrezatuar bashkërisht virtytet e të gjithë popujve të kaluar. Nëse sot Xhemati ynë do t'i përmbahet këtij qëllimi edhe një herë, do të afrohet koha kur Profeti Muhammed<sup>savs</sup> do të shkëlqejë në *gradën e lavdëruar* dhe bota do të shpëtojë nga hallet e saj dëshpëruese.

### **Kush janë *magdūb* ata që tërhoqën zemërim dhe *dāl-līn* ata që devijuan?**

Çdo njeri a popull që shkaktoi pakënaqësinë dhe zemërimin e Zotit, cilësohet si *المَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ magdūbi 'alejbim* (që tërhoqën zemërimin). Gjithashtu, të gjithë ata që u përhumben në dashurinë e dikujt a diçkaje tjetër përveç Zotit, duke e harruar Atë, janë *ضَالِّينَ dāl-līn* (të devijuar). Por Profeti Muhammed<sup>savs</sup> dha një kuptim edhe më specifik të këtyre fjalëve. Në Musnedin e tij, Imam Ahmed Ibni Hanbeli sjell një rrëfim të gjatë, duke iu referuar Adij Ibni Hatimit, në fund të tij thuhet:

قَالَ [يعنى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ] أَنَّ الْمَغْضُوبَ عَلَيْهِمُ الْيَهُودُ وَأَنَّ الضَّالِّينَ النَّصَارَى-

I Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> tha se “ata që tërhoqën zemërimin (*magdūbi ‘alejhim*) janë hebrenjtë dhe të devijuarit (*dāl-līn*) janë të krishterët”.<sup>124</sup>

Po ashtu, edhe Tirmidhiu e jep të njëjtin rrëfim, të cilin e cilësoi si *hasen garib*.<sup>125</sup> Ibni Merdevijeh sjell rrëfimin e Ebu Dher Gifariut<sup>ra</sup> që thotë:

سَأَلْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عَنِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ قَالَ الْيَهُودُ وَقُلْتُ الضَّالِّينَ قَالَ النَّصَارَى-

E pyeta të Dërguarin e Allahut<sup>savs</sup> rreth atyre që tërhoqën zemërimin (*magdūbi ‘alejhim*). “Hebrenjtë”, m’u përgjigj ai. Pastaj e pyeta rreth të devijuarve (*dāl-līn*). “Të krishterët”, m’u përgjigj ai.<sup>126</sup>

Po këtë kuptim e vërtetojnë shumë nga sahabët e Profetit<sup>savs</sup>. Për shembull, Ibni Abasi dhe Abdullah Ibni Mesud. Kurse Ibni Ebi Hatimi shkon gjer aty, saqë thotë:

وَلَا أَعْلَمُ بَيْنَ الْمُفْسِرِينَ فِي هَذَا إِخْتِلَافًا-

“Të gjithë komentuesit janë të një mendimi dhe unë nuk di për ndonjë kundërshti të tyre në këtë çështje”.<sup>127</sup>

Provat nga Kurani Famëlartë

Këtë mund ta vërtetojmë edhe nëpërmjet ajeteve të Kuranit, sepse në Kuran shpesh flitet për *zemërimin* ndaj hebrenjve. Për shembull, që në suren El-Bekare, thuhet:

فَبَاءُوا بِغَضَبٍ عَلَى غَضَبٍ

“ata tërhoqën zemërim mbi zemërimin”.<sup>128</sup>

Përballë kësaj, për të krishterët, Kurani përmend fjalën *devijuan*. Për shembull, thotë:

الَّذِينَ ضَلَّ سَعْيُهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا

“Ata që *humbën* gjithë mundin e tyre që në këtë botë”.<sup>129</sup>

Po ashtu, në suren El-Maide, pasi përmend të krishterët dhe doktrinën e tyre të gabuar të bërjes së Mesihut dhe të nënës së tij si zota, Allahu i Madhërishëm thotë:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ غَيْرَ الْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ ضَلُّوا مِنْ قَبْلُ وَأَصْلُوا كَثِيرًا مِنْ سَوَاءِ السَّبِيلِ

“O ithtarët e librit! (dmth. të krishterët, sepse për ta flitet në kontekst) Mos e teproni në fenë tuaj në mënyrë të padrejtë dhe mos ndiqni dëshirat e një populli, që ka devijuar më parë dhe devijoi shumë të tjerë! Ata kanë humbur nga rruga e drejtë”.<sup>130</sup>

Ndër të krishterët disa ishin edhe adhurues të Zotit të Vetëm, kurse një pjesë e madhe e tyre bënë *shirk*, duke e marrë Mesihun për Zot. Këta të fundit propagandonin besimin e tyre edhe te të parët dhe një pjesë të madhe e kishin konvertuar në doktrinën e tyre të devijuar dhe, në këtë mënyrë, ata humbën nga rruga e drejtë. Ajeti i mësipërm u drejtohet të krishterëve të thjeshtë që të mos e ndiqnin rrugën e grupit të të devijuarve.

Kështu që, edhe sipas Kuranit Famëlartë, edhe sipas thënieve të Profetit Muhammed<sup>sav</sup> provohet se ata që *morën zemërimin* në veçanti janë hebrenjtë, kurse të devijuarit në veçanti janë të krishterët.

Kjo pjesë e ajetit lidhet me الذين “*të cilët*” a “*që*” ose me përemrin هم *ata* të pjesës “*ata që i bekojnë*” dhe kuptimi i ajetit është:

*O Allah! Na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekojnë, që (më pas) nuk morën zemërimin Tënd dhe që as nuk Të braktisën në dashurinë e dikujt a diçkaje tjetër.*

Kjo e nxit fuqishëm besimtarin që të shqetësohet dhe të mos e ndalë rrugëtimin e tij, derisa të mos ketë rrezik për të devijuar nga rruga e drejtë. Pra, besimtari gjithë jetën duhet të orvatet që hapi i tij t’u bjerë vetëm rrugëve të *takvasë*, sepse me një shkujdesje të vogël, shpirti i tij mund të degradohet dhe të shembet kulm e themel.

### **Një profeci madhështore në këtë ajet**

Ky ajet bëri një profeci shumë të madhe, që mund t’i shtojë besimin çdo të mençuri. Në kohën kur u zbrit kjo sure, Profeti Muhammed<sup>savs</sup> akoma nuk ishte përballur me hebrenjtë dhe të krishterët, por vetëm me idhujtarët e Mekës. Numri i hebrenjve dhe i të krishterëve në Mekë ishte aq sa kripa në miell, dhe nuk kishin asnjë pozitë drejtuese në qeverisjen e saj. Shtrohet pyetja: cila mund të ketë qenë arsyeja se kjo sure nuk u mësoi muslimanëve të luteshin: “O Allah! Na mbro që të mos bëhemi idhujtarë sërish”, por mësoi “O Allah! Na mbro që të mos ndjekim rrugën e hebrenjve dhe të krishterëve”? Me këto fjalë, ky ajet bëri profecinë se idhujtaria do të asgjësohej tërësisht nga Meka, andaj, nuk kishte nevoja që muslimanët të luteshin që të mos bëheshin si idhujtarët e Mekës. Kurse, fetë e hebrenjve dhe të krishterëve do të mbeteshin, andaj muslimanëve u duhej të luteshin që të mos u përngjanin atyre.

## **Çfarë kuptimi ka që muslimanët të luten që të mos u përngjajnë hebrenjve?**

Ky ajet ka edhe një pikë tjetër që na tërheq vëmendjen. Të krishterët i pranojnë muslimanët në fenë e tyre. Andaj, ndihet nevoja e kësaj lutjeje, në mënyrë që Zoti i Madhërishëm t'i shpëtojë muslimanët nga gjëma e të krishterëve, pra, nga shndërrimi i tyre në të krishterë. Por, hebrenjtë në përgjithësi nuk pranojnë konvertime nga jashtë në fenë e tyre. Atëherë cila mund të jetë arsyeja që Zoti u mësoi muslimanëve të luteshin që ata të mos bëheshin sikur hebrenjtë?

Dihet që Fjala e Zotit të Madhërishëm nuk na mëson një lutje të pakuptimtë e të panevojshme. Dhe as i Dërguari i Allahut<sup>savs</sup> nuk do të na jepte porosi ta bënim një lutje të tillë rreth dyzet herë në ditë. Prandaj, muslimanët duhet të vrasin mendjen se sprova çifute mos do t'u binte në një formë tjetër?! Mos vallë ata do t'u përngjanin hebrenjve jo duke u asimiluar me ta, por duke refuzuar Mesihun që do t'u vinte, njësoj si ata që refuzuan Mesihun e tyre?! Po, kjo do të ishte gjendja e tyre, kur edhe sprova e krishterë do ta sulmonte fuqishëm Islamin. Pra, nga njëra anë, ata do t'u përngjanin hebrenjve duke e refuzuar të ngjashmin e Mesihut dhe si rrjedhojë, do të privoheshin nga ndihma e Zotit të Madhërishëm dhe, nga ana tjetër, krishterimi do t'i sulmonte keqas, duke ua marrë mijëra e mijëra shpirtra të tyre. Ky ajet, vallë, a nuk bën një profeci të madhe?! Vallë, a nuk do të përfitonin muslimanët nga kjo profeci, duke shpëtuar veten nga dy zjarre?!



## Renditje shumë e bukur e ajeteve të sures El-Fatiha

Po t'i hedhim një sy të vëmendshëm kësaj sureje, na del në pah edhe një aspekt tjetër i bukurive të saj dhe ai është: atributet e Zotit dhe lutjet janë renditur në atë mënyrë, sa që një pjesë i përgjigjet pjesës tjetër.

Kështu, së pari thuhet: “*Lavdia është e Allahut*” (*El-Hamdulil-lah*) dhe kjo i përgjigjet lutjes “*Vetëm Ty të adhurojmë*” (*Ijja ke na'budu*). Kjo tregon se në momentin që njeriu vetëdijesohet se është Allahu që është përmbledhësi i të gjitha vetive të mira, ai do të shprehë vetvetishëm: “*Vetëm Ty të adhurojmë*”.

Atributi i radhës është “*Zoti i botëve*” (*Rabbil-‘ālemīn*) dhe kjo pjesë i përgjigjet lutjes së radhës “*Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë*” (*ve ijja ke neste'in*). Sepse robi vetëm kur të jetë i bindur se Zoti është krijuesi dhe rritësi i gjithçkaje, motivohet të thotë: Vetëm prej Teje kërkoj ndihmë.

Atributi tjetër është “*I Gjithëmeshirshmi*” (*Err-Rrahmān*) që do të thotë se Ai mëshiron pa kufi e pa dallim, dhe kjo i përgjigjet lutjes tjetër që është në vijim: “*Na udhëzo në rrugën e drejtë*” (*Ihdinas-sirātal-mustekīm*). Sepse kur njeriu shikon se Zoti i Madhërishëm ia ka plotësuar çdo nevojë, pa qenë kërkesa e tij dhe pa qenë ndonjë vepër e tij, dëshira më e madhe që mund t'i lindë në zemër është që gjithsesi të arrijë tek Burimi dhe, për këtë arsye, ai do t'i kërkojë Zotit *Rrahman* që t'ia mundësojë ardhjen drejt Tij.

Atributi i radhës është: “*Mëshirëbërësi*” (*Err-Rrahīm*) që do të thotë se për çdo vepër të mirë, Ai të jep shpërblimin më të mirë. Lutja e radhës i përgjigjet këtij atributi, e cila është: “*Në rrugën e atyre që i bekove*”

(*Sirātal-ledhīne en'amte 'alejhim*), sepse është atributi *Rrahim*, i cili bën të mundur që veprat e njeriut të mos shkojnë kot, por të sjellin rezultate të shkëlqyera.

Pastaj vjen atributi "*Sunduesi i ditës së gjykimit*" (*Māliki jeumid-dīn*) dhe kjo i përgjigjet lutjes "*jo në rrugën e atyre që tërboqën zemërimin Tënd dhe as të atyre që devijuan*" (*gajril-magdūbi 'alejhim ve led-dāl-līn*). Sepse kur njeriu do të jetë i bindur se atij do t'i kërkohet llogari, gjëja e parë që i lind në zemër është frika e dështimit dhe e devijimit. Prandaj, ai që mendon rreth atributit *Māliki jeumid-dīn*, patjetër që do të lutet që të mos shkaktojë zemërimin e Zotit dhe të mos devijojë nga rruga e Tij.

### **Udhëzim që përputhet me natyrën e njeriut**

Nëse u hedhim një sy me vëmendje ajeteve të kësaj sureje të shenjtë si dhe renditjes së tyre, na bëhet i qartë udhëzimi që mëson rrugëtimin shkallë-shkallë drejt Zotit të Madhërishëm.

Një qenie e caktuar mund të adhurohet vetëm për dy arsye: ose nga dashuria, ose nga frika ndaj saj. Dhe cilësitë e Veta që Zoti i Madhërishëm na ka treguar në këtë sure, na i mundësojnë të dyja këto elemente. Ka njerëz, të cilët nga natyra çmojnë dashurinë dhe mirësinë më shumë, dhe kur i shohin këto vlera te tjetri, motivohen t'i binden atij. Por ka të tjerë që nuk i përfillin shumë mirësitë dhe të tillët i bind frika. Së dyti, çdo i mençur së pari përpiqet të bëjë punën përmes rrugës së dashurisë, dhe nëse nuk e arrin në këtë mënyrë, e përdor frikën si motivim.

Në këtë sure, edhe Zoti i Madhërishëm së pari parashtroi atributet, të cilat nëse njeriu i përsiat, dashurohet me Zotin. Ai do të mendojë se Zoti që quhet Allah, është përmbledhësi i të gjithë mirësive dhe i pastër nga çdo e metë [*El-Hamdulil-lah*]; Ai është Krijuesi dhe Furnizuesi i çdo gjëje, që kujdeset si për ata që e besojnë, ashtu edhe për ata që e mohojnë [*Rabbil-‘ālemīn*]; Ai paraprakisht krijoi të gjitha ato mjete që do të ishin jetike për ne, madje edhe shumë gjëra të tjera që ne ende nuk i kemi zbuluar [*Err- Rrahmān*]; çdo vepër të mirë që bëjmë, Ai na e shpërblen në mënyrën më të mirë [*Err-Rrahīm*]. Ata të cilëve u bën përshtypje mirësia dhe dashuria e Zotit, duke i studiuar këto attribute, do të thonë vetvetishëm: “Vetëm Ty të adhurojmë”, dhe do të përkulen para Tij.

Kurse ata të cilëve nuk u bëjnë ndikim mirësia dhe dashuria dhe janë mësuar me një trajtim më të rreptë, kur shohin se si Allahu i Madhërishëm gjykon çdo gjë, aq saqë një ditë të gjithë do të paraqiten para Tij për t'i dhënë llogari për të gjitha mirësitë dhe bekimet që Ai u ka dhënë, pra, kur thellohen në atributin “Sunduesi i kohës së gjykimit” [*Māliki jeumid-dīn*] do të ndiejnë një frikë, saqë edhe ata në mënyrë të vetvetishme do të thonë: “Vetëm Ty të adhurojmë”, dhe do të përkulen para Tij.

Kështu që, nga këto dy kategori njerëzish, cilido qoftë, duke studiuar ajetet e para të sures El-Fatiha, do të pohojë natyrshëm: *Ijjāke na'budu* “Vetëm Ty të adhuroj”. Por, pasi zbulon bukurinë dhe dashurinë e Zotit, ose madhështinë dhe sundimin e Tij, do ta konstatojë edhe pafuqinë e tij për ta arritur Atë, andaj, bashkë me këtë lutje, do t'i

duhet të thotë: *ve ijjāke neste’in* “Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”, sepse ai do ta kuptojë se detyrën e adhurimit nuk mund ta bëjë dot siç duhet për shkak të dobësisë së vet nga njëra anë, dhe për shkak të përkushtimit që duhet t’i kushtojë Zotit nga ana tjetër.

Kur dashuria e mbush kupën dhe edhe madhështia e Zotit mbretëron fuqishëm në zemrën e robit, natyra e tij vetë do t’i kërkojë: *Ihdinas-sirātal-mustekīm* “Më udhëzo në rrugën e drejtë!” Rruga e drejtë gjithmonë është më e shkurtër se rrugët e tjera. Andaj, ky ligjërim reflekton edhe dashurinë e robit që thotë: O Zot! Nuk mund të qëndroj më larg Teje, andaj, tregoma rrugën më të shkurtër, që të vij sa më shpejt drejt Teje.

Por, ata që arrijnë në oborrin Hyjnor, dihet se nuk janë të gjithë të një grade. Mund të jenë edhe njerëz të thjeshtë dhe mund të jenë edhe të veçantë. Prandaj, pas kërkesës së mësipërme, vetë natyra e njeriut do t’i kërkojë Zotit: *Sirātal-ledhīne en’amte ‘alejhim* “O Zot! Më trego jo vetëm rrugën e drejtë, por rrugën e atyre që Ti i ke bekuar”. Pra, rob i kërkon Zotit që pranë Tij, ai të mos llogaritet me njerëzit e thjeshtë, por me të dashurit e Tij; duke qenë rob i dashuruar me Zotin, të bëhet edhe i dashur i Zotit (sepse grupi që është bekuar prej Zotit është ai që ka fituar dashurinë e Zotit; xhemati që gëzon vetëm bekime hyjnore në çdo hap, quhet xhemati i dashur i Zotit). Kështu që, rob i kërkon dashurinë e atij niveli, që nuk ka asnjë largësi. Në këtë gradë njeriu përsoset. Largohet çdo distancë mes të dashuruarit dhe të dashurit.

Megjithatë, besimi ngaqë mbetet: *بَيْنَ الْخَوْفِ وَالرَّجَاءِ* “mes frikës dhe shpresës”, njeriu në këtë gradë, pavarësisht se ka kënaqësinë më të

madhe shpirtërore, ai do të dëshirojë që kjo gjendje e tij të mbetet e përhershme dhe të fitojë palëkundshmëri në këtë rrugëtim. Andaj, Zoti që është Bujar, Vetë e mësoi njeriun t'i lutet: O Zot! Bëje që pas këtij takimi me Ty, të mos ndahem kurrë prej Teje. Ndarja bëhet për dy arsye: kur i dashuri është i pakënaqur dhe e përzë atë që pretendon të jetë i dashuruar, ose vetë i dashuruari heq dorë nga dashuria. Ajeti i radhës i përmend të dyja situatat. Pra, thotë: *gajril-magdubi 'alejhim* "O Zot! Mos ndodhtë që unë të bëj ndonjë gabim dhe të Të shkaktoj zemërim" dhe thotë: *ve led-dāl-lin* "As mos ndodhtë që pasi të kem arritur te destinacioni i duhur, unë vetë të ftohem nga dashuria ndaj Teje, duke u dashuruar me dikë a diçka tjetër!"

Kjo është një lutje kaq e përsosur saqë, Vetë Zoti i Madhërishëm nga mëshira e Tij ia mësoi njeriut që ai të lutet pranë Tij. Kaq e përsosur është saqë asnjë fe tjetër nuk mund të sjellë të ngjashmen e saj. Mendoni, se si është paraqitur natyra e njeriut që nga fillimi deri në fund! Si kjo sure kaq e vogël ka përmbledhur ilaçin e njerëzve të gjithfarë mendimesh! Andaj, ata që dinë të kuptojnë, le të kuptojnë dhe ata që dinë të mendojnë, le të mendojnë se nuk ka fe tjetër shpëtimtare për botën përveç Islamit dhe nuk ka libër tjetër që kuron sëmundjet shpirtërore, përveç Kuranit.

### *Āmīn*

Në hadithet e sakta (*sihab*) përmendet se Hazret Profeti Muhammed<sup>1savs</sup> kur e përfundonte suren El-Fatiha në namaz, pra duke lexuar ajetin: *gajril-magdubi 'alejhim ve led-dāl-lin*, thoshte: *Āmīn*,<sup>131</sup> që do të thotë:

اللَّهُمَّ اسْتَجِبْ لَنَا

O Allah! Na prano lutjen!

Po kështu vërtetohet nga sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, që  
ndiqën praktikën profetike.





## Rreth autorit

I biri i premtuar i Mesihut të Premtuar dhe Imam Mehdiut; shenjë e manifestimit të Allahut të Plotfuqishëm; fjala e Zotit, e cila ishte parashikuar nga Profeti Muhammed<sup>sa</sup> si dhe nga Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> gjithashtu; yll i tillë i qiellit shpirtëror që kërkon qindra vite për t'u shfaqur një herë; njeri i Zotit i kurorëzuar me dritë që rrezaton për të rrënjosur jetën shpirtërore të pasuesit të tij dhe për të magjepsur ata që nuk kanë pasur fatin e ndjekjes së tij; orator me një kualitet fenomenal saqë fjalimet e tij e mbanin audiencën të vëmendshme për orë të tëra; oqean i dijës shpirtërore; zëri i kohës; gjeni i shekullit XX; njeri me aftësi madhore të lidërshipt e me dhunti të shumta ishte Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmedi<sup>ra</sup> (1889-1965), i biri i Themeluesit të Xhematit Musliman Ahmedia, Mesihut të Premtuar<sup>as</sup> dhe Kalifi i Dytë i tij. Ai u zgjodh në këtë detyrë që në moshën 24 vjeçare, kur Xhemati ende ishte në periudhën foshnjore. Në një periudhë mbi pesëdhjetëvjeçare të Kalifatit të tij, ai e rriti, mbrujti dhe e formoi Xhematin përmes udhëzimeve shpirtërore, lutjeve, lotëve, rraskapitjeve dhe gjakut të tij. Ai jo vetëm që forcoi Xhematin, themelet e të cilit ishin hedhur nga Mesihu i Premtuar<sup>as</sup>, por gjithashtu e zgjeroi atë duke inicuar projekte, organizata dhe programe të ndryshme, duke u inspiruar prej Mesihut të Premtuar<sup>as</sup> dhe duke vepruar nën udhëzimin Hyjnor. Ndër prioritetet e tij të para, për të cilin ai e kishte dedikuar veten, ka qenë përmbushja e misionit të



Mesihut të Premtuar<sup>as</sup>, misionit madhor të përhapjes së Islamit të vërtetë me vlerat e tij të pacenuara në mbarë botën. Për ta arritur këtë, ai nisi *Tabrik-e-Xhedid*-in, nëpërmjet të cilit dërgoi, dhe vazhdon të dërgohen deri më sot, misionarë të Islamit anembanë botës. Mendjemprehtësia dhe intelekti i tij i lartë, urtësia e tij e madhe dhe, mbi të gjitha, dituria e tij e dhuruar prej Zotit e mundësuan të linte si trashëgimi një korpus të gjerë librash, fjalimesh etj, të cilat do të duan vite për të ardhur në dritë në gjuhë të ndryshme.

Kur Mesihu i Premtuar<sup>a.s.</sup> bëri lutje të veçanta që Zoti i Madhërishëm t'i dhuronte një djalë për mbështetjen e Islamit, Ai i dha sihariqin e lindjes pikërisht të këtij djali, duke thënë:

*“... Unë të jap shenjën e mëshirës në përputhje me atë që më kërkove ... Gëzohu se të jepet një djalë i pashëm dhe i çiltër... Ai do të jetë jashtëzakonisht i zgjuar, mirëkuptues dhe i butë nga zemra. Ai do të begatohet me dituri të dukshme dhe shpirtërore ... Djalë, kënaqësi e zemrës, i lartë e fisnik, manifestim i të Parit e të Fundit, manifestim i së Vërtetës e Triumfit ... Ardhja e tij është shumë e bekuar dhe do të jetë burim i manifestimit të madhështisë hyjnore...”*<sup>132</sup>

## **Bibliografi**

- <sup>1</sup> Sa'īd el-Khūrī esh-Shertūnī, "Akrebul-Mevārid fī Fusahil-'Arabijjeti vesh-Shevārid", vëllimi i tretë, zëri: sīn-vāv-rā (سور), Kum 1403 h./ 1983, fq. 233.
- <sup>2</sup> Ebū 'Abdullāh el-Kurtubī, "El-Xhāmiu li-Ahkāmil-Kurān", vëllimi i parë, redaktor: dr. 'Abdullāh bin 'Abdul-Muhsin et-Turkī, botues "Muessesetur-Risāleh", Bejrut 1427 h./ 2006, fq. 107.
- <sup>3</sup> Po aty.
- <sup>4</sup> El-Bekare 2:24.
- <sup>5</sup> Sahīh Muslim, kitāb "Es-Salāt", bāb "Huxhxheti men kāle el-besmeletu ājetun min evveli kul-li sūretin sivā berāete", hadithi nr. 894.
- <sup>6</sup> Xhāmi'u et-Tirmidhī, kitāb "Es-Salāt", bāb "Mā xhāe ennehu lā salāte il-lā bifātihatil-kitāb", hadithi nr. 247.
- <sup>7</sup> Sahīh Muslim, kitāb "Es-Salāt", bāb "Vuxhūbi kirāetil-fātihati fī kul-li rek'atin ve innehu idhā lem juhsinil-fātihate ve lā emkenehu te'al-lumuhā kare'e mā tejessere lehu min gajrihā", hadithi nr. 874.
- <sup>8</sup> Po aty, hadithi nr. 880.
- <sup>9</sup> Muhammed ibn Xherīr et-Taberī, "Xhāmi'ul-Bejān 'an te'vili ājel-Kurān", vëllimi i parë, redaktor: Mahmūd Muhammed Shākir, botues "Mektebeh Ibn Tejmiijeh", Kajro 1377 h./ 1968, fq. 201.
- <sup>10</sup> Sunen Ebī Dāvud, kitāb "El-Vitr", bāb "Fātihatil-Kitāb", hadithi nr. 1457.
- <sup>11</sup> Ahmed ibn Hanbel, "Musned", vëllimi XV, redaktor: Shu'ajb el-Arnaut, botues "Muessesetur-Risāleh", Bejrut 1417 h./ 1997, fq. 489, hadithi nr. 9788.
- <sup>12</sup> El-Hixhr 15:88.

<sup>13</sup> Abdullah ibn 'Abdurr-Rahmān ed-Dārimī, "Musned", kitāb "Fedāilil-Kurān", bāb "Fadl fātihatil-kitāb", vëllimi IV, redaktor: Husejn Sālim, botues "El-Mugni", botimi i parë, Riad 1421 h./ 2000, fq. 2122, hadithi nr. 3413.

<sup>14</sup> Imām el-Bejhakī, "Shu'abul-Īmān", fasl "Fī fedāilis-suver vel-ājāt, dhikru fatihatul-kitāb", vëllimi II, redaktor: Muhammed Se'id Zaghlūl, botues: "Kutub el-'Ilmijeh", botimi i parë, Bejrut 1421 h./ 2000, fq. 450, hadithi nr. 2370.

<sup>15</sup> Ahmed ibn Hanbel, "Musned", vëllimet XVII dhe XVIII, redaktor: Shu'ajb el-Arnaut, botues "Muessesetur-Risāleh", Bejrut 1417 h./ 1997, fq. 5 dhe 51, hadithet nr. 10985 dhe 11472.

<sup>16</sup> Sahih el-Bukhārī, kitāb "Fedāilul-Kurān", bāb "Fadlu fātihatul-kitāb", hadithi nr. 5007.

<sup>17</sup> Imām el-Bejhakī, "Shu'abul-Īmān", fasl "Fī fedāilis-suver vel-ājāt, dhikru fatihatul-kitāb", vëllimi II, redaktor: Muhammed Se'id Zaghlūl, botues: "Kutub el-'Ilmijeh", botimi i parë, Bejrut 1421 h./ 2000, fq. 448, hadithi nr. 2363.

<sup>18</sup> Ebū et-Tajjib Siddik bin Hasan, "Fet'hul-Bejān fī Mekāsīdul-Kurān", vëllimi I, redaktor: 'Abdullāh ibn Ibrāhīm el-Ensārī, botues "El-Mektebetul-'Asrijeh", Bejrut 1412 h./ 1992, fq. 32.

<sup>19</sup> Ebū 'Abdullāh el-Kurtubī, "El-Xhāmiu li-Ahkāmil-Kurān", vëllimi i parë, redaktor: dr. 'Abdullāh bin 'Abdul-Muhsin et-Turkī, botues "Muessesetur-Risāleh", Bejrut 1427 h./ 2006, fq. 172.

<sup>20</sup> Zbulesa 10:2-3. Bibla, Dhjata e Re, përkthyes dhe botues: "Shoqata Shqiptare e Biblës (The Albanian Bible Society)", Tiranë, korrik 1995, fq. 293.

<sup>21</sup> Zbulesa 10:4. I njëjti botim.

<sup>22</sup> Sunen en-Nesāi, kitāb "El-Ifitāh", bāb "Fadlu fātihatul-kitāb", hadithi nr. 914.

<sup>23</sup> Sahih el-Bukhari, kitab "Fedailul-Kuran", bab "Fadlu fatihatul-kitab", hadithi nr. 5006.

<sup>24</sup> Ebü 'Abdullah el-Kurtubî, "El-Xhamiu li-Ahkamil-Kuran", vëllimi i parë, redaktor: dr. 'Abdullah bin 'Abdul-Muhsin et-Turki, botues "Muessesetur-Risaleh", Bejrut 1427 h./ 2006, fq. 177.

<sup>25</sup> Po aty, fq. 179.

<sup>26</sup> Po aty, fq. 177.

<sup>27</sup> Sahih el-Bukhari, kitab "Fedailul-Kuran", bab "Fadlu fatihatul-kitab", hadithi nr. 5006.

<sup>28</sup> Sahih Muslim, kitab "Es-Salat", bab "Vuxhubi kiräetil-fatihati fi kul-li rek'atin ve innehu idha lem juhsinil-fatihate ve la emkenehu te'al-lumuhä kare'e mä tejessere lehu min gajrihä", hadithi nr. 878.

<sup>29</sup> Sahih el-Bukhari, kitab "El-Edhan", bab "Vuxhubil-kiräeti lil-imämi vel-me'mümi fis-salaväti kul-lihä fil-hadari ves-seferi ve mä juxh'heru fihä ve mä jukhäfetu", hadithi nr. 756.

<sup>30</sup> Sahih Muslim, kitab "Es-Salat", bab "Vuxhub kiräetil-fatihati fi kul-li rek'atin ve innehu idha lem juhsinil-fatihate ve la emkenehu te'al-lumuhä kare'e mä tejessere lehu min gajrihä", hadithi nr. 874.

<sup>31</sup> Sahih Ibn Khuzejmeh, kitab "Es-Salat", bab "Ixxhabul-kiräeti fis-saläti bifatihatil-kitabi ve nefjis-saläti bigajri kiräetihä", hadithi nr. 488.

<sup>32</sup> Sahih Ibn Hibban, kitab "Es-Salat", bab "Sifetus-salat", hadithi nr. 1782.

<sup>33</sup> Sunen Ebî Däud, kitab "Es-Salat", bab "Men terekel-kiräete fi salätihi bifatihatil-kitab", hadithi nr. 820.

<sup>34</sup> Ebū ‘Abdullāh el-Kurtubī, “El-Xhāmiu li-Ahkāmil-Kurān”, vëllimi i parë, redaktor: dr. ‘Abdullāh bin ‘Abdul-Muhsin et-Turkī, botues “Muessesetur-Risāleh”, Bejrut 1427 h./ 2006, fq. 184.

<sup>35</sup> Sunen Ibn Māxheh, kitāb “Ikāmetus-salāti ves-sunneti fihā”, bāb “El-Kirāetu khalfel-imām”, hadithi nr. 839.

<sup>36</sup> Sunen Ebī Dāvud, kitāb “Es-Salāt”, bāb “Men terekel-kirāete fī salātihi bifātihtil-kitāb”, hadithi nr. 824.

<sup>37</sup> Sunen Dārekutnī, kitāb “Es-Salāt”, bāb “Vuxhūb kirāeti ummil-kitābi fis-salāt ve khalfel-imāmi”, hadithi nr. 1190.

<sup>38</sup> El-Alak 96:2.

<sup>39</sup> Ebul-Kāsim Mahmūd ibn ‘Umer ez-Zemakhsherī, “El-Keshshāf ‘an hakāikit-tenzil ve ‘ujūnil-ekāvil fī vuxhūhil-te’vīl”, redaktor: Khalīl Me’mūn Shihā, botues “Dārul-Ma’rifeh”, Bejrut 1430 h./ 2009, fq. 25.

<sup>40</sup> Ebū Hajjān el-Endelūsī, “Tefsīr el-Bahrul-Muhīt”, vëllimi I, redaktor: ‘Ādil Ahmed ‘Abdul-Mevxhūd, botues: “Kutub el-‘Ilmijeh”, Bejrut 1413 h./ 1993, fq. 128.

<sup>41</sup> Muhammed ibn Ja’kūb el-Fīruzābādī, “El-Kāmūs el-Muhīt”, redaktor: Ebul-Vefā Nasr el-Hūrīnī, botues “El-Muessesetur-Risāleh”, zëri: vāv-sīn-mīm (وسم), fq. 1166-1167, dhe zëri: sīn-mīm-vāv (سمو), fq. 1296.

<sup>42</sup> Sa’id el-Khūrī esh-Shertūnī, “Akrebul-Mevārid fī Fusahil-‘Arabijjeti vesh-Shevārid”, vëllimi i parë, zëri: sīn-mīm-elif (سما), Kum 1403 h./ 1983, fq. 545-546.

<sup>43</sup> Po aty, zëri: elif-lām-hā (اله), fq. 16-17.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> Ebul-Fadl Muhammed ibn Mendhūr, "Lisānul-‘Arab", vëllimi XIII, botues "Dārus-Sāder", zëri: elif-lām-hā (ال) Bejrut, 1300 h./1883, fq. 467-471.

<sup>46</sup> "Encyclopædia Biblica, a Dictionary of the Bible", vëllimi III, zëri: NAMES; artikulli: 116. EL; fusnota: 3, redaktor: Thomas Kelly Cheyne dhe John Sutherland Black, botimi i parë, botues: "The Macmillan Company", Londër, prill 1902, fq. 342 (3325).

<sup>47</sup> Ebū Hajjān el-Endelūsī, "Tefsīr el-Bahrul-Muhīt", vëllimi I, redaktor: ‘Ādil Ahmed ‘Abdul-Mevxhūd, botues: "Kutub el-‘Ilmijeh", Bejrut 1413 h./ 1993, fq. 125.

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> Ebū et-Tajjib Siddik bin Hasan, "Fet’hul-Bejān fī Mekāsīdul-Kurān", vëllimi I, redaktor: ‘Abdullāh ibn Ibrāhīm el-Ensārī, botues "El-Mektebetul-‘Asrijeh", Bejrut 1412 h./ 1992, fq. 41.

<sup>50</sup> Ebū Hajjān el-Endelūsī, "Tefsīr el-Bahrul-Muhīt", vëllimi I, redaktor: ‘Ādil Ahmed ‘Abdul-Mevxhūd, botues: "Kutub el-‘Ilmijeh", Bejrut 1413 h./ 1993, fq. 125.

<sup>51</sup> Sunen Ebī Dāvud, kitāb "Es-Salāt", bāb "Men xhehere bi bismil-lāhirr-rrahmānirr-rrahīm", hadithi nr. 788.

<sup>52</sup> Ebū ‘Abdullāh el-Hākim en-Nīsābūrī, "El-Mustedrek ‘alā es-Sahīhajn", kitāb "Es-Salāt", bāb "Et-Te’mīn", hadithi nr. 845.

<sup>53</sup> Sunen Dārekutnī, kitāb "Es-Salāt", bāb "Vuxhūb kirāeti bismil-lāhirr-rrahmānirr-rrahīm fīs-salāti ve xhehri bihā ve ikhtilāfir-rivājāti fī dhālike", hadithi nr. 1175.

<sup>54</sup> Ebū et-Tajjib Siddik bin Hasan, "Fet'hul-Bejān fi Mekāsīdul-Kurān", vëllimi I, redaktor: 'Abdullāh ibn Ibrāhīm el-Ensārī, botues "El-Mektebetul-'Asrijjeh", Bejrut 1412 h./ 1992, fq. 38.

<sup>55</sup> Sahih Muslim, kitāb "Es-Salāt", bāb "Huxhxheti men kāle el-besmeletu ājetun min evveli kul-li sūretin sivā berāete", hadithi nr. 894.

<sup>56</sup> Ebu Bekr er-Rāzī el-Xhessās, "Ahkāmul-Kurān", bāb "El-Kavlu fil-besmeleti hel hije min evāilis-suver", fasl "Fī kirāetil-besmeleti fis-salāt", vëllimi i parë, redaktor: Muhammed es-Sādik el-Kamhāvī, botues "Ihjāut-Turath el-'Arabij", Bejrut 1412 h./ 1992, fq. 15.

<sup>57</sup> Xhelāluddīn es-Sujūtī, "Ed-durru menthūr fi tefsīri bil-me'thūr", vëllimi I, redaktor: dr. 'Abdullāh bin 'Abdul-Muhsin et-Turkī, Kajro, 1424 h./ 2003, fq. 45; cituar nga: El-Hāfidh 'Abdul-Kādir er-Ruhāvij, "El-Erba'in", transmetim nga Hazret Ebu Hurejre r.anhu.

<sup>58</sup> Ahmed ibn Hanbel, "Musned", vëllimi XXII, redaktor: Shu'ajb el-Arnaut, botues "Muessesetur-Risāleh", Bejrut 1417 h./ 1997, fq. 321, hadithi nr. 14434.

<sup>59</sup> En-Neml 27:31.

<sup>60</sup> Hud 11:42.

<sup>61</sup> El-Vakia 56:80.

<sup>62</sup> El-Bekare 2:27.

<sup>63</sup> En-Nahl 16:99.

<sup>64</sup> Ligji i Përtërirë 18:18-19. Bibla, Dhjata e Vjetër, përkthyes dhe botues: "Shoqata Shqiptare e Biblës (The Albanian Bible Society)", Tiranë, korrik 1995, fq. 202.

<sup>65</sup> Ligji i Përtërirë 18:20. I njëjti botim.

<sup>66</sup> "The Koran", përktheu nga arabishtja në anglisht: John Stanley Rodwell, botues "J. M. Dent & Sons Ltd.", London 1929, fq. 19, fusnota 2.

<sup>67</sup> En-Neml 27:31.

<sup>68</sup> Fatir 35:25.

<sup>69</sup> Fakhrud-Dīn er-Rāzī, "Tefsīrul-Kebīr" i njohur si "Mefātīhul-Gajb", vëllimi I, botimi i parë, botues "Dārul-Fikr", Bejrut 1401 h./ 1981, fq. 162.

<sup>70</sup> Ibrahim 14:2.

<sup>71</sup> El-En'am 6:4.

<sup>72</sup> Er-Rāgib el-Isfahānī, "Mufredāt Elfādhul-Kurān", redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: "Dārul-Kalem", zëri: thā-nūn-elif (ثنى), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 179.

<sup>73</sup> Ahmed ibn Hanbel, "Musned", vëllimi XXXIX, redaktor: Shu'ajb el-Arnaut, botimi i parë, botues "Muessesetur-Risāleh", Bejrut 1421 h./ 2001, fq. 246, hadithi nr. 23824.

<sup>74</sup> Er-Rāgib el-Isfahānī, "Mufredāt Elfādhul-Kurān", redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: "Dārul-Kalem", zëri: hā-mīm-dāl (حمد), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 256.

<sup>75</sup> Po aty, zëri: rā-bā-bā (رب), fq. 336.

<sup>76</sup> Beni Israil 17:25.

<sup>77</sup> Sa'īd el-Khūrī esh-Shertūnī, "Akrebul-Mevārid fī Fusahil-'Arabijjeti vesh-Shevārid", vëllimi i parë, zëri: rā-bā-bā (رب), Kum 1403 h./ 1983, fq. 381.

<sup>78</sup> Jusuf 12:42.

<sup>79</sup> Po aty.



<sup>80</sup> Er-Rāgib el-Isfahānī, "Mufredāt Elfādhul-Kurān", redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: "Dārul-Kalem", zëri: rā-bā-bā (رَبَّ), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 336.

<sup>81</sup> Ebū Hajjān el-Endelūsī, "Tefsir el-Bahrul-Muhit", vëllimi I, redaktor: 'Ādil Ahmed 'Abdul-Mevxhūd, botues: "Kutub el-'Ilmijeh", Bejrut 1413 h./ 1993, fq. 130.

<sup>82</sup> Er-Rāgib el-Isfahānī, "Mufredāt Elfādhul-Kurān", redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: "Dārul-Kalem", zëri: 'ajn-lām-mīm (عَلَم), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 581-582.

<sup>83</sup> Sa'īd el-Khūrī esh-Shertūnī, "Akrebul-Mevārid fī Fusahil-'Arabijjeti vesh-Shevārid", vëllimi i dytë, zëri: 'ajn-lām-mīm (عَلَم), Kum 1403 h./ 1983, fq. 824.

<sup>84</sup> Esh-Shu'ara 26:24-29.

<sup>85</sup> HaMim Es-Sexhde 41:10-11.

<sup>86</sup> *Hazrat Mirza Ghulam Ahmad*, "T'xhazul-Mesih", "Ruhani Khazain", vëll. XVIII, UK, 2009, fq. 139-140.

<sup>87</sup> El-Kalem 68:53.

<sup>88</sup> El-Bekare 2:48.

<sup>89</sup> El-Bekare 2:31.

<sup>90</sup> El-Haxh 22:48.

<sup>91</sup> Ebul-Fadl Muhammed ibn Mendhūr, "Lisānul-'Arab", vëllimi XIII, botues "Dārus-Sāder", zëri: jā-vāv-mīm (يَوْم), Bejrut, 1300h./1883, fq. 650.

<sup>92</sup> Po aty.

<sup>93</sup> Po aty.

<sup>94</sup> Po aty.

<sup>95</sup> Sa'īd el-Khūrī esh-Shertūnī, "Akrebul-Mevārid fī Fusahil-‘Arabijjeti vesh-Shevārid", vëllimi i parë, zëri: dāl-jā-nūn (دين), Kum 1403 h./ 1983, fq. 362.

<sup>96</sup> El-Infitar 82:18-20.

<sup>97</sup> Sa'īd el-Khūrī esh-Shertūnī, "Akrebul-Mevārid fī Fusahil-‘Arabijjeti vesh-Shevārid", vëllimi i dytë, zëri: ‘ajn-bā-dāl (عبد), Kum 1403 h./ 1983, fq. 736.

<sup>98</sup> Sahīh Muslim, kitāb "Es-Salāt", bāb "Vuxhūbi kirāetil-fātihati fī kul-li rek'atin ve innehu idhā lem juhsinil-fātihate ve lā emkenehu te'al-lumuhā kare'e mā tejjessere lehu min gajrihā", hadithi nr. 878.

<sup>99</sup> Sahīh el-Bukhārī, kitāb "El-Xhenāiz", bāb "Mā kīle fī evlādil-mushrikīn", hadithi nr. 1385.

<sup>100</sup> Sa'īd el-Khūrī esh-Shertūnī, "Akrebul-Mevārid fī Fusahil-‘Arabijjeti vesh-Shevārid", vëllimi i dytë, zëri: hā-dāl-jā (هدى), Kum 1403 h./ 1983, fq. 1380.

<sup>101</sup> TaHa 20:51.

<sup>102</sup> Es-Sexhde 32:25.

<sup>103</sup> El-A'raf 7:44.

<sup>104</sup> Et-Tegabun 64:12.

<sup>105</sup> En-Nur 24:55.

<sup>106</sup> Er-Rāgib el-Isfahānī, "Mufredāt Elfādhul-Kurān", redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: "Dārul-Kalem", zëri: sīn-rā-tā (سرط), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 407.

<sup>107</sup> Po aty, fq. 692.

<sup>108</sup> Muhammed 47:18.

<sup>109</sup> Sa'īd el-Khūrī esh-Shertūnī, "Akrebul-Mevārid fī Fusahil-‘Arabijjeti vesh-Shevārid", vëllimi i dytë, zëri: nūn-‘ajn-mīm (نعم), Kum 1403 h./ 1983, fq. 1321.

<sup>110</sup> Er-Rāgib el-Isfahānī, "Mufredāt Elfādhul-Kurān", redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: "Dārul-Kalem", zëri: nūn-‘ajn-mīm (نعم), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 815.

<sup>111</sup> Xhāmi‘u et-Tirmidhī, kitāb "El-Fiten", bāb "Mā xhāe akhberen-nebijju sal-lAllāhu ‘alejhi ve sel-leme as’hābehu bimā huve kāinun ilā jevmil-kijāmeti", hadithi nr. 2191.

<sup>112</sup> Er-Rāgib el-Isfahānī, "Mufredāt Elfādhul-Kurān", redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: "Dārul-Kalem", zëri: gajn-dād-bā (غضب), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 608.

<sup>113</sup> Po aty, fq. 509.

<sup>114</sup> El-Kehf 18:105.

<sup>115</sup> Ed-Duha 93:8.

<sup>116</sup> Beni-Israil (El-Isra) 17:84.

<sup>117</sup> El-Maide 5:12.

<sup>118</sup> El-Maide 5:21.

<sup>119</sup> En-Nisa 4:67-70.

<sup>120</sup> El-En’am 6:125.

<sup>121</sup> Sunen Ebī Dāvud, kitāb "El-Vitr", bāb "Fātihtatil-Kitāb", hadithi nr. 1457.

<sup>122</sup> Et-Tahrim 66:13.

<sup>123</sup> El-Maide 5:4.

<sup>124</sup> Ahmed ibn Hanbel, "Musned", vëllimi XXXII, redaktor: Shu‘ajb el-Arnaut, botimi i parë, botues "Muessesetur-Risāleh", Bejrut 1420 h./ 1999, fq. 123-124, hadithi nr. 19381.

<sup>125</sup> Xhāmi‘u et-Tirmidhī, kitāb "Tefsīrul-Kurān", hadithi nr. 2954.

<sup>126</sup> Ebū et-Tajjib Siddik bin Hasan, "Fer'hul-Bejān fī Mekāsīdul-Kurān", vëllimi I, redaktor: 'Abdullāh ibn Ibrāhīm el-Ensārī, botues "El-Mektebetul-'Asrijeh", Bejrut 1412 h./ 1992, fq. 53.

<sup>127</sup> Hāfidh Ibn Kethīr, "Tefsīrul-Kurānil-'Adhīm", vëllimi I, redaktor: Muhammed Husejn Shemsud-dīn, botues "El-Kutub el-'Ilmijeh", Bejrut, 1419 h./ 1998, fq. 56.

<sup>128</sup> El-Bekare 2:91.

<sup>129</sup> El-Kehf 18:105.

<sup>130</sup> El-Maide 5:78.

<sup>131</sup> Sahīh Muslim, kitāb "Es-Salāt", bāb "En-Nehju 'an mubāderetil-imāmi bit-tekbīri ve gajrihi", hadithi nr. 923.

<sup>132</sup> Mexhmua Ishtiharat (Përmbledhja e njoftimeve), Ishtihar (njoftimi) 20 shkurt 1886, vëll. I, f. 100-103.

## Shpjegimi i termave

|                     |                                                                                                                                                                                                              |
|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Hafiz</i>        | Ai që e di përmendësh gjithë Kuranin e Shenjtë.                                                                                                                                                              |
| <i>Hazret</i>       | I nderuar.                                                                                                                                                                                                   |
| <i>Mekam mahmud</i> | Gradë e lavdëruar. <i>Mekam mahmud</i> si gradë përmendet në Kuranin Famëlartë, në ajetin 80 të sures 17.                                                                                                    |
| <i>Sahab</i>        | Besimtar musliman që ka jetuar me Profetin Muhammed <sup>saws</sup> .                                                                                                                                        |
| <i>Sahib</i>        | I nderuar.                                                                                                                                                                                                   |
| <i>Sure</i>         | Kapitull i Kuranit të Shenjtë.                                                                                                                                                                               |
| <i>Takva</i>        | <i>Takva</i> , në arabisht, do të thotë “drojë prej Zotit”. Ajo gjithashtu nënkupton se një besimtar i vërtetë, duke qenë i devotshëm, gjithmonë i shmanget mospëlqimit të Zotit dhe mundohet ta kënaqë Atë. |
| <i>Tefsir</i>       | Komentim.                                                                                                                                                                                                    |
| <i>Umet</i>         | Populli besimtar i një profeti.                                                                                                                                                                              |
| <i>Xhemat</i>       | Kuptimi leksikor: bashkësi, grup i besimtarëve që ka një udhëheqës.                                                                                                                                          |

### Shënim për citimin e ajeteve të Kuranit Famëlartë

Ajeti (vargu) “*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*” (Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit) që i referohet Kuranit Famëlartë, konsiderohet si ajeti i parë i çdo sureje (kapitulli). Në disa tekste, nuk shënohet si ajeti i parë, dhe lexuesi duhet të ketë parasysh se ajeti i cituar në këtë libër, në tekste të tjera do të gjendet në një ajet më parë.

## Shkurtesat

- savs*      *Selallahu alejhiveselam* (Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Hazret Profetit Muhammed<sup>savs</sup>.
- as*        *Alejhiselam* (Paqja qoftë mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë profeti të Allahut.
- ra*        *RadijAllahu anhu/anha/anhum* (Allahu qoftë i kënaqur me të/ta!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë sahabi a sahabeje të ndonjë profeti.

### **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Mahmood Ahmad, Mirza Basheer-ud-Din  
Komentim i Sures El-Fatiha / Mirza Bashiruddin  
Mahmud Ahmed ; përkth. nga origj. Samad  
Ghori ; red. Ina Komino, Besmir Yvejsi. –  
Tiranë : Fondacioni “Xhemati Mysliman  
Ahmedia e Shqipërisë”, 2018  
150 f. ; 14.5 x 21cm.  
ISBN 978-9928-4491-0-8

1.Feja islame 2.Kurani 3.Kritika, interpretimi

28 -23 -273

### **Adresat**

#### **Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës**

Rr. “Holger Pedersen”, Lagjja e Spitalit,  
Prishtinë, Kosovë

Kontakt: +381 3855 8436, +377 4481 7813,

Fax: +381 3851 2408

#### **Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë**

Rr. “Pavarësia”, KM 1, Mëzez,

Kutia Postare 8176,

Tiranë, Shqipëri (Albania)

Kontakt +355 67 216 8054

amj.albania@gmail.com

---

Në shqip: [www.alislam.al](http://www.alislam.al)

Në anglisht: [www.alislam.org](http://www.alislam.org)

Janë vetëm shtatë vargje por secili prej tyre mbart një det kuptimesh dhe dijes. E tillë është surja El-Fatiha, kaptina e parë e Kuranit Famëlartë. Me një depërtim të thellë në këtë sure, lexuesi kupton që ajo është si një prizëm, të cilën nga do ta kthesh, tregon ngjyra të reja. I tillë është ky komentim brilant i kësaj sureje të bekuar.

Megjithatë, ky libër është vetëm një pjesë e vogël e Komentimit të Gjerë të sureve të ndryshme të Kuranit Famëlartë që bëri Kalifi i Dytë i Xhematit, Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed, Allahu e mëshiroftë. Komentimi i sures El-Fatiha është një pjesë e vëllimit të parë. Gjithsej, autori ka shkruar dhjetë vëllime që kanë më shumë se dhjetë mijë faqe.

---

*This is an Albanian translation of the commentary of Surah Al-Fatiha, taken from "Tafsir-e-Kabir" vol. I, written by Hazrat Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmad r.a., the Second Khalifa of the Promised Messiah <sup>a.s</sup> (1914 - 1965).*

www.alislam.al



ISBN 9928-4491-0-8



9 789928 449108